

VENDIM
Nr.416, datë 2.6.2010

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PESTË, TË GJASHTË, TË SHTATË DHE TË TETË
KOMBËTAR PERIODIK, NË KUADËR TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE “PËR
ZHUKJEN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT RACOR”**

Në mbështetje të neneve 100 e 122 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të ligjit nr.7768, datë 9.11.1993 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racor”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë kombëtar periodik, në kuadër të konventës “Për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racor”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**RAPORTI I V- VIII PERIODIK KOMBËTAR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MBI KONVENTËN NDËRKOMBËTARE “PËR ZHUKJEN E TË GJITHA FORMAVE TË
DISKRIMINIMIT RACOR”(2002 – 2009)**

Shkurtime

AP	Avokati i Popullit
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
INSTAT	Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë
KC	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
KF	Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë
KP	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPr.A	Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë
KPr.C	Kodi i Procedurave Civile i Republikës së Shqipërisë
KPr.P	Kodi i Procedurave Penale i Republikës së Shqipërisë
K Punës	Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë
KKRT	Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit
KM	Këshilli i Ministrave
Konventa kuadër	Konventa e OKB “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial”
KSHH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
KSHM	Komiteti Shtetëror për Minoritetet
Kushtetuta	Kushtetuta e Shqipërisë
Kuvendi	Kuvendi i Shqipërisë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MPÇSShB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
RSH	Republika e Shqipërisë

Dokumenti bazë

I. Karakteristikat demografike, ekonomike, sociale dhe kulturore

A.i. Popullsia

1. Popullsia e Republikës së Shqipërisë (në vijim RSH) në datën 1 janar 2009, sipas vlerësimeve të Institutit të Statistikave (në vijim INSTAT) ka qenë 3.193.850 banorë.

Ky numër, krahasuar me regjistrimin e fundit të popullsisë dhe banesave¹, ka pësuar një rritje prej 4%.

2. Për rifreskimin dhe plotësimin e të dhënave në këtë drejtim, Qeveria Shqiptare po merr të gjitha masat e nevojshme, që brenda vitit 2011 të realizojë fillimin e procesit të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në RSH.

Për herë të parë pas shumë vjetësh², në këtë regjistrim do të përfshihen rubrikat e kombësisë dhe përkatësisë fetare.

3. Vlerat krahasuese të topikëve të popullsisë në vite, gjenden në aneksin e këtij raporti.

(Tab. A. i.1/ 2/ 3/ 4/5/6/7 dhe Graf. A.1.1/2)

A.ii. Treguesit socialë, ekonomikë dhe kulturorë³

Treguesit socialë

A.ii.1. Niveli arsimor

4. Bazuar në statistikën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në vijim MASH) dhe sipas Raportit të Regjistrimit Bruto (GER-Gross Enrolment Ratio) regjistrimi i nxënësve në arsimin e detyruar dhe të mesëm dhe niveli i frekuentimit në arsimin e detyruar nga nxënësset femra rezultojnë në këto shifra: arsimi fillor 99%, arsimi i ulët 102%, arsimi i detyruar 101%, arsimi i mesëm 64%.

5. Referuar Raportit të Regjistrimit Neto (NER-Net Enrolment Ratio), arsimi i detyruar dhe ai i mesëm frekuentohen në këto nivele: arsimi fillor 89%, arsimi i ulët 98%, arsimi i detyruar 94% dhe arsimi i mesëm 53,4%.

6. Një pjesë e vajzave nuk e frekuentojnë arsimin e detyruar dhe shkaqet janë të lidhura me mentalitetin, mungesën e sigurisë në përgjithësi për ato shkolla që janë larg vendbanimit të nxënësve, si dhe me zënien me punë, kryesisht brenda ekonomive familjare. Shkalla neto e regjistrimit gjatë periudhës 2001-‘06 flet për një pjesëmarrje në rritje të femrave në veçanti në nivelin universitar, ku numri i femrave është më i madh se ai i meshkujve, gjë e cila reflektohet edhe në numrin e të diplomuarve (Tab.A.ii.1.3). Edhe në nivelet e tjera të arsimit parashkollor dhe atij 9-vjeçar diferenca midis meshkujve dhe femrave, megjithëse në favor të meshkujve, nuk është sinjifikative. (Tab. A.ii.1.1).

7. Në shkollat 9-vjeçare raportohet një pjesëmarrje e vajzave në shkollën 48%. Në shkollat e mesme pjesëmarrja e vajzave më e ulët (45%) krahasuar me djemtë (55%), ndërsa në arsimin universitar regjistrimi i femrave (rreth 58,2%) është më i lartë se sa ai i meshkujve. Në sistemin parashkollor 9-vjeçar dhe të mesëm përfaqësimi i grave dhe vajzave paraqitet në një nivel të konsiderueshëm. Në arsimin 9-vjeçar përqindja e femrave vazhdon të rritet si në zonat urbane, ashtu dhe në ato rurale. Në vitin akademik 2005-‘06 kjo shifër arriti në 66%. Ndërkohë që, në përgjithësi, përqindja e femrave në arsimin e mesëm është më e lartë se ajo e meshkujve, në zonat rurale ato përbëjnë vetëm rreth 43% të stafit pedagogjik.

8. Në nivelin e lartë arsimor pjesëmarrja e grave është e ulët (49%, kundrejt 51% burra) në të gjitha nivelet, si në administratë, ashtu edhe në stafin pedagogjik. Në drejtoritë dhe zyrat arsimore ka një përfaqësim prej 59% nga burrat dhe 41% nga gratë. Në pozicione drejtuese, 92% e drejtorëve janë meshkuj, kurse janë 8% femra. Në zyrat rajonale 83% e drejtorëve janë meshkuj, kurse 17% janë femra. Megjithëse në nivelin e specialistëve dhe punonjësve ndihmës në këto institucione gratë kanë përqindje më të lartë, ato ende mbeten më poshtë se burrat (48% specialiste femra kundrejt 52% meshkuj). Po ashtu, 40% e punonjësve ndihmës janë femra, kurse 60% janë meshkuj.

A.ii.2. Punësimi dhe papunësia

¹ Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë dhe Banesave (REPOBA 2001)

² Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë në vitin 1930, i përfshinte të dyja këto rubrika

³ Informacion i marrë nga INSTAT

9. Të punësuarit për vitin 2006, zinin 48.8 % të popullsisë në moshë pune. Gjatë atij viti të punësuarit ishin 935.000 persona (578 000 meshkuj/357 000 femra).

Analiza e nivelit të punësimit sipas gjinisë në vite, tregon se për periudhën 1996-2006, niveli i punësimit të femrave ka qenë dukshëm më i ulët se ai i meshkujve.

Kështu, niveli i punësimit të meshkujve për vitin 2006 është 58,8 %, ndërsa për femrat është vetëm 38,2%. Në sektorin shtetëror femrat përbënin rreth 43,3 % të të punësuarve gjithsej, ku në grupin e ligjvënësve, nëpunësve të lartë dhe drejtuesve ato përbënin vetëm 24,6 % dhe për grupet e specialistëve dhe të nëpunësve të thjeshtë, kjo shifër shkonte deri në 57 %.

10. Për vitin 2008, në bazë të të dhënave të anketës për forcën e punës dhe në përputhje me definicionin për punësimin, të EUROSTAT dhe të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, rezultojnë rreth 1.123 mijë të punësuar në moshë 15 vjeç e lart (15 – 64 vjeç).

Shkalla e punësimit në nivel vendi për popullsinë në moshë 15-64 vjeç rezultoi 53,8%.

Niveli i punësimit, në të gjitha grupmoshat, është më i lartë te meshkujt (63% - meshkujt dhe 45,5% - femrat). Analiza e nivelit të punësimit sipas gjinisë në vite, tregon se për periudhën 1996 - 2008, niveli i punësimit të femrave ka qenë dukshëm më i ulët se ai i meshkujve. Femrat e punësuar kanë një pjesëmarrje më të madhe në sektorin privat bujqësor, ndërkohë që meshkujt janë më të angazhuar në sektorin privat jobujqësor (femrat përbëjnë vetëm afro ¼ e të punësuarve në sektorin privat jobujqësor).

11. Diferenca femra meshkuj vihet re edhe në pjesëmarrjen në nivele të ndryshme të administratës publike dhe vendore. Femrat zënë vetëm 39,3 % të të punësuarve në ministri dhe në institucione të tjera të larta shtetërore. Ndërsa në administratën vendore përqindja që zënë femrat është akoma më e ulët, vetëm 31,6 %. Kjo pjesëmarrje është disi më e lartë në bashkitë ku femrat zënë 45,4 % të të punësuarve në këto institucione. Ndërsa në komuna pjesëmarrja e femrave është 21,9 % e ndërsa në prefektura ato zënë vetëm 24,3 %.

12. Shkalla e papunësisë për vitin 2008 ka qenë 13%. Nivelet e saj më të larta prekin më tepër grupmoshat e reja deri në rreth 30 vjeç. Tregues i papunësisë për grupmoshën 30-49 vjeç është më i lartë për femrat sesa për meshkujt; nga ana tjetër në grupmoshat 55+ vjeç, vihet re një tendencë më e lartë për të kërkuar punë tek meshkujt. Vlerat krahasuese të papunësisë për periudhën midis viteve 1995 – 2008, tregojnë se niveli i papunësisë është më i lartë tek femrat sesa tek meshkujt (përveç vitit 2007, sipas anketës së forcave të punës), ndërsa niveli i papunësisë së regjistruar sipas gjinisë ka mbetur me të njëjtën tendencë. (Tab.A.ii.2.1/2/3/4/5)

A.ii.3 Pagat

13. Gjatë gjithë periudhës 1995-2007, vërehet një prirje në rritje e pagës mesatare mujore për në punonjës në sektorin shtetëror. Kjo nuk mund të thuhet përse i përket prirjes në pagën reale, e cila është ndikuar nga luhatjet e inflacionit. (Tab. A.ii.3)

14. Në periudhën 1994-‘96, si rrjedhojë e qëndrueshmërisë së çmimeve të mallrave të ndryshme të konsumit dhe rritjes së pagave në sektorin shtetëror dy herë në vit, rritja e pagave ishte më e madhe se rritja e çmimeve. Kriza ekonomike e vitit 1997 solli si rrjedhojë uljen e ndjeshme të pagës reale, duke shënuar një rënie rreth 17 % krahasuar me atë të vitit 1996.

15. Në vitin 1999 çmimet e konsumit pothuaj nuk ndryshuan fare dhe në fund të tij paga reale pësoi një rritje prej 17,7%. Viti 2001 shënon një rritje të pagës mesatare mujore me 15,1% ndërkohë që edhe çmimet e konsumit pësojnë rritje me rreth 3,1% duke çuar në një rritje të pagës reale prej 11,6%. Në vitin 2003 rritja e pagës mesatare mujore është 8,5% ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2,4% duke sjellë rritje në pagën reale me 6%. Në vitin 2004 rritja e pagës mesatare mujore është 9,9%, ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2,4% duke sjellë rritje në pagën reale me 7,3%. Në vitin 2005 rritja e pagës mesatare mujore dhe rritja e pagës reale mbeten në të njëjtin nivel me vitin 2004. Në vitin 2006 rritja e pagës mesatare mujore është 7,5%, ndërsa rritja e pagës reale është 4,9%.

Për vitin 2007 rritja e pagës mesatare mujore është 17,1%, ndërsa çmimet e konsumit rriten me 2,9% duke sjellë rritje në pagën reale me 13,8%. Gjatë vitit 2008, rritja e pagës mesatare mujore është 8,2% ndërsa çmimet e konsumit u rriten me 2,2% duke sjellë rritje në pagën reale me 4,7%.⁴

A.ii.4 Sistemi arsimor

16. Karakteristikat kryesore të arsimit në vitet e fundit janë:

⁴ Të dhënat e mësipërme për pagën mesatare mujore në sektorin shtetëror dhe rritjen e çmimeve të konsumit janë të publikuara nga INSTAT

-Shtimi i numrit të nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm profesional e teknik dhe profilizimi i shkollave të mesme të përgjithshme;

-Rritja e pranimeve të reja në arsimin e lartë me shkëputje nga puna, si përgjigje e kërkesave të mëdha të nxënësve që mbarojnë shkollat e mesme;

-Përmirësimi i shumë ambienteve mësimore dhe i teksteve shkollore.

17. Në vitet e fundit është rritur me shpejtësi edhe numri i shkollave jopublike (private), veçanërisht në qytetet kryesore të vendit. Pjesa më e madhe e tyre kanë përfunduar tashmë procesin e implementimit të programeve mësimore sipas sistemit të Kartës së Bolonjës.

Në vitin shkollor 2005 u regjistruan në të gjitha nivelet e arsimit 769 600 fëmijë, nxënës e studentë, (4,3 % e numrit të përgjithshëm të të cilëve janë të arsimit privat) duke shënuar një rritje prej 1 %, krahasuar me vitin 2003-‘04 dhe 2,3 % me vitin 2001-‘02.

18. Arsimi parashkollor ka një gjendje të qëndrueshme të numrit të fëmijëve të regjistruar në pesë vitet e fundit, pas rënies që pësoi pas viteve ‘90.

Në arsimin bazë 9-vjeçar, numri i nxënësve të regjistruar për herë të parë në klasë të parë në vitin 2005 ishte rreth 51 000. Krahasuar me vitin 2002, gjatë atij viti rezultoi një diferencë prej 12 000 personash më pak (që ka ardhur si rezultat i uljes së lindshmërisë dhe i lëvizjes jo të rregullt të popullsisë në migracion/emigracion).

19. Në vitin shkollor 2005-‘06, në raport me grupmoshën teorike të popullsisë që duhej të ishte në arsimin 9-vjeçar, pjesëmarrja në shkollat 9-vjeçare rezultoi 102,4%.

Kjo shpjegohet me faktin se në të regjistruarit ka më të vegjël ose edhe më të rritur se grupmosha që i përket këtij niveli arsimor. Në shkollat e mesme numri i nxënësve të regjistruar ka ardhur duke u rritur çdo vit. Shkollat e mesme të përgjithshme, në të cilat përfshihen 82,9 % e të gjithë nxënësve të arsimit të mesëm, pas disa vjet eksperimentimi, janë duke u profilizuar në drejtim të shkencave shoqërore dhe të natyrës. Arsimi profesional, megjithëse zë një përqindje të vogël të arsimit të mesëm, ka një tendencë në rritje me qëllim rritjen e mundësive të punësimit.

20. Gjatë vitit 2005, në arsimin e lartë, u regjistruan për herë të parë në sistemin me kohë të plotë, 52,5 % e atyre që mbaruan shkollat e mesme. Po kështu duke krahasuar studentët e regjistruar në vitin 2005 me ata në vitin 1990-‘91, numri i tyre është rritur në 46.700, ose janë regjistruar 2,3 herë më tepër studentë në vitin e fundit. Përqindjen më të madhe të të regjistruarve të vitit 2005 e zënë ata në fushën e shkencave shoqërore, ekonomike dhe drejtësisë, të cilët përbëjnë rreth 31 % të të regjistruarve. Një numër gjithmonë e më i madh i nxënësve dhe studentëve vazhdojnë çdo vit me sukses shkollat jashtë shtetit, privatisht ose me bursa, kryesisht në Itali, SHBA etj.

A. ii. 5. Shëndeti publik

21. Njohja e situatës shëndetësore të vendit nëpërmjet treguesve statistikorë të shëndetësisë është pjesë e vlerësimit të sistemit të shërbimit shëndetësor, për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të tij. Situata shëndetësore paraqitet me probleme për shkak të periudhës së vështirë të tranzicionit, megjithatë treguesit kryesorë janë në rrugën e përmirësimit të tyre si në shërbimin shëndetësor parësor edhe në atë spitalor. Niveli i disa treguesve të rëndësishëm, si jetëgjatësia, vdekshmëria dhe sëmundshmëria kronike janë të krahasueshme me vendet e zhvilluara, ndërsa tregues si vdekshmëria foshnjore, vdekshmëria amtare dhe sëmundshmëria akute infektive janë të krahasueshme me ato të vendeve në zhvillim.

22. Sistemi shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik. Sektori privat mbulon shërbimin farmaceutik, stomatologjik dhe më pak shërbimet e tjera. Ky sistem ka evoluar në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve të tranzicionit. Institucionet e Shërbimit Parësor kanë si mision mbrojtjen e shëndetit në përputhje me objektivat e OBSH “shëndet për të gjithë”. Këto institucione kanë ardhur duke u zvogëluar përsa i përket numrit të tyre dhe aktivitetit në treguesit kryesorë. Kjo shpjegohet me riorganizimin e këtyre institucioneve, krijimin e mjediseve më të përshtatshme, rritjen e cilësisë së shërbimit, si dhe krijimin e sektorit privat.

23. Në institucionet me shtretër, treguesit e shërbimit spitalor duke qenë se mbulojnë gjithë shërbimin shëndetësor spitalor shërbejnë si pikënisje për analizën e sëmundshmërisë, epidemiologjisë, vdekshmërisë, burimeve njerëzore etj. Institucionet në shërbimin spitalor përfaqësohen nga spitalet e përgjithshme edhe ato të specializuara. Reforma spitalore me kontributin e donatorëve po përmirëson treguesit e shfrytëzimit të spitaleve në drejtim të përqendrimit të shërbimeve në spitale të mëdhenj, shërbimeve më të kualifikuara dhe përdorimin e aparaturave me teknologji bashkëkohore.

24. Statistikat tregojnë se një pjesë relativisht e lartë e vdekjeve dhe sëmundjeve në Shqipëri vijnë si pasojë e: duhan-pirjes, abuzimit me alkool, pakujdesisë në rrugë, përdorimit të drogave ilegale, mënyrës

së të ushqyerit dhe stresit, si një fenomen i ri i shoqërisë moderne.

Inaktiviteti fizik është një tjetër faktor risku, i cili prezanton një problem potencial për hipertensionin, sëmundjet e artereve koronare të zemrës etj.

Treguesit ekonomikë

A.ii.6. Energjia

25. Nafta dhe energjia elektrike janë dy burimet kryesore të energjisë së prodhuar në vend. Energjia elektrike përbën 24 % të prodhimit në vend në vitin 2007, ndërsa nafta, 52 % të tij. Në veçanti nga burimet e tjera të energjisë, nafta ka pasur rritje të konsiderueshme të importit gjatë periudhës 1998-2007, pasi prodhimi vendas nuk arrin të mbulojë kërkesën gjithnjë në rritje për këtë produkt.

26. Burimet e energjisë, si total i prodhimit në vend dhe importit, në vitin 2007 u rritën me 7,9% , krahasuar me vitin 2006. Sasia më e madhe e energjisë disponibël për konsum final, gjatë periudhës 1998-2007, është shënuar në vitin 2004 (2,131 ktoe). Sektori i transportit dhe familjet janë konsumatorët kryesorë të energjisë finale për konsum. Në vitin 2007, familjet konsumuan gjithsej rreth 24,7 % të energjisë finale për konsum, (kryesisht energji elektrike) ndërsa, sektori i transportit rreth 42,2 % (naftë dhe nënproduktet e saj).

A. ii..7. Indeksi i çmimeve të konsumit

27. Në vitin 2008 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 2,2 % dhe një vit më parë ky ndryshim ishte 3,1%. Gjatë vitit 2008 rritjet më të mëdha vjetore u vërejtën në grupet “Argëtim dhe kulturë” (10,2%) dhe “Qira, ujë lëndë djegëse dhe energji” (4,9%). Ulja më e madhe vjetore u vërejt në grupin “Komunikim” (19,3%), ndërsa në grupet e tjera ndryshimi vjetor varionte nga -3,9 në +3,5%.

A.ii.8. Indeksi i çmimeve të prodhimit

28. Indeksi i çmimeve të prodhimit në vitin 2008 arriti 111,1 % (Viti 2005 = 100%) duke shënuar një rritje vjetore 6,5% krahasuar me vitin 2007. Kundrejt të njëjtës periudhë krahasimi, sektori “Industria nxjerrëse” shënoi një rritje 6,8 %. Në këtë sektor pothuajse të gjitha indekset e çmimeve të produkteve kanë pasur një rritje kundrejt vitit 2007.

Këtu mund të përmendim rritjen e çmimeve në aktivitetet “Nxjerrja e produkteve energjetike” prej 7,4 % dhe “Nxjerrja e produkteve joenergjetike” prej 0,6 %. Sektori “Industri përpunuese” u rrit 3,2 % krahasuar me vitin 2007. Brenda këtij sektori çmimet në aktivitetin “Industria ushqimore” u rritën 9,8 %, në aktivitetin “Industria tekstile dhe e veshjeve” u rritën 5,6%, në aktivitetin “Rafinimi i naftës, koksifikimi” u rritën 13,5%. Ndërsa çmimet e produkteve në aktivitetin “Industria e duhanit ” u ulën 14,8 %, në aktivitetin “Industria e kauçikut dhe plastikës” u ulën 7,5%.

A.ii.9. Ndërtimi

29. Gjatë vitit 2008 u miratuan leje ndërtimi për objekte të llojeve të ndryshme me një vlerë prej 93,9 miliardë lekë. Atë vit, numri i lejeve të miratuara për ndërtesa në krahasim me vitin 2007, u rrit 149,9%. Banesat janë objektet më të preferuara në kërkesat për leje ndërtimi. Gjatë periudhës 2002 – ‘08, numri i lejeve për banesa zinte mbi 56 – 63% të numrit total të lejeve për ndërtesa të llojeve të ndryshme.

30. Prefekturat Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë vazhdojnë të kenë kërkesat më të mëdha për leje ndërtimi. E veçantë për prefekturat Tiranë, Durrës ka qenë kërkesa për objekte me shumë kate, kryesisht për banesa dhe ndërtesa tregtare. Pjesa më e madhe e ndërtimeve, si: ndërtesa banimi, hotele, ndërtesa tregtare, ndërtesa industriale etj. janë të financuara kryesisht nga investitorë privatë. Infrastruktura e objekteve social-kulturore dhe shëndetësore është financuar kryesisht nga investitorë shtetërorë. Investitorët shqiptarë janë më të interesuarit për financimin e objekteve në sektorin e ndërtimit, i cili përbën 87,1% të aktiviteteve të tyre.

A.ii. 10. Turizmi

31. Zhvillimi i turizmit është i lidhur ngushtë me investimet dhe punësimin. Në këtë kuadër gjatë viteve 2007-’08 ka pësuar rritje numri i aktivitete të tilla: si hoteleri, bar- restorante, qendra tregtare, transport dhe ndërtime (të ndryshme të infrastrukturës), shoqëruar këto me punësimin në rritje në zonat turistike.

32. Të ardhurat që vijnë nga turizmi dhe që pasqyrohen në bilancin e pagesave, krijojnë mundësinë e përdorimit të tyre në zhvillimin e zonave të rëndësishme.

Gjatë vitit 2008 numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur 26 % krahasuar me vitin 2007 (këta kryesisht nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi).

A.ii.11. Transporti

33. Transporti ajror civil ndërkombëtar kryhet nëpërmjet aeroportit “Nënë Tereza” në Rinas (Tiranë) i vetmi aeroport që kryen transport të këtij lloji. Gjatë vitit 2008 në këtë aktivitet kanë operuar 18

shoqëri ajrore, nga të cilat 16 të huaja dhe 2 të përbashkëta. Aktiviteti në rritje i transportit ajror ka bërë që numri i fluturimeve dhe ai i pasagjerëve të transportuar në vitin 2008 të jetë respektivisht 5,5 dhe 13,7% më i lartë në krahasim me vitin 2007.

34. Transporti detar në Shqipëri kryhet nëpërmjet 4 porteve: Durrësi, Vlora, Saranda dhe Shëngjini. Volumi i ngarkim - shkarkimit të porteve në vitin 2008 ka qenë 8,6% më i lartë se ai i vitit 2007. Porti më i madh dhe më i rëndësishëm është ai i Durrësit, i cili për vitin 2008 realizoi 79 % të volumit të ngarkim - shkarkimit të të gjitha porteve.

Transporti detar ndërkombëtar i pasagjerëve ka shënuar një rritje prej 16,8 % në 2008 në krahasim me vitin 2007.

35. Gjatësia e linjës hekurudhore në shfrytëzim, në vitin 2008 ka qenë 399 kilometra. Transporti hekurudhor në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007 ka shënuar një ulje të volumit të punës në transportin e mallrave prej 11 %. Ndërkohë, transporti e pasagjerëve ka pasur një rënie të volumit të punës prej 24,6 %, krahasuar me 2007.

36. Gjatësia e naftësjesve në vitin 2008 ishte afro 0,3 herë më e vogël se ajo e vitit 1993. Volumi i transportit të naftës me tubacion, i shprehur në ton-kilometra në vitin 2008 pësoi një rënie prej 15,3 % në krahasim me vitin 2007.

Përdorimi gjithnjë e më shumë i transportit rrugor privat u shoqërua me një numër të madh mjetesesh rrugore të cilat shënuan një rritje prej 8,13 % në vitin 2008, krahasuar me vitin 2007. Në veçanti numri i veturave të pasagjerëve në vitin 2008 u rrit 11,3% në krahasim me vitin 2007. Në vitin 2008, numri i aksidenteve në trafikun rrugor ka shënuar ulje të ndjeshme të të aksidentuarve, krahasuar ky me vitin 2007.

A.ii.12. Tregtia e jashtme

37. Viti 2008, krahasuar me një vit më parë, ka pasur një rritje si të eksportit ashtu edhe të importit. Rritja e importit (16,9%) ishte më e madhe se rritja e eksportit (15,8%). Gjatë atij viti ka pasur një përkeqësim të bilancit tregtar rreth 17,3%. Pjesa më e madhe e tregtisë ka vazhduar të kryhet me vendet e BE (64,6 %). Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, edhe për këtë vit, kanë vazhduar të mbeten Italia dhe Greqia.

38. Karakteristikë e eksporteve shqiptare është rieksporimi pas përpunimit të lëndës së parë. Kjo pasqyrohet në grupin “Tekstile dhe Këpucë”, eksporti i të cilit zë 43,4% të totalit të eksportit.

Treguesit kulturorë

A.ii.13. Kultura

39. Për vetë karakterin shoqëror dhe specifik që kanë, institucionet dhe aktivitetet e Kulturës dhe Artit janë të lidhura gjithmonë me mbështetjen e shtetit, sidomos atë financiare (e cila varet nga niveli i zhvillimit ekonomik të vendit).

40. Aktualisht kultura dhe arti vazhdojnë të mbeten në një situatë të vështirë, e cila kufizon zhvillimin e mjaft aktivitete të rëndësishme, si: teatrot, estradat, prodhimi dhe shfaqjen e filmave, mbrojtjen e shumë monumenteve të kulturës etj. Në vitet e fundit ka pasur përpjekje nga disa institucione të rëndësishme kombëtare për të dalë nga kjo gjendje dhe për të gjetur si identitetin ashtu edhe vizitorin e spektatorin.

41. Në gjashtë vitet e fundit më me sukses paraqitet ngritja e stacioneve televizive dhe të radiove private, megjithëse ato janë kthyer në konkurrentet më të mëdha dhe më të suksesshme në fushën e kulturës dhe të artit.

B. Kuadri i përgjithshëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut

B.i. Kuadri kushtetues dhe ligjor

42. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton dhe siguron respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Të pesëmbëdhjetë nenet e parë të këtij dokumenti, konfirmojnë parimet themelore kushtetuese, të cilat përligjin ndër të tjera: sovranitetin e popullit, zbatimin e sistemit të zgjedhjeve të lira (të barabarta, të përgjithshme dhe periodike), shtetin e së drejtës, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, autonominë dhe decentralizimin e pushtetit në qeverisjen vendore; sistemin ekonomik, balancimin e pushteteve, natyrën laike të shtetit, simbolet kombëtare etj.

43. “Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut” përkufizohen në nenin 15 të Kushtetutës si “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, të cilat janë në themel të rendit juridik”. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, ngarkohen t’i respektojnë ato dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Përmbajtja e kësaj dispozite në Kushtetutë i referohet nenit 1 të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (e cila është nënshkruar nga RSH më 13.07.1995, 4354

ratifikuar më 31.07.1996 dhe hyrë në fuqi më 2.10.1996).

44. Neni 16 i Kushtetutës parashikon shprehimisht se “të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë, vlejnë njëloj edhe për shtetasit e huaj e për personat pa shtetësi në territorin e RSH”. Përfshirje bëhet vetëm për rastet kur ushtrimi i liritë dhe të drejtave lidhet në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare.

45. Kufizimi i liritë dhe i të drejtave të personit bëhet në mbrojtje të interesit publik. Paragrafi 2 i nenit 17 përcakton se këto kufizime “nuk duhet të cenojnë thelbin e liritë dhe të të drejtave” dhe mbi të gjitha “të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”. (neni 18 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut)

46. Neni 21 i Kushtetutës parashikon shprehimisht se “Jeta e personit mbrohet me ligj”. Pavarësisht se legjislatori është mjaftuar me këtë sanksionim të jetës së personit, në të vërtetë ato që mbrohen me ligj janë të drejtat dhe liritë vetjake që i jepen këtij personi që me lindjen e tij.

Tagrat që i njihen çdo personi apo individ, parashikohen nga Kushtetuta në dispozita dhe krerë të veçantë.

Kreu II - “Liritë dhe të drejtat vetjake”, ku përfshihen: e drejta e jetës së personit (neni 21); liria e shprehjes, shtypit, radios dhe televizionit (neni 22); e drejta për informim (neni 23); liria e ndërgjegjes dhe fesë (neni 24); mosnënshtrimi ndaj torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtëruës (neni 25); ndalimi i punës së detyruar (neni 26); liria personale (neni 27); e drejta për një proces të rregullt gjyqësor penal (nenet 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35); liria e korrespondencës (neni 36); paprekshmëria e banesës (neni 37); e drejta për të zgjedhur vendbanimin dhe lëvizur lirisht (neni 38); ndalimi i dëbimit dhe dëbimit kolektiv (neni 39); e drejtën e pronës private (nenet 41 dhe 42); e drejta e ankimit në gjykatë dhe dëmshpërblimit (nenet 43 dhe 44);

Kreu III - “Liritë dhe të drejtat politike”, ku përfshihen: e drejta për t’u zgjedhur dhe për të zgjedhur (neni 45); e drejta e anëtarësimit në organizata dhe shoqata (neni 46); e drejta e tubimeve dhe e pjesëmarrjes në to (neni 47);

Kreu IV - “Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, ku përfshihen: e drejta e zgjedhjes së profesionit (neni 49); e drejta e pjesëmarrjes në organizata sindikaliste (neni 50); e drejta e grevës (neni 51); e drejta e sigurimeve shoqërore (neni 52); e drejta e familjes (neni 54); e drejta e kujdesit shëndetësor (neni 55) si dhe e drejta për arsim (neni 57).

47. Kushtetuta, në nenin 59 të saj, përcakton ndër objektivat sociale të shtetit shqiptar i) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë; ii) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim; iii) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm; iv) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë; v) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

48. Në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë (në vijim Kuvendi), Këshillit të Ministrave (në vijim KM) apo dhe institucioneve të tjera shtetërore, janë miratuar një korpus i tërë aktesh normative, i cili ka si qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Disa prej këtyre akteve janë: Kodi Penal (1995- i ndryshuar); Kodi i Procedurës Penale (1995- i ndryshuar); Kodi Civil (1994- i ndryshuar); Kodi i Procedurës Civile (1995- i ndryshuar); Kodi i Punës (1995- ndryshuar); Kodi i Procedurave Administrative (1999); Kodi i Familjes (2003), Kodi Zgjedhor (2008); Ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar (1995); Ligji “Për të Drejtën e Tubimeve” (1996); Ligji për Shtypin (1997); Ligji “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat” (1998); Ligji për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim (1998- i ndryshuar); Ligji për Ekzekutimin e Vendimeve Penale (1998); Ligji “Për Azilin në RSH-së” (1998- i ndryshuar); Ligji “Për Avokatin e Popullit” (1999- i ndryshuar); Ligji për Partitë Politike (2000); Ligji “Për Funkcionimin e Policisë Gjyqësore” (2000- i ndryshuar); Ligji “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në RSH-së” (2001- i ndryshuar); Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” (2001- i ndryshuar); Ligji “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në RSH-së” (2002); Ligji “Për Profesionin e Avokatit” (2003 - i ndryshuar); Ligji “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë” (2004); Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (2005); Ligji “Për masat ndaj dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (2006); Ligji “Për Policinë e Shtetit” (2007), Ligji “Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve” (2007); Ligji “Për Funkcionimin e Pushtetit Gjyqësor (2008); Ligji “Për Shërbimin e Përmbarimit Gjyqësor Privat” (2008); Ligji “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (2008); Ligji “Për të huajt” (2008); Ligji “Për policinë e burgjeve” (2008); Ligji “Për Ndihmën Juridike” (2008); Ligji “Për barazinë gjinore në

shoqëri” (2008); Ligji “Për Shëndetin Publik (2009).

B.ii. Zbatimi i normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

49. Neni 5 i Kushtetutës përcakton detyrimin e shtetit shqiptar për të zbatuar të drejtën ndërkombëtare. Në RSH e drejta ndërkombëtare gëzon një pozitë të privilegjuar në raport me të drejtën e brendshme. Mbështetur në nenin 122 të Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Kuvendi bëhet pjesë e së drejtës së brendshme, pasi botohet në Fletoren Zyrtare. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe aplikimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit të cilët nuk pajtohen me të. Në të gjitha rastet e konfliktit të së drejtës së brendshme me normat e nxjerra nga organizatat ndërkombëtare dhe të ratifikuara nga Shqipëria, si pjesëmarrëse në to, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të këtyre të fundit.

50. Shqipëria ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Këtë fakt e ka dëshmuar gjithashtu ratifikimi apo aderimi në një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

51. Lista e marrëveshjeve ndërkombëtare, të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë me organizmat ndërkombëtarë, si: KE, OKB, ILO, UNESCO, HCCH, në kuadrin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjendet në aneksin e këtij raporti (me të njëjtin indeks).

C. Procesi i raportimit në nivel kombëtar

C.i. Metodologjia e ndjekur për hartimin e Raportit Kombëtar Periodik

52. Raporti Periodik i Republikës së Shqipërisë, në kuadrin e Konventës së OKB “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial”, është hartuar në përputhje me nenin 9 të asaj Konvente, kërkesat e dokumenteve CERD/C/2007/1 (datë 13.06.2008) dhe CERD/C/63/CO/1 (datë 10.12.2003), ku ky i fundit lidhet drejtpërdrejt me vëzhgimet dhe rekomandimet e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racial, dalë pas shqyrtimit të raportit I – IV të Qeverisë Shqiptare.

53. Në këtë kuadër dhe në zbatim të urdhrat të Kryeministrit nr. 201, datë 5.12.2007 “Për ngritjen e grupit të punës “Për hartimin e raporteve kombëtare në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare”” u ngrit grupi ndër-institucional i punës, i cili përfshinte specialistë të fushës nga: Ministria e Brendshme; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës; Radiotelevizioni Shqiptar; Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit; Zyra e Avokatit të Popullit; Instituti i Statistikave; Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

C.ii. Institucione të tjera dhe mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

54. Njësia për Parandalimin e Torturës - pranë Avokatit të Popullit, është krijuar në vitin 2008 në bazë të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim””, dhe ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim.

55. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve (në vijim KSHM) – është një institucion qendror, me personalitet juridik dhe në varësi të Kryeministrit. Ai bashkëpunon me organet e qeverisjes qendrore dhe/ose vendore, organizatat e shoqatave të ligjshme, të cilat veprojnë në vend në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe të lirive të personave u përkasin minoriteteve.

Komiteti propozon masa konkrete për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe arsimor të minoriteteve, duke kontribuar për përmirësimin e gjendjes së minoritarëve, kudo ku ata jetojnë.

Në përbërjen e tij ka përfaqësues të minoriteteve kombëtare (minoriteti grek, maqedonas, serb dhe malazez) dhe gjuhësore (rom dhe vllah/arumun). Gjatë kësaj periudhe Komiteti ka arritur të evidentojë dhe të parashtrojë pranë qeverisë problematikat, me të cilat ballafaqohen minoritetet, duke sugjeruar njëkohësisht dhe zgjidhjet përkatëse.

56. Sektori i të Drejtave të Njeriut, Minoriteteve dhe Raportimeve - në Ministrinë e Punëve të Jashtme ndjek përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve. Ndër të tjera, në bashkëpunim me institucionet e linjës, ky sektor ndjek paralelisht edhe koordinimin e zbatimit të politikave mbi minoritetet.

Ai ka si objektiv zhvillimin e dialogut zyrtar me përfaqësuesit e shoqatave të minoriteteve, nxitjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të shoqatave të tyre, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre gjuhësor, kulturor, fetar dhe kombëtar.

57. Komiteti Ndërmnishtor për të Drejtat e Fëmijëve - i cili funksionon prej vitit 2007 si organ këshillimor pranë Këshillit të Ministrave, garanton përfshirjen e politikave për respektimin e të drejtave të

fëmijëve në politikat e zhvillimit. Ky Komitet është autoriteti më i lartë që monitoron zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët dhe planit të saj të veprimit.

58. Komiteti Drejtues Kombëtar “Për eliminimin e punës së fëmijëve”⁵ - i cili drejtohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është struktura më e lartë për integrimin e çështjes së punës së fëmijëve në hartimin e politikave kombëtare. Pranë Ministrisë së Punës është krijuar “Njësia për Eliminimin e Punës së Fëmijëve”, e cila monitoron situatën e punësimit të fëmijëve.

Këto struktura janë krijuar në kuadrin e Programit Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC).

Inspektorati Shtetëror i Punës siguron zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet shtetërore dhe private, përfshirë edhe kontrollin e punës të të miturve.

59. Sekretariati Teknik për Fëmijët (STF)⁶ - ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijë dhe planit të saj të veprimit, si dhe koordinon bashkëpunimin me ministrinë, institucione të tjera qendrore, qarqet, bashkitë, komunat, organizatat dhe ofruesit e shërbimeve për fëmijë etj. Njësitë për Mbrotjtjen e të Drejtave të Fëmijëve në nivel qarku dhe bashkie kanë si detyrë zbatimin e kuadrit ligjor dhe politikave për mbrotjtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal.

60. Sekretariati Teknik për Romët⁷ - pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ka për detyrë: i) të ndjekë monitorimin e zbatimit të objektivave, masave prioritare të përcaktuara në strategjinë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”; ii) nxitjen dhe ndërgjegjësimin e institucioneve, strukturave rajonale dhe pushtetit vendor për t’u përfshirë në zbatimin e strategjisë së komunitetit rom; iii) vendosjen dhe mbajtjen e kontakteve me ministrinë e linjës, institucionet përgjegjëse të përfshira në zbatimin e strategjisë, shoqatat e komunitetit rom dhe OJF-të e ndryshme që veprojnë në fushën e minoriteteve për zbatimin e strategjisë; iv) bashkëpunimi me donatorë dhe OJF-të për fuqizimin e kapaciteteve të sektorit dhe të institucioneve në nivel qendror, rajonal dhe lokal për zbatimin e strategjisë.

61. Grupi Ndërmnistror i Punës për ndjekjen dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”⁸ – është ngritur në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të VKM nr. 633, datë 18.09.2003 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom””. Grupi kryesohet nga zëvendësministri i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe në përbërje ka 11 anëtarë.

62. Ndër të tjera, në detyrat e këtij grupi përfshihen: i) mbikëqyrja dhe zbatimi i strategjisë “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom” dhe vlerësimin e ndikimit të politikave dhe efekteve financiare; ii) bashkëpunimi dhe nxitja e institucioneve përgjegjëse për implementimin e Strategjisë Kombëtare për Romët; iii) ndjekja e progresit të treguesve të monitorimit që përcaktohen në strategjinë e komunitetit rom, për të gjitha ministrinë dhe institucionet e tjera të varësisë; iv) bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe donatorë të ndryshëm për sigurimin e fondeve të nevojshme dhe realizimin e objektivave të kësaj strategjie; v) orientimi dhe dhënia e rekomandimeve për raportet e përgatitura nga Sekretariati Teknik, lidhur me zhvillimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë fushë.

Strukturat qeveritare përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje

63. Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore - Autoriteti përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, sipas nenit 13 të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, është ministri që mbulon këto çështje (aktualisht Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta). Ministri realizon detyrat e përcaktuara në ligj, si dhe mbikëqyr veprimtarinë për çështjet e barazisë gjinore nëpërmjet strukturës që ai ka për këtë qëllim.

64. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta - sipas ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

65. Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta (DPSHB) - pranë Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, funksionon që prej vitit 2006 si struktura përgjegjëse për barazinë

⁵ Krijuar në vitin 2001, pranë MPÇSSHb

⁶ Krijuar në vitin 2006, pra në MPÇSSHb

⁷ Krijuar me urdhërin nr. 231/2, datë 22.06.2004 të Minstrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

⁸ Krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.37, datë 09.03.2009

gjinore dhe dhunën në familje. DPSHB përbëhet nga dy sektorë: i) Sektori i Barazisë Gjinore dhe ii) Sektori për Masat ndaj Dhunës në Familje.

Ajo është struktura përgjegjëse për “të nxitur barazinë gjinore dhe një pjesëmarrje të gjerë të gruas në jetën ekonomike, politike e kulturore të vendit”, si dhe të “parandalimit dhe luftës kundër dhunës në familje”.

66. Në zbatim të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” struktura të tjera përgjegjëse janë të gjitha institucionet shtetërore: në nivel qendror (ministritë me institucionet vartëse të tyre) dhe nivel vendor (qarqet, bashkitë, komunat), si dhe nëpunësit për çështjet e barazisë gjinore në strukturat qendrore dhe vendore të linjës.

Organet këshillimore

67. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore - ngritur në zbatim të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” me urdhrin nr. 3 (të Kryeministrit) datë 8.01.2009 “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”, funksionon si organ këshillimor për politikën gjinore dhe është një strukturë që sugjeron politikën që garantojnë integritetin gjinor.

68. Grupi i Punës Ndërinstitucional (GPNI) – është ngritur në mbështetje të ligjit nr.9970, datë 24.07.2008 dhe me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 2498, datë 16.12.2008 (ndryshuar me urdhrin nr. 2271, datë 8.12. 2009), dhe vepron si grup këshillimor në sigurimin e statistikave dhe indikatorëve gjinorë, në mbështetje të politikave të monitorimit të barazisë gjinore në Shqipëri.

69. Në nivel parlamentar, çështjet gjinore trajtohen në Komisionin Parlamentar të Shëndetësisë, Punës dhe Çështjeve Sociale.

70. Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore - i kryesuar nga Ministri i Brendshëm, ka në përbërjen e tij përfaqësues të lartë të nivelit politik të institucioneve qendrore dhe është përgjegjës për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit.

71. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore⁹ - koordinon punën ndërmjet ministrive të linjës, strukturave të tjera shtetërore dhe joshetërore në nivel kombëtar e ndërkombëtar, në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Pranë kësaj zyre funksionon dhe Njësia Antitrafik.

Komitetet Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, të krijuara prej vitit 2006 në 12 qarqet e vendit, kanë si qëllim mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e veprimeve qeveritare e joqeveritare në nivel rajonal/vendor, për parandalimin e fenomenit të trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të mundshme të trafikimit. Në nivelin administrativ funksionojnë struktura të posaçme në polici për të luftuar krimin e organizuar dhe trafikun e paligjshëm.

72. Sektori për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje - funksionon në nivel qendror prej vitit 2007. Në nivel rajonal, pranë Drejtorive të Policive në qarqe janë krijuar Seksionet për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje.

Këto struktura kanë për detyrë mbrojtjen e të miturve dhe parandalimin e dhunës ndaj tyre në familje, si dhe mbrojtjen e të miturve nga aktivitetet kriminale.

73. Shërbimi Social Shtetëror - është institucion ekzekutiv i politikave dhe legjislationit në fushën e mbrojtjes sociale.

74. Shërbimi Kombëtar i Punësimit - ndjek zbatimin e ligjit lidhur me punësimin, formimin e kualifikimit profesional, si dhe ndjek politikën aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin e plotë dhe të zgjedhur lirisht.

75. Inspektorati Shtetëror i Punës - ka si qëllim zbatimin e legjislationit të punës nga subjektet, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit në punë.

76. Instituti i Shëndetit Publik – ka për detyrë monitorimin e situatave të shëndetit publik në vend dhe marrjen e masave për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve, dëmtimeve, paaftësive, faktorëve dëmtues shëndetësorë të mjedisit, zhvillimin dhe aplikimin e promocionit të shëndetit.

77. Në fushën e arsimit, strukturat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës kanë si mision të sigurojnë një sistem arsimor bazë për të gjithë sistem arsimor cilësor të integruar me kërkimin shkencor, që mundëson shanse të barabarta për individët, duke synuar arritjen e standardeve ndërkombëtare.

C.iii. Kuadri ligjor që garanton mosdiskriminimin, barazinë dhe dëmshpërblimin efektiv

⁹ Krijuar në vitin 2005

78. Neni 16 i Kushtetutës së RSH-së përcakton shprehimisht se “të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë, vlejnë njëjloj edhe për shtetasit e huaj e për personat pa shtetësi në territorin e RSH-së”. Përjashtim bëhet vetëm për rastet kur ushtrimi i liritë dhe të drejtave lidhet në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare. Kjo dispozitë ofron të njëjtat garanci lidhur me ushtrimin e liritë dhe të drejtave nga personat juridikë, për aq kohë sa ato përputhen me qëllimet e përgjithshme të tyre.

79. Parimi kushtetues: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” parashikohet në nenin 18/1. Në mbështetje të tij, paragrafi vijues sanksionon mosdiskriminim të padrejtë, për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare e filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore, të të gjithë personave që jetojnë dhe punojnë në territorin e Shqipërisë. Në çdo rrethanë tjetër, kufizimi i ushtrimit të të drejtave për shkaqet e sipërpërmendura, shihet i lidhur ngushtësisht me qëllimet e veprimeve të subjektit të Konventës kuadër, dhe padyshim me objektin e veprimeve të kundërligjshme, nëse këto parashikohen si të tilla nga ligji.

80. Këto dy dispozita vendosin shenjë e barazisë lidhur me ushtrimin e të drejtave dhe liritë si për shtetasit shqiptarë, pakicat kombëtare, shtetasit e huaj ashtu sikurse dhe për personat pa shtetësi. Duke qëndruar në të njëjtën linjë, kjo shenjë barazie vendoset edhe nga neni 3 i Kodit Civil të RSH (në vijim KC).

81. Neni 1/b i Kodit Penal (në vijim KP) “Detyrat e legjislacionit penal”, përcakton si detyra të legjislacionit penal të RSH “mbrojtjen e pavarësisë së shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”. Kjo dispozitë e vë theksin në rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave dhe liritë të njeriut, në kuadër të zhvillimit, sigurimit të bashkëjetesës dhe mirëkuptimit me pakicat kombëtare.

82. Neni 9 i Kodit të Punës në RSH (në vijim K.Punës), sanksionon në mënyrë të prerë ndalimin e çdo lloj diskriminimi të marrjes në punë. Shprehur ndryshe, ligji ndalon çdo dallim, përjashtim ose parapëlqim, të mbështetur mbi bazën e ngjyrës, seksit, moshës, fesë, bindjeve politike, origjinës kombëtare, origjinës shoqërore, lidhjeve familjare, të metave fizike ose mendore, të cilat cenojnë të drejtën e punëtorit imigrant, për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim.

Dallimet, përjashtimet ose parapëlqimet që kërkohen për një vend pune të caktuar, nuk konsiderohen si diskriminime.

83. Sipas nenit 11 të Kodit të Procedurave Administrative (në vijim KPr.A) “Në marrëdhëniet me personat privatë, administrata publike udhëhiqet nga parimi i barazisë në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohet apo diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare apo filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore”. Parimi i “trajtimin të barabartë” nuk është një mohim i diskrecionit të organeve të administratës. Qëllimi i tij është që administrata ta ushtrojë këtë diskrecion në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët.

84. Në vijim listojmë disa prej ligjeve të hartuara dhe të miratuara gjatë periudhës së viteve 2002 – ‘08, dispozitat e të cilave sanksionojnë sjelljet e veprimet diskriminuese.

-Ligji nr. 8960, datë 24.10.2002 “Për ratifikimin e Kartës Sociale Europiane, e ndryshuar”, parashikon se të gjithë personat me përgjegjësi familjare dhe që janë angazhuar ose dëshirojnë të angazhohen në punësim, kanë të drejtë ta bëjnë këtë pa iu nënshtroar diskriminimit dhe, sa të jetë e mundur, pa konflikt ndërmjet përgjegjësisë të tyre familjare dhe të punësimit. Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë garantohet pa diskriminim, të çfarëdo shkakut të tillë, si race, ngjyre, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër.

-Ligji nr. 9090, datë 26.06.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” parashikon se gjykata ose prokuroria mund ta vlerësojë marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim të pavlefshëm, kur arrin në përfundimin se nuk pasqyrohet vullneti i palëve në konflikt, kur janë cenuar rëndë të drejtat dhe interesat e tyre ose kur zhdëmtimi është haptazi në disproporcion me dëmin e shkaktuar.

-Ligji nr. 9280, datë 23.9.2004 “Për shpalljen e “Ditës së Kujtesës”” përcakton datën 27 janar si “Dita e Kujtesës”, e cila do të përkujtohet si dita e nderimit të të gjithë atyre që kanë ndihmuar për mbrojtjen fizike të hebrenjve në Shqipëri dhe të vetë shtetasve shqiptarë të kërcënuar nga rreziku i zhdukjes fizike, burgosjes, internimit, dëbimit dhe spastrimit etnik. “Dita e kujtesës” është ditë homazhi dhe reflektimi për cilindo që ka qenë objekt i dhunës kolektive, në formën e etnocidit, gjenocidit dhe aparteidit.

-Ligji nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për sportin” parashikon se të ushtruarit e sportit është një e drejtë

e të gjithë shtetasve në RSH, duke parandaluar kështu çdo lloj diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe si: bindjet politike apo fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, gjendja ekonomike ose shoqërore. Ndër të tjera në ligj sanksionohet se “gjatë veprimtarive sportive të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik apo në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohej provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar apo gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive ose/dhe ndaj spektatorëve”.

-Ligji nr.9547, datë 01.06.2006 “Për ratifikimin e Konventës nr. 168 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia:”, 1988) parashikon detyrimin e shtetit shqiptar, si shtet anëtar në Konventën kuadër, për marrjen e masave të duhura, me qëllim koordinimin e sistemeve të mbrojtjes kundër papunësisë dhe politikës së punësimit. Në kushtet aktuale të tregut të punës, strukturat shtetërore duhet të sigurojnë barazi trajtimi për të gjithë personat, pa diskriminim në bazë race, seksi, besimi, opinion politik, prejardhje kombëtare, shtetësie, origjine etnike ose sociale, paafësisë ose moshës.

-Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008 ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore. Po ashtu ky ligj garanton mbrojtjen me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Në përputhje me këtë ligj, “dhunë konsiderohet çdo veprim, apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”.

-Ligji nr.9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” ka për qëllim mbrojtjen e fëmijës nëpërmjet vendosjes në një familje të përhershme, duke marrë masa që kjo mbrojtje të bëhet në interesin më të lartë të fëmijës. Ndër të tjera, paragrafi 2 i nenit 33 parashikon se agjencitë ndërmjetëse në fushën e birësimit duhet të mos paragjykojnë dhe të mos diskriminojnë aplikantët birësues, pavarësisht nga raca, origjina apo bindjet e tyre fetare.

-Ligji nr.9773, datë 12.07.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për punëtorët me përgjegjësi familjare, C 156, 1981””. Dispozitat hyrëse të kësaj Konvente ngarkojnë shtetin shqiptar me detyrimin për të garantuar barazinë efektive të mundësive dhe trajtimit të punëtorëve, burra dhe gra. Kjo barazi u garanton personave me përgjegjësi familjare, të cilët janë të angazhuar ose dëshirojnë të angazhohen në punë, ushtrimin e së drejtës për të realizuar një gjë të tillë pa u diskriminuar dhe pa konflikt, ndërmjet profesionit dhe përgjegjësisë familjare. Në përputhje me nenet 1 dhe 5 të Konventës së Diskriminimit (Punësimi dhe Profesionit) të vitit 1958, ligji përcakton përkufizimin e termit “diskriminim”, i cili nënkupton diskriminimin në punë dhe profesion.

-Ligji nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëshmipërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” ka si qëllim dhënien e dëshmipërblimit financiar nga shteti shqiptar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist, të mbetur gjallë, për familjarët e viktimave të ekzekutuara dhe personat e internuar ose të dëbuar në kampe. Po ashtu ligji konfirmon angazhimin e shtetit demokratik në dënimin e krimeve të regjimit totalitar komunist dhe garantimin e një jete më të mirë për personat që i mbijetuan atij.

-Ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” parashikon se autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që përbën diskriminim ndaj ose ndërmjet kandidatëve blerës apo ndaj kategorive të tyre me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pjesëmarrësve në procedurën e ankandit.

-Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili përcakton rregullat për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, parashikon rregulla të veçanta për të dhënat personale të personit fizik (ose si quhen ndryshe në këtë ligj “të dhëna sensitive”), që kanë të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

-Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” ka për qëllim promovimin e konkurrencës dhe infrastrukturës efikente në komunikimet elektronike si dhe garantimin e shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në territorin e RSH, duke synuar sigurimin e transparencës, ndershmërisë dhe të mosdiskriminimit të përdoruesve të tyre.

-Ligji nr.9946, datë 30.06.2008 “Për sektorin e gazit natyror” përcakton rregullat që mundësojnë ekzistencën e një tregu konkurrues dhe të integruar me tregjet rajonale/ evropiane, për një shërbim me cilësi të lartë dhe me kosto të arsyeshme, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të personave fizikë dhe juridikë për këto veprimtari, pa asnjë lloj diskriminimi.

-Ligji nr.9952, datë 14.07.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”, parashikon rregullat për parandalimin dhe kontrollin në marrjen e masave për HIV/AIDS-in, kujdesin, trajtimin dhe mbështetjen e personave të infektuar me HIV/AIDS, pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të etnisë, gjinisë, racës etj.

-Ligji nr.9959, datë 17.07.2008 “Për të huajt” përcakton regjimin e hyrjes, qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve në/nga territori i RSH. Në nenin 2 të këtij ligji parashikohet se të huajt që janë subjekt i tij, duhet të trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, duke respektuar parimin e reciprocitetit, mosdiskriminimit dhe trajtimit më pak të favorshëm se shtetasit shqiptarë. Ndër të tjera, ligji parashikon se institucionet publike dhe OJF-të u ofrojnë të huajve mbrojtje kundër çdo lloj forme diskriminimi, në të gjitha veprimtaritë ku marrin pjesë këta të fundit. Ligji sanksionon diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë nga personat juridikë, publikë dhe privatë, gjatë të gjithë procesit të migrimit për punësim. Në rastet e dëbimit, ligji parashikon se i huaji nuk mund të jetë subjekt i një urdhri dëbimi, në rast se ka arsye të bazuara për të dyshuar se i huaji, në vendin e origjinës apo në një vend tjetër, do të dënohet me vdekje, nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimeve për shkaqe diskriminuese.

-Ligji nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, mundësive dhe shanseve të barabarta në ushtrimin e të drejtave, si dhe pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. Gjithashtu, dispozitat e këtij ligji parashikojnë detyrimin e strukturave shtetërore kompetente për të garantuar mbrojtje efikase nga diskriminimi, për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për të njëjtin shkak. Ky ligj sanksionon veprimet dhe mosveprimet diskriminuese për shkak të gjinisë, në fushën e arsimit, formimit profesional dhe në media.

-Ligji nr.10002, datë 6.10.2008 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Brendshme” në nenin 43 të tij, parashikon shprehimisht se “Punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm ka për detyrë t’i trajtojë personat në mënyrë të barabartë dhe t’i kryejë detyrat pa diskriminim, në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara, si dhe të respektojë dinjitetin dhe integritetin fizik të çdo punonjësi tjetër të shërbimit”.

Në këtë mënyrë parandalohet çdo veprim i punonjësve të kësaj fushe, i cili mund të shkaktojë shkelje të integritetit dhe dinjitetit të individëve.

-Ligji nr.10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1999 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar” dhe ligji nr. 10054, datë 29.12.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale” i ndryshuar” parashikojnë dispozita materiale dhe procedurale lidhur me kryerjen, ndjekjen dhe ndëshkimin e veprave penale që lidhen me racizmin dhe diskriminimin në sistemet kompjuterike, me qëllim penalizimin e shpërndarjes së materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 4 i protokollit) dhe fyerjes për motive raciste dhe ksenofobike (neni 5 i protokollit).

-Ligji nr.10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike” synon rregullimin ligjor të institutit të “dhënies së ndihmës juridike” që shteti u ofron personave me mundësi të pamjaftueshme ekonomike, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të tyre të ligjshme në gjykata apo organe të tjera shtetërore. Dhënia e ndihmës juridike nga shteti për individët mbështetet në parimin e barazisë së të drejtave për të gjithë individët, që përfitojnë nga ndihma juridike. Ligji parashikon një dallim pozitiv në dhënien e ndihmës juridike duke u mbështetur në kushtet ekonomike të individit; kjo për ata individë të cilët për arsye ekonomike nuk janë në gjendje të sigurojnë konsulencën juridike apo mbrojtjen ligjore para organeve të drejtësisë.

Po ashtu ndër të tjera:

-Ligji “Për arsimin parauniversitar”¹⁰, në nenin 3 të tij sanksionon se “shtetasit e RSH gëzojnë të drejta të barabarta për t’u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimit që përcakton ky ligj, pavarësisht nga gjendja sociale, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik”.

-Ligji “Për nxitjen e punësimit”¹¹ parashikon se punëtorët imigrantë të huaj dhe pa shtetësi, gëzojnë të njëjtat të drejta si shtetasit shqiptarë lidhur me punësimin në territorin shqiptar. Në këtë kategori

¹⁰ Miratuar me ligjin nr.7952, datë 21.06.1995, ka pësuar ndryshime me ligjin e vitit 1998

¹¹ Miratuar me ligjin nr.7995, datë 20.09.1995, ka pësuar ndryshime me ligjet e miratuara në vitet 1999, 2002 dhe 2006

përfshihen të gjithë punëtorët imigrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre, qofshin këta shtetas apo jo të vendeve me të cilat RSH ka nënshkruar marrëveshje punësimi. Personat e huaj dhe ata pa shtetësi, që martohen me shtetas shqiptarë, gëzojnë të njëjtat të drejta si shtetasit shqiptarë, me kusht që të jenë rezident në RSH. (neni 3/2)

-Ligji “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”¹² sanksionon ndalimin e diskriminimit midis shtetasve shqiptarë, të cilët dëshirojnë të emigrojnë jashtë vendit. Shprehimisht në këtë paragraf parashikohet se “Çdo shtetas shqiptar gëzon të drejtën e mundësive dhe të të trajtimit të barabartë për të emigruar, pa dallim race, ngjyre, seksi, etnie, besimi fetar, bindjeje politike apo origjine sociale”.(neni 5/4)

85. Mbështetur në nenin 43 të Kushtetutës së RSH, çdo shtetasi shqiptar ose të huaj i garantohet e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Neni vijues parashikon dëmshpërblimin efektiv të subjekteve, në rast se ato dëmtohen nga një akt, veprim ose mosveprim i paligjshëm i organeve shtetërore.

86. Rivendosja e të drejtave në një proces penal parashikohet nga neni 9 i KPr.P Në zbatim të tij, çdo subjekti të proceduar në kundërshtim me ligjin ose të dënuar pa të drejtë i kthehen të gjitha të drejtat dhe shpërblehet për dëmin e pësuar.

87. Në seksionin II të KP “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” (kreu VIII “Krim kundër autoritetit të shtetit”), neni 253 (“Shkelja e barazisë së shtetasve”) parashikon se “kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, gjendjes shëndetësore, bindjeje fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegieve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”.

88. Me qëllim parandalimin e çdo veprimi ose mosveprimi arbitrar që do të cenonte lirinë e individit, të kryera nga një punonjës me funksion shtetëror ose publik, në KP janë parashikuar disa dispozita dhe konkretisht: neni 248 “Shpërdorimi i detyrës”, neni 249 “Kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij”, neni 250 “Kryerja e veprimeve arbitrare”, neni 251 “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”:

89. Sipas nenit 608 i KC (Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit), kur një person i shkakton tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij në mënyrë të paligjshme dhe me faj, ai detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Në nenin 30 të KPr.C, rehabilitimi dhe zhdëmtimi i palëve lidhen me publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës. Sipas kësaj dispozite, çdo person ka të drejtë ti kërkojë gjykatës publikimin e vendimit në media. Kur ky njoftim nuk jepet në afatin e caktuar nga gjykata, subjekti ka të drejtë të kërkojë publikimin e vendimit me shpenzimet e personit, ndaj të cilit ka fituar në procesin civil.

90. Kodi i Punës për rastet e mosmarrëveshjeve midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, në zbatim të kushteve të kontratës së punësimit, cakton gjykatën si organin kompetent për zgjidhjen e çështjes. Në bazë të nenit 170 të këtij Kodi, shkelja e të drejtave të subjektit punëmarrës parashikuar në kontratën e punësimit, dënohet nga gjykata me shlyerje të masës së dëmit dhe/ose gjobë.

91. Në bazë të nenit 5/5 të ligjit “Për të huajt”, çdo shtetas i huaj me qëndrim të ligjshëm në territorin shqiptar gëzon të drejtën e ankimit në një procedurë administrative/gjyqësore, si dhe të drejtën e dëmshpërblimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar. Mbështetur në nenin 71 të ligjit, i huaji gëzon të drejtën e ankimit në rast se ai është subjekt i një urdhri largimi nga shteti shqiptar.

92. Nenet 74 dhe 78 të ligjit parashikojnë të drejtën e të huajt për të ankimuar, brenda afatit të parashikuar nga ligji, përkatësisht “urdhrit e largimit me forcë” dhe “urdhrit e dëbimit”.

93. Dispozita 86/2 e këtij ligji (“Qëndrimin i detyrueshëm në një territor të caktuar”) i njeh gjithashtu të drejtën të huajt “të ankimojë në Gjykatën e Shkallës së I-rë, urdhrin e qëndrimit në një territor të caktuar.

Në secilin prej urdhrave të lëshuar vendoset informacioni lidhur me të drejtën e ankimit për secilin nga urdhrat, duke parashtruar dispozitat specifike që ia njohin këtë të drejtë.

94. Neni 90 i ligjit, i njeh shtetasit të huaj të drejtën për dëmshpërblim lidhur me ndalimin/mbajtjen e tij në një territor të caktuar në mënyrë të padrejtë. Dëmshpërblimi përfitohet nëse për

¹² Miratuar me ligjin nr. 9668, datë 18.12.2006

çdo urdhër ndalimi (në qendrën e mbyllur apo të detyrimit për qëndrim në një territor të caktuar) ka një vendim të formës së prerë nga gjykata, e cila i shpall këto akte të pavlefshme.

II. Zbatimi i dispozitave të neneve 1-7 të Konventës kuadër në Republikën e Shqipërisë

Neni 1

95. Në mbështetje të nenit 3 të Kushtetutës së RSH, shteti shqiptar dhe organet e tij janë përgjegjës kryesorë për krijimin, zbatimin e kuadrit të mbrojtjes së të drejtave e lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

Tre paragrafët e nenit 18 të Kushtetutës sanksionojnë detyrimin e shtetit për të garantuar: i) barazinë e të gjithë individëve/personave para ligjit; ii) se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si: gjinia, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindëror; dhe iii) se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin ii, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

96. Përkufizimi tjetër që përcakton termin “diskriminim” në legjislacionin shqiptar vjen tek në nëpërmjet nenit 9 të K. Punës. Sipas tij me diskriminim kuptohet “çdo dallim, përjashtim ose parapëlqim që bazohet në racë, ngjyrë, seks, moshë, fe, bindje politike, origjinë kombëtare, origjinë shoqërore, lidhje familjare, të meta fizike ose mendore që cenon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe trajtim”.

97. Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” ndalon diskriminimin gjinor. Përkufizimi që jep ligji mbi “Diskriminimin për shkak të gjinisë” nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin në mënyrë të barabartë, nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile. Dispozitat e ligjit ndalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

98. Masat e marra nga qeveria lidhur me këtë fenomen kanë të bëjnë me plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, në përputhje me angazhimet e ndërmarra nga shteti shqiptar pas anëtarësimit në konventat ndërkombëtare. (Aneks Tabela II.1/1) Gjithashtu ky kuadër është plotësuar me masat të veçanta (VKM, udhëzime dhe masa administrative), me qëllim zhvillimin e barabartë të të drejtave të individëve që ju përkasin grupeve të ndryshme etnike. (Aneks Tab. II.1/2)

99. Ligji “Për të huajt”¹³, hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83/1 të Kushtetutës dhe propozuar nga KM, parashikon dhe rregullon regjimin e hyrjes, trajtimit dhe daljes së të huajve (me statusin e imigrantit) në RSH. Ai përcakton qartë funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike dhe private, shqiptare dhe të huaja, që kanë të bëjnë me të huajt. (neni 1).

100. Mbështetur në aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, ligji garanton respektimin e të drejtave dhe liritë themelore të njeriut. Zbatimi i tij orientohet nga parimet e reciprocitetit, mosdiskriminimit dhe ofrimit të të huajve një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që ofrohet për shtetasit shqiptarë. (neni 2)

101. “I huajt”, subjekt i këtij ligji, është çdo person me/pa shtetësi, i cili sipas legjislacionit shqiptar nuk është shtetas shqiptar. Hyrja e të huajt në territorin shqiptar, ndër të tjera dhe për qëllime punësimi, lidhet natyrshëm me termat “punëmarrës”, “punëtor i vetëpunësuar”, “anëtarë të familjes”, “i mitur”, “punësim ndërkufitar”, “punësim stinor”, të cilat përcaktohen në ligj.

102. Ligji “Për të huajt” parashikon hyrjen e të huajve në territorin shqiptar sipas një regjimi, i cili përfshin tre praktika hyrjesh i) pa viza, ii) me viza dhe iii) me taksa kufitare. Ky regjim është i vlefshëm dhe për familjarët e të huajve, të cilët i bashkohen të huajt në territorin shqiptar.

103. Të huajt që dëshirojnë të punojnë në Shqipëri, pajisen me viza nga MPJ. Pas hyrjes në territorin shqiptar, të huajt, sipas legjislacionit të brendshëm në fuqi, kanë të drejtë të pajisen leje qëndrimi ashtu sikurse dhe të kryejnë procedurat për ripërtëritjen e saj (neni 22). Me leje qëndrimi pajisen edhe familjarët që i bashkohen të huajt, rezident në territorin shqiptar. Ai duhet të provojë se qëndron ligjërisht në Shqipëri dhe se është i aftë të sigurojë jetesën për familjarët e tij. (nenet 32, 33)

104. Kushtëzuar nga fakti i qëndrimit të rregullt në territorin shqiptar, ligji i njeh “të huajt” të

¹³ Miratuar me ligjin nr.8492, datë 27.05.1999, dhe ndryshuar me ligjin e miratuar në vitin 2008, nr.9959, datë 17.07.2008

drejtën e zotërimit të dokumenteve (për të vërtetuar identitetin e vet), të drejtën për të lëvizur lirisht brenda territorit shqiptar, të drejtën e organizimit, si edhe të drejtën e ankimit në një procedurë administrative dhe gjyqësore. (neni 5)

105. Ligji i kategorizon lejet e punës konform veprimtarisë ekonomike që i huaji vendos të zhvillojë. Ato grupohen në leje të punës të Tipit A (për veprimtari ekonomike si punëmarrës) dhe të Tipit B (për veprimtari të pavarur ekonomike), të cilat në vetvete ndahen në nëngrupe të tjera. (neni 48)

106. Hyrja e të huajve në territorin shqiptar, por të identifikuar me statusin e azilantit, parashikohet nga ligji nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

Mbështetur në nenin 1 të ligjit, RSH u njeh të drejtën për azil a mbrojtje të përkohshme të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Këta persona mund të jenë refugjatë apo persona të tjerë, që kërkojnë azil në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

107. Nenet 3, 4 dhe 5 të ligjit përkufizojnë me termin “azilkërkues” çdo të huaj:

a) refugjat, “që për shkak të frikës së bazuar të persekutimit për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij dhe nuk ka mundësi, ose për shkak të një frike të tillë nuk ka dëshirë, të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, ose kur ai duke mos pasur një shtetësi dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij si pasojë e këtyre ngjarjeve, nuk ka mundësi, ose nuk ka dëshirë të kthehet atje për arsye të kësaj frike”;

b) person, që i ofrohet mbrojtje e përkohshme mbi baza humanitare, megjithëse nuk përmbush kriteret e nenit 4 të këtij ligji, nisur nga arsyet përkatëse të shprehura në Konventën Europiane për parandalimin e torturës dhe trajtimit a ndëshkimit çnjerëzor apo degradues, në Konventat e Kombeve të Bashkuara kundër torturës, për të drejtat civile dhe politike, për të drejtat e fëmijës dhe çdo instrument tjetër ndërkombëtar në të cilin Republika e Shqipërisë është ose do të jetë palë.

108. Mbështetur në nenin 7 të ligjit, RSH njeh dhe respekton detyrimin për të mos kthyer, larguar jashtë territorit të vet, personat që kanë përfituar apo kërkuar azili apo mbrojtje të përkohshme, në rastet kur: a) në një shtet ku jeta apo liria e tyre kërcënohen për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike; b) në një shtet ku ata do t’i nënshtrohen torturës dhe trajtimit a ndëshkimit çnjerëzor e poshtërues, ose çdo trajtim tjetër të parashikuar në traktatet ndërkombëtare; c) në shtetin e tyre të origjinës, në rast se atyre u është dhënë mbrojtje e përkohshme, në përputhje me klauzolat e këtij ligji; ç) në një shtet të tretë, i cili mund të kthejë a çojë personin në një nga situatat e treguara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

109. Refugjatit, i cili e ka përfituar azilin në përputhje me këtë ligj, mund t’i hiqet kjo e drejtë, kur: a) kërkon me vullnetin e vet mbrojtjen e shtetit ku gëzon shtetësinë; b) rimerr me vullnetin e vet shtetësinë të cilën e kishte humbur; c) fiton një shtetësi të re dhe gëzon mbrojtjen e shtetit të shtetësisë së re; ç) rivendoset me vullnetin e vet në shtetin nga ku është larguar ose jashtë të cilit ka qëndruar për motive persekutimi; d) kanë pushuar së ekzistuari rrethanat e parashikuara në nenin 4 dhe nuk ka arsye për të refuzuar mbrojtjen e shtetit të shtetësisë së tij; dh) është person pa shtetësi dhe kanë pushuar së ekzistuari rrethanat për të cilat i është dhënë e drejta e azilit, si dhe ka mundësitë dhe kushtet për t’u rikthyer në shtetin, nga ku ishte larguar. (neni 8)

Të huajit, refugjatit, që ndodhet në territorin e RSH, i refuzohet e drejta për azil në rastin kur ka prova të mjaftueshme se ai: a) ka kryer krim kundër paqes, krim lufte apo kundër njerëzimit, sipas përcaktimeve të parashikuara në konventat ndërkombëtare; b) ka kryer një krim të rëndë ordiner jashtë territorit të RSH; c) është fajtor për veprime që bien ndesh me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara. (neni 9)

110. Çdo azilkërkues apo refugjat duhet të respektojë Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera ligjore në RSH. Atij nuk i lejohet të angazhohet në veprimtari të tilla që krijojnë probleme për rendin publik, cenojnë sigurinë kombëtare dhe mund të ndikojnë në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tjera.

I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë gëzon status ligjor në përputhje me legjislacionin shqiptar, Seksionin e Aktit Final të Konferencës së Plotfuqishmëve, Konventën e OKB-së së vitit 1951 “Për statusin e refugjatëve”, traktatet e tjera ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, si dhe të gjitha të drejtat që legjislacioni shqiptar iu njeh të huajve. Ai pajiset me lejeqëndrimi, dokumente udhëtimi, leje pune të posaçme dhe gëzon të drejtën e trajtimit social në të njëjtën masë si shtetasit shqiptarë, si dhe përkrahje sociale, të cilat i merr nga zyra për refugjatët.

111. Neni 16 i ligjit parashikon se azilkërkuesit që hyjnë ilegalisht në territorin e RSH, nuk do të ndiqen penalisht për kalim të paligjshëm të kufirit, në qoftë se ata paraqiten përpara autoriteteve përkatëse

jo më vonë së 10 ditë nga dita e kalimit të paligjshëm të kufirit. Ndalimi mund të bëhet vetëm në rastet e: a) verifikimit të identitetit të tyre; b) mashtrimit me dokumente të autoriteteve përkatëse; c) lëshimit të një mandat arresti ndërkombëtar; ç) mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe rendit publik.

Në rastet e ndalimit, nëse është e mundur, azilërkuesi mbahet në izolim, i veçuar nga personat e tjerë. Azilërkuesit e mitur dhe të pashoqëruar nën moshën 16 vjeç, në përputhje me normat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve të ratifikuara nga RSH, nuk burgosen, përveçse në raste ekstreme. Në çdo rast tjetër ndaj tyre merren masat e duhura dhe të përshtatshme për fëmijët.

112. Lidhur me “shtetësinë shqiptare”, neni 1 i ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, parashikon se “Shtetësia shqiptare është një lidhje e qëndrueshme juridike, që shprehet në të drejtat dhe detyrat e ndërsjella të personit fizik dhe të shtetit shqiptar. Shtetësia shqiptare fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili respekton normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë të pranuar nga RSH”.

Shtetas shqiptar është çdo person, që ka pasur shtetësinë shqiptare me hyrjen në fuqi të këtij ligji, si dhe çdo person, shtetas i huaj apo jo, që fiton shtetësinë shqiptare bazuar në këtë ligj. (nenet 2 dhe 3)

113. Shtetësia shqiptare nuk mund të hiqet arbitrarisht. Çdo shtetas shqiptar ka të drejtë të heqë dorë nga shtetësia shqiptare me kusht që të ketë një shtetësi tjetër, të ketë fituar një shtetësi tjetër apo t'i jetë garantuar nga organet kompetente të shtetit të huaj dhënia e një shtetësie tjetër.

114. Neni 6 parashikon se shtetësia shqiptare fitohet me a) lindje; b) natyralizim dhe c) birësim.

Në vijim neni 7 i ligjit, parashikon se një fëmijë e fiton shtetësinë shqiptare me lindje, kur:

a) të dy prindërit, në kohën e lindjes së fëmijës, janë shtetas shqiptar; b) njëri prej prindërve, në kohën e lindjes së fëmijës, është shtetas shqiptar dhe fëmija lind në territorin shqiptar. (përveç rasteve kur prindërit vendosin bashkërisht që fëmija të fitojë shtetësinë e prindit tjetër); c) fëmija ka lindur jashtë territorit shqiptar dhe njëri prej prindërve është shtetas shqiptar, ndërsa prindi tjetër është me shtetësi të panjohur ose pa shtetësi; d) fëmija ka lindur jashtë territorit shqiptar dhe njëri prej prindërve është shtetas shqiptar, ndërsa prindi tjetër ka një shtetësi tjetër, por të dy prindërit bien dakord që fëmija të marrë shtetësinë shqiptare.

115. Marrja e shtetësisë shqiptare me natyralizim, bëhet me kërkesën e vetë shtetasit të huaj, në rast se plotësohen kushtet si vijon: a) të ketë mbushur moshën 18 vjeç; b) të ketë banuar ligjërisht në territorin e RSH, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se 5 vjet; c) të ketë banesë dhe të disponojë të ardhura të mjaftueshme; d) të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar në shtetin e vet apo në RSH ose në ndonjë shtet të tretë për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie (përfshirë nga ky rregull bëhet vetëm në ato raste kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike); e) të ketë njohuri, të paktën fillestare, të gjuhës shqipe; f) pranimi i tij si shtetas shqiptar të mos prejë sigurimin dhe mbrojtjen e RSH; dhe g) të huajt, që ka mbushur moshën 18 vjeç, mund t'i jepet shtetësia shqiptare me natyralizim edhe në qoftë se nuk plotëson kushtet e këtij ligji, me përjashtim të pikës f, në qoftë se RSH ka një interes shkencor, ekonomik, kulturor dhe kombëtar. (neni 9)

Në rast se personi është pa shtetësi, kushtet e pikës a, b, c dhe d të nenit nuk merren parasysh. Koha e përcaktuar në pikën b të këtij neni, për kategorinë e të huajve, që vërtetojnë se janë me origjinë shqiptare deri në dy shkallë, qoftë edhe nga njëri prind, bëhet “të paktën 3 vjet”. Të gjitha kushtet e tjera për fitimin e shtetësisë shqiptare të treguara në këtë nen, mbeten të paprekura.

116. Shtetësia shqiptare merr fund me kërkesë të personit, kur personi: a) ka mbushur moshën 18 vjeç; b) nuk mbetet pa shtetësi si rezultat i heqjes dorë nga shtetësia shqiptare, meqenëse ka shtetësi të huaj, fiton shtetësi të huaj ose garanton se do të fitojë shtetësi të huaj; c) është rezident në një shtet të huaj; d) nuk është në ndjekje penale për vepra penale, për të cilat, sipas legjislacionit shqiptar, parashikohet dënim me burgim jo më pak se 5 vjet; dhe f) nuk ka detyrime ligjore ndaj autoriteteve shtetërore, personave juridikë dhe fizikë. (neni 16)

117. I huaji që është i martuar me një shtetas shqiptar, prej jo më pak se 3 vjetësh, në rast se dëshiron mund të fitojë shtetësinë shqiptare me natyralizim.

Fëmijët e moshës nën 18 vjeç, përfitojnë shtetësinë shqiptare me natyralizim, nëse prindërit e tij, të cilët e kanë përfutur edhe ata më parë shtetësinë shqiptare me natyralizim, e kërkojnë një gjë të tillë.

118. Në rast se dy prindërit me shtetësi shqiptare birësojnë një të mitur të një shtetësie tjetër apo pa shtetësi, fëmija fiton shtetësinë shqiptare. I mituri i birësuar, e fiton shtetësinë shqiptare edhe kur njëri prej prindërve është shqiptar dhe të dy prindërit, në çastin e birësimit, banojnë në territorin e Shqipërisë, si dhe në çdo rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi, si rezultat i birësimit. (neni 12)

119. Për të miturit shtetësia shqiptare mbaron kur të dy prindërit, të cilët kanë hequr dorë nga

shtetësia shqiptare, merren vesh që edhe fëmija e tyre ta lërë shtetësinë shqiptare. (neni 16)

Edhe kur njëri prej prindërve nuk është dakord që fëmija të humbasë shtetësinë shqiptare, fëmijës mund t'i hiqet shtetësia, nëse çmohet se një gjë e tillë është në dobi të fëmijës dhe nëse fëmija ka apo do të marrë një shtetësi tjetër.

Fëmija i mitur e humbet shtetësinë shqiptare kur birësohet nga prindër të huaj dhe fiton me këtë rast një shtetësi të re.

Neni 2

120. Masat e marra nga qeveria shqiptare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor në fushën e arsimit iu referohen më së shumti pakicës gjuhësore rome.

Kjo edhe për faktin se ajo përfaqëson shtresën më të margjinizuar dhe vulnerabël të shoqërisë shqiptare (lidhur me përcaktimet e bëra në Deklaratën e Durbanit).

Një nga angazhimet e viteve të fundit të shtetit shqiptar lidhur me këtë komunitet gjuhësor është zbatimi i Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve”.

121. Mbështetur në progres-raportin e Strategjisë Kombëtare për romët, masat e ndërmarra nga ministritë e linjës dhe organizatat për përmirësimin e jetës se vajzave dhe grave rome:

Puna me prindërit e fëmijëve romë është përqendruar kryesisht në ndryshimin e mentalitetit të tyre për të vlerësuar shkollimin në raport me punësimin e parakohshëm të fëmijëve dhe për të vlerësuar rëndësinë që ka arsimimi për të hyrë në tregun e punës etj. Në këtë drejtim ka pasur një bashkëpunim të mirë dhe është punuar me fushata më të specializuara ndërgjegjësimi dhe veprimtari që do të ndihmonin në krijimin e një mentaliteti të ri për arsimin në komunitetin e prindërve romë.

122. Diskriminimi në procesin e punësimit është një çështje mjaft delikate, për të cilën shteti shqiptar ndërhyr si rregullator. Programet e nxitjes së punësimit për vitet 2006-‘09, përfshinin punëkërkues të papunë, të grupeve të veçanta si: femra mbi 35 vjeç, persona mbi 50 vjeç, romë, jetime, të rinj 16-25 vjeç, persona me probleme sociale, persona të dalë nga ristrukturimi i ekonomisë etj. Në totalin e punëkërkuesve të papunë, 67% i përkasin kësaj kategorie.

123. Gjatë zbatimit të programit “Për nxitjen e punësimit për punëkërkuesit e papunë femra”, u vu re se rreth 47% e të gjithë të të punësuarve janë kryesisht femra mbi moshën 35 vjeç, të divorcuara, rome dhe me probleme sociale. Në të katër programet e nxitjes që zbatohen nga MPÇSSHB, rreth 80% e aplikantëve janë femra.

124. Lidhur me martesat e pjesëtarëve të këtij minoriteti, sidomos të vajzave rome në moshë të vogël, mund të thuhet se ka një perceptim të ndryshëm të kësaj çështjeje në zona të ndryshme gjeografike të vendit ku banon popullsia rome. Falë përpjekjeve kryesisht nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile dhe kryesisht të OJF-ve rome në këto zona mendësitë e minoritetit rom për këtë çështje kanë filluar të ndryshojnë. Janë zbatuar disa projekte ndërgjegjësimi nga organizata rome dhe jorome si fushata e ndërgjegjësimit “Gratë rome dhe të drejtat ligjore” apo dhe fushata e ndërgjegjësimi/avokimit për të drejtat e minoriteteve, të cilat kanë pasur ndikimin e tyre për të sensibilizuar këtë komunitet në lidhje me të drejtat dhe për të krijuar një ambient të favorshëm që do të ndihmonte në ndryshimin e koncepteve mbi familjen.

125. Strategjia Kombëtare për romët i kushton një vëmendje të veçantë forcimit të pozitës së grave në familjen rome, luftën e çdo forme diskriminimi ndaj tyre dhe zhvillimin e programeve speciale për këtë grup. MPÇSSHB ka ndërmarrë disa masa konkrete për integrimin e grave rome në shoqëri. Ajo ka organizuar programe për nxitjen e punësimit të grave dhe vajzave nga të cilat është siguruar punësimi i grave dhe vajzave me probleme sociale.

126. Shkalla e përfshirjes së grave dhe vajzave rome në programet e punësimit lidhet ndërmjet të tjerave dhe me shkallën e ndërgjegjësimit dhe informacionit nga ana e tyre. Janë hartuar dhe zbatuar dy programe për këtë qëllim, përkatësisht “Programi për nxitjen e punësimit të femrave” (VKM nr. 632, datës 18.09.2003) dhe “Programi për nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi” (VKM nr. 47, datës 16.01.2008).

127. Gjithashtu, vlen të përmendim dhe përpjekjet e organeve të qeverisjes vendore, të cilat në bashkëpunim me zyrat rajonale të punësimit, si dhe OJF-të lokale punojnë për një integrim të gruas rome dhe formimin profesional të saj. Qëllimi i këtyre fushatave ndërgjegjësuere ka qenë të mbështesin minoritetin rom për integrimin e tyre në shoqëri dhe për të ndryshuar mentalitetin e tyre për punën. Një masë konkrete e ndërmarrë nga MPÇSSHB është aplikimi i tarifave falas për pjesëmarrje në kurset e

ofruara në drejtoritë rajonale të formimit profesional publik për punëkërkueset e papuna rome, të regjistruara në zyrat e punësimit.

128. Tashmë në vendin tonë vepron Forumi i Gruas Rome, një bashkim i organizatave të grave rome, i cili synon dhënien e kontributit për ndryshimin e situatës së gruas rome në Shqipëri

129. MPÇSSHb ka miratuar të gjithë kornizën e nevojshme ligjore për të zbatuar programin e ndihmës ekonomike. Ligjërisht të gjithë që kategorizohen në grupin në nevojë kanë të drejta të barabarta për sa i takon përfitimeve nga mbështetja sociale. Minoriteti gjuhësor rom nuk ka qenë pre e diskriminimit në këtë fushë. Të gjitha familjet rome që kanë plotësuar dokumentacionin përkatës trajtohen me ndihmë ekonomike njëjloj si pjesa tjetër e popullsisë. Përmes udhëzimeve të posaçme janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe masa e përfitimit të saj për familjet dhe individët në nevojë, kushtëzimi i ndihmës ekonomike me punë e shërbime komunitare, mënyra e marrjes së vendimeve dhe mënyrat e pagesës. I gjithë legjislacioni është publik dhe mund të merret nga grupet e interesit. Gjithashtu, kjo ministri ka nxjerrë disa akte administrative, të cilat detyrojnë njësitë e pushtetit vendor të ofrojnë asistencë për familjet rome, kur këto plotësojnë kushtet për të përfituar ndihmë ekonomike (duke i dhënë prioritet nënave kryefamiljare rome).

130. Përsa i përket kuadrit ligjor për luftimin dhe parandalimin e fenomenit të trafikimit mund të thuhet se ai është i plotë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Dispozitat për krimin e trafikimit të qenieve njerëzore zënë një vend të rëndësishëm në K.P. Në planin teorik shteti ka ndërmarrë hapa pozitivë në përafrimin e legjislacionit penal shqiptar me Konventat Ndërkombëtare dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës.

131. Në nëntor 2006 është vendosur një linjë telefonike kombëtare pa pagesë për denoncimin e rasteve të trafikimit, e cila shërben si një instrument parandalues dhe mbrojtës, veçanërisht në parandalimin e trafikimit të fëmijëve dhe vajzave rome.

132. Dhuna është një fenomen që e shoqëron familjen rome në vazhdimësi. Ekzistenca e këtij fenomeni lidhet me kushtet ekonomiko-sociale të minoritetit rom, nivelin e ulët arsimor, mentalitetin e tyre tradicional lidhur me rolin inferior të gruas në familje dhe patriarkalizmin e familjeve rome. Diskriminimi dhe ushtrimi i dhunës ndaj grave pengon afirmimin dhe përfshirjen e tyre në shoqëri. Ky fenomen përcjell efektet e tij edhe në jetën e fëmijëve romë, duke mbajtur parasysht rolin e madh që ka nëna në edukimin e fëmijëve të saj. Kështu, në qytetin e Korçës nga të dhënat e marra në polici janë evidentuar raste të ushtrimit të dhunës në familjet rome. Për këtë qëllim forcat e policisë kanë vendosur linja bashkëpunimi me shoqatat e grave që kanë objekt të veprimtarisë së tyre parandalimin e dhunës në familje.

133. Ligji nr. 9669, i datës 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, garanton mbrojtje ligjore dhe mbështetje të veçantë pa asnjë dallim racor edhe grave, fëmijëve, të paafteve dhe të moshuarve të komunitetit rom.

134. Në mbështetje të kësaj strategjie, të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në vijim MASH), parashikojnë marrjen e masave apo për uljen e numrit të fëmijëve të shtresave vulnerabël që braktisin shkollën, kryesisht romë.

135. Në zbatim të udhëzimit nr. 34, datë 8.12.2004, strukturat e MASH monitorojnë prej vitit 2004 zbatimin e projektit “Shansi i dytë - Për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe atyre të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”. Kjo masë nënligjore iu adresohet kryesisht fëmijëve romë dhe atyre nga familjet e marginalizuara. Nga monitorimi i zhvilluar deri tani është vërejtur se numri i nxënësve, nga familjet në nevojë dhe të marginalizuara, që braktisin shkollën ka ardhur në rënie.

136. Për identifikimin e rasteve të braktisjes së shkollës apo dhe analfabetizmit, Ministri i Arsimit dhe i Shkencës ka miratuar udhëzimet nr. 6, datë 29.03.2006 “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë pajisur me certifikatë lindje” dhe nr. 22, datë 1.09.2006 “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2006/2007”, si dhe urdhrin nr. 410, datë 08.11.2006 “Për identifikimin e situatës dhe masat që duhen marrë në luftën kundër analfabetizmit”.

137. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 32, datë 28.08.2008 “Për zbatimin e strukturave shkollore, planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2008 – 2009”, përcakton masat që duhet të merren për minimizimin e fenomenit të braktisjes së shkollës në institucionet e arsimit bazë. Ky akt parashikon: i) trajnimin e mësuesve që punojnë me nxënës që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendencë braktisjeje, ii) hartimin e programeve të veçanta pune, me qëllim sensibilizimin e prindërve për rëndësinë e shkollimit, iii) inspektimi dhe raportimi periodik i Drejtorive Arsimore Rajonale (në vijim DAR) lidhur me këtë fenomen dhe problemet e arsimit të

shtresave të marginalizuara.

138. Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 132, datë 11.10.2004 “Për eksperimentimin e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar” dhe ai nr. 170, datë 21.04.2008 “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”, ishin përpjekjet e para për futjen e shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar. Ky shërbim funksionon për të gjithë nxënësit e në mënyrë të veçantë për ata me probleme social-ekonomike, e sidomos për fëmijët romë.

139. Aktualisht MASH është në proces të hartimit të Strategjisë së Arsimit Parashkollor, ku një ndër objektivat themelore të saj është përfshirja e grupmoshës 5-6 vjeç në arsimin e detyruar.

140. Studimi i realizuar nga MASH me temë “Shkaqet që favorizojnë analfabetizmin dhe masat që duhen marrë në luftën kundër kësaj dukurie” kishte për qëllim jo vetëm krijimin e një database për evidentimin e fëmijëve analfabetë brenda sistemit arsimor të detyrueshëm, por edhe evidentimin e nevojave të mësuesve për kualifikim, lidhur me zbutjen e dukurisë së analfabetizmit.

141. MASH planifikon çdo vit trajnimin e mbi 3000 mësuesve, nëpërmjet të cilit synohet promovimi i metodologjive të reja dhe njohja me programet e reja në arsimin parauniversitar. Për këtë qëllim, bazuar në problemet specifike që ka gjithsecili, janë hartuar plane të veçanta trajnimi të mësuesve për punën me nxënësit e marginalizuar.

Ky institucion ka hartuar platforma për çdo Drejtori Arsimore Rajonale (në vijim DAR) apo Zyrë Arsimi (në vijim ZA), për tërheqjen në shkollë të fëmijëve që e kanë braktisur atë dhe realizimin e programeve mësimore suplementare.

Plani mësimor ka në strukturën e tij një lëndë me zgjedhje, ku vetë komunitetet nëpërmjet bordeve të prindërve në shkolla vendosin se çfarë lënde do të zhvillojnë. Kjo krijon mundësinë që shkollat me nxënës nga shtresat e marginalizuara të përfshijnë në “lëndët me zgjedhje” gjuhën e tyre. Të njëjtit qëllim i shërben dhe 10% e orëve të lira javore ose lëndore, ku mësuesit mund të zhvillojnë mësimin në përputhje me interesat e komunitetit nga vijnë nxënësit.

142. Qeveria shqiptare, për vitin 2008, planifikoi në buxhetin e MASH një fond të veçantë për ndërtimin e dhjetë konvikteve të reja për zonat në nevojë, nga të cilat shtatë konvikte u financuan në vitin 2008 dhe tre të tjerët për vitin 2009.

143. Gjithashtu, MASH ka ndërmarrë dhe këto veprime:

- Nëpërmjet sektorit të inspektimit të MASH dhe sektorëve të inspektimit në DAR dhe ZA, është forcuar kontrolli shtetëror dhe ai i minoritetit, për të rritur përgjegjësinë e mësuesve në procesin mësimor;

- Janë zhvilluar trajnime me vajzat dhe gratë romë për përmirësimin e kushteve minimale të jetesës, mirërritjen e fëmijëve, sensibilizimin për shkollim;

- Janë ndërtuar një numër i konsiderueshëm shkollash, si dhe është bërë rikonstruksioni i shumë të tjerave, për të arritur nivelet e një mësimdhënie cilësore;

- Po kalohet gradualisht në përqendrimin e shkollave të vogla në shkolla cilësore e me mjedise tërheqëse për nxënësit;

- Janë zhvilluar tryeza të rrumbullakëta me tematikë “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”, në rrethe të ndryshme të vendit;

- Janë zhvilluar takime sensibilizuese me minoritetin rom për regjistrimin e fëmijëve në shkollë, për mosbraktisjen e saj, si dhe njohjen me udhëzimin për regjistrimin në shkollë pa certifikatë lindje;

- Rritja e vazhdueshme e pagës së mësuesve me 20% çdo vit;

- Pajisja e shkollave çdo vit me mjete didaktike dhe laboratorë të informatikës;

- Krijimi i bibliotekave shkollore për të gjitha shkollat;

- Gradualisht po bëhet zëvendësimi i mësuesve pa arsim përkatës me mësues me arsim përkatës.

144. Përveç strukturave shtetërore, mjaft shoqata e fondacione të ndryshme në gjithë vendin, janë të angazhuara në zbatimin e programeve për zbutjen e varfërisë së familjeve romë.

Në bashkëpunim me UNICEF, “Save the Children” dhe shoqatat romë, në zbatim të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve” u siguroi financimi i nevojshëm dhe filloi një studim për evidentimin e përvojave pozitive në drejtim të edukimit të fëmijëve romë, si dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e cilësisë së arsimit të tyre. Ky studim përfundoi në dhjetor 2007.

UNICEF, në bashkëpunim me palët e interesuara, aktualisht ndjek realizimin e disa projekteve konkrete për arsimin parashkollor, duke hapur disa kopshte të reja pranë këtij komuniteti, në qytetet e Beratit, Korçës, Tiranës, Vlorës, Shkodrës etj.

145. Organizata “Fëmijët e botës dhe të Shqipërisë”, e cila e shtrin veprimtarinë e saj në pjesën veriore të qytetit të Tiranës, është e angazhuar në programin e integritetit të fëmijëve romë në shkolla,

kualifikimin e mësuesve që punojnë me fëmijët romë, si dhe ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për fëmijët romë dhe familjet e tyre.

146. Fondacioni “Ndihmë për fëmijët”, në bashkëpunim me MASH, punon për zbutjen e varfërisë së familjeve në nevojë, për sensibilizimin lidhur me shkollimin e fëmijëve, si dhe ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për fëmijët romë dhe familjet e tyre.

147. Qendra komunitare për fëmijët dhe të rinjtë romë në qytetin e Elbasanit, zhvillon veprimtarinë e saj në kuadër të integritetit të fëmijëve dhe të rinjve romë në shoqëri, si dhe gjallërimit të jetës kulturore në komunitet. Për të zbutur analfabetizmin e fëmijëve të këtij komuniteti qendra ofron kurse të gjuhës rome, gjuhës shqipe, artizanatit, edukimit muzikor, edukimit fizik.

148. Në politikat arsimore të shtetit, të cilat synojnë parandalimin e veprimeve diskriminuese në ambientet shkollore dhe akademike, një vëmendje e veçantë u kushtohet edhe personave me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Planit Arsimor Kombëtar, miratuar me VKM nr.8, datë 7.01.2005, janë ndërmarrë një sërë nismash për zhvillimin e një sërë aktiviteteve që lidhen me arsimin special, si pjesë e sistemit të brendshëm arsimor publik. Këto aktivitete kanë për qëllim ofrimin e asistencës për zhvillimin arsimor më të plotë të personave me nevoja të veçanta fizike, mendore e shqisore dhe në përputhje me nevojat e tyre.

Bazuar në dy objektivat kryesorë të kësaj strategjie: i) shtrirja graduale e arsimit gjithëpërfshirës; dhe ii) përmirësimi i shkollave speciale dhe kthimi i tyre edhe në qendra burimore për arsimin e zakonshëm, prej vitit 2006 e në vazhdim janë ndërmarrë këto masa:

- Hartimi i planeve të veçanta të punës për personat me aftësi të kufizuara, bazuar edhe në programin “Cilësi dhe barazi në arsim” (mbështetur nga Banka Botërore 2007 – ‘08).

- Institucionalizimi i shërbimit psikologjik shkollore në arsimin parauniversitar, i cili rezultoi sa ka pasur impakt pozitiv në punën me këtë kategori nxënësish. Ky shërbim tashmë mbulon të gjitha shkollat e mëdha të arsimit të detyruar dhe institucionet arsimore që punojnë me personat me aftësi të kufizuara;

- Kualifikimi i specialistëve pranë DAR dhe ZA, të cilët mbulojnë problemet e arsimit special;

- Hartimi i një kurrikule të re të shkollës, që favorizon proceset gjithëpërfshirëse, është një ndër objektivat e reformës kurrikulare;

Kjo u krijon mundësinë mësuesve që të zgjedhin atë tekst që përmbush kriteret për të punuar me të gjithë nxënësit, bazuar në aftësitë reale që nxënësit kanë;

- Janë hartuar standardet e ndërtimit të shkollave të reja në të cilat përcaktohet dhe përshtatshmëria për nxënësit me aftësi të kufizuara. (adaptimi i teksteve shkollore dhe përshtatshmëria e ambienteve të mësimi);

- Në 5 rajone të vendit përkatësisht në Tiranë, Berat, Librazhd, Vlorë dhe Gjirokastrë janë krijuar shkolla pilot për trajnimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mësuesit në këto rajone janë trajnuar e pajisur me materiale ndihmëse për identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, që ndihmojnë për gjithëpërfshirjen dhe punën në planin edukativ individual;

- Lidhur me përmirësimet ligjore, ngarkesën e mësuesit dhe vlerësimin e tij financiar, janë mbledhur mendime nga të gjitha DAR dhe ZA dhe janë në procesin e rishikimit Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar. Gjithashtu në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar të të Drejtave të Paaftësisë (FSHDP) në mars 2005 është kryer një studim për legjislacionin në fushën e aftësisë së kufizuara;

- Bazuar në mundësinë dhe aftësitë konkrete të çdo fëmije, është mundësuar regjistrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat artistike e profesionale. Për vitin shkollor 2005 – ‘06 ndoqën mësimin në shkollat e mesme profesionale (pa konkurruar) 10 nxënës të verbër si dhe 2 nxënës që nuk dëgjojnë e nuk flasin, ndërsa në vitin pasardhës akademik numri i këtyre nxënësve ishte 8. Në arsimin e lartë në vitin 2008 vazhduan studimet 75 studentë me aftësi të kufizuara.

- Bazuar në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996, “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2006 – 2007”, të gjitha DAR dhe ZA u është kërkuar të emërojnë me përparësi në shkollat speciale dhe ato të integruara studentët të cilët kanë mbaruar në degën “Pedagogji speciale” në universitetin e Vlorës.

Të dhëna statistikore mbi minoritetet kombëtare në Shqipëri

149. Duke i konsideruar të dhënat statistikore mbi minoritetet, si përcaktuese në projektimin dhe

monitorimin e politikave të të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve, Instituti i Statistikave (INSTAT)¹⁴, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme (Zyra e Minoriteteve) në muajin shkurt 2004 publikoi rezultatet e vlerësimeve statistikore në nivel kombëtar mbi minoritetet kombëtare në Shqipëri.

150. Këto vlerësime janë bazuar në të dhënat e anketës LSMS (Living Standard Measurement Survey), e cila u realizua gjatë vitit 2002 nga INSTAT, si pjesë e programit të qeverisë për Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social, e asistuar nga Banka Botërore, si dhe të regjistrimeve të popullsisë dhe banesave të viteve të viteve 1945, 1950, 1960, 1969, 1979, 1989 dhe 2001.

151. INSTAT në procesin e përpunimit të të dhënave mbi minoritetet është konsultuar edhe me burime të tjera informacioni me karakter të ndryshëm si vëzhgime, studime, të dhëna administrative dhe vlerësime retrospektive mbi minoritetet në Shqipëri.

Në bazë të këtyre vlerësimeve, përqindja e minoriteteve kombëtare në popullsinë aktuale të Shqipërisë, (afërsisht prej 3.069.275 banorë), vlerësohet të jetë në nivelin 1.4%.

Minoriteti kombëtar grek

152. Shqipëria i kushton një vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoritetit kombëtar grek, që jetojnë në territorin e saj, duke i konsideruar si një element vital të shoqërisë së saj dhe si një urë lidhëse me Greqinë dhe Europën. Kjo vëmendje gjen hapësirë sidomos në politikën e stabilitetit dhe fqinjësisë së mirë që Shqipëria zhvillon në rajon, si dhe procesin e rëndësishëm të integritetit në BE. Minoritetit grek i janë siguruar hapësirat dhe mundësitë e realizimit në praktikë të të drejtave që i takojnë bazuar në standardet e përcaktuara në dokumentet ndërkombëtare të OKB-së, OSBE-së, KE-së, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjeve dypalëshe, si dhe në përvojën më të mirë të shteteve të Europës me demokraci të zhvilluar.

153. Shprehje e qartë e zbatimit në praktike të kësaj politike është fakti që personat e minoritetit grek kanë përfutur një lloj si gjithë shtetasit e tjerë në sferën e njohjes, garantimit e mbrojtjes së të drejtave e lirive themelore të njeriut, si liria e ndërgjegjes, e mendimit dhe e shprehjes; garantimi i sigurisë së personit; liria e lëvizjes dhe kontaktet e lira me vendin e origjinës; liria e besimit, e drejta e pronësisë; liria e grumbullimit e bashkimit; pjesëmarrja në jetën publike; në procesin elektorale; në shtypin e lirë; pjesëmarrja në institucionet shtetërore e shoqërore, etj.

154. Më poshtë po përmendim disa marrëveshje dypalëshe, të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri.

i. TRAKTATI I MIQËSISË, BASHKËPUNIMIT, FQINJËSISË SË MIRË DHE SIGURISË MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS GREKE.

Neni 1: Angazhimi i palëve për respektimin e "...lirive themelore, të drejtave njerëzore dhe minoritare".

Neni 12: Palët kontraktuese do të përpiqen që, në mbështetje të konventave dhe marrëveshjeve mes tyre, të zgjerojnë shkëmbimet e tyre kulturore në të gjitha nivelet duke përfshirë edhe krijimin e qendrave kulturore dhe mësimin e gjuhëve të tyre, në mënyrë që të japin ndihmesën në njohjen e ndërsjellë të kulturave kombëtare dhe në pasurimin e trashëgimisë së përbashkët kulturore të Europës.

Neni 13: Të dyja palët, duke njohur rëndësinë e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave njerëzore dhe minoritare, janë dakord të zbatojnë dispozitat e teksteve të OSBE-së, të Kopenhagës (1990), të Gjenevës (1991) dhe të Moskës (1991).

II. MARRËVESHJA MES QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS GREKE PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS. NËNSHKRUAR NË TIRANË MË 4 NËNTOR 1998.

Neni 1, paragrafi c : Palët kontraktuese do të nxisin dhe ngrenë në një nivel më të lartë studimet e gjuhës greke në Universitetin e Tiranës dhe atë të Gjykostrës dhe të gjuhës shqipe në Universitetin e Janinës.

Neni 1, paragrafi f : Palët do të krijojnë kondita të nevojshme për mësimin e gjuhës amtare dhe qytetërimin të njerëzve që i përkasin minoritetit grek. Pala greke do të shqyrtojë mundësinë e mësimin të gjuhës amtare nga fëmijët shqiptarë që ndodhen në Greqi me prindërit e tyre për arsye ekonomike. Pala

¹⁴ INSTAT është institucioni qendror i specializuar, jo vetëm në mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare statistikore, por dhe për hartimin e kriterëve metodologjike për kryerjen e regjistrimeve.

shqiptare do të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së gjuhës greke ndër gjuhët e tjera të huaja fakultative në shkollat e mesme.

Neni 1, paragrafi k : Palët do të bashkëpunojnë për prezantimin në secilin vend të historisë, gjeografisë, kulturës dhe ekonomisë së vendit tjetër, veçanërisht në tekstet shkollore. Për këtë qëllim ato do të ndërmarrin veprime të përbashkëta, si shkëmbimi i materialeve dokumentare dhe ndërmarrjen e një aksioni të përbashkët për tekstet shkollore.

Neni 2 : Pala greke merr përsipër të japë ndihmesën për zhvillimin dhe modernizimin e sistemit arsimor të shqiptarëve dhe minoritetit grek, duke ofruar materiale mësimore, pajisje, trajnim mësuesish dhe çdo mjet tjetër të përshtatshëm.

III. PROGRAMI KULTUROR I BASHKËPUNIMIT MES QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS GREKE PËR PERIUDHËN 2003 – 2005, I NËNSHKRUAR NË ATHINË NË DATAT 1 - 4 PRILL 2003.

Neni 1, Kapitulli 1.3.1 : Palët kontraktuese do të nxisin dhe ngrenë në një nivel më të lartë studimet e gjuhës greke në Universitetin e Tiranës dhe atë të Gjirokastrës dhe të gjuhës shqipe në Universitetin e Janinës.

Neni 1, kapitulli 1.3.2 : Palët kontraktuese të shohin mundësinë e futjes së studimit të gjuhës shqipe në Universitetin e Athinës.

Neni 1, kapitulli 1.3.3 : Palët kontraktuese do të krijojnë kondita të nevojshme për mësimin e gjuhës amtare dhe qytetërimin të njerëzve që i përkasin minoritetit grek.

Neni 1, kapitulli 1.3.4 : Pala greke do të shqyrtojë mundësinë e futjes së mësimin të gjuhës amtare nga fëmijët shqiptarë që ndodhen në Greqi me prindërit e tyre për arsye ekonomike.

Neni 1, kapitulli 1.3.5 : Pala shqiptare do të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së gjuhës greke ndër gjuhët e tjera të huaja fakultative në shkollat e mesme.

Neni 1, kapitulli 1.3.6 : Pala greke merr përsipër të japë ndihmesën për zhvillimin dhe modernizimin e sistemit arsimor për shqiptarët dhe minoritetin grek duke ofruar materiale mësimore, pajisje, trajnim mësuesish dhe çdo mjet tjetër të përshtatshëm.

Bashkëpunimi ndërkufitar me palën greke konsiderohet themelor në disa plane:

a. Ndikon në nivelin e mirëbesimit mes dy popujve. Synimi është kthimi i kufirit shqiptaro-grek në një kufi modern europian, ku mirëbesimi dhe respektimi i dinjitetit të qytetarit të jetë në shkallën më të lartë.

b. Ndihmon në sigurimin e lirisë së lëvizjes së rregullt në po atë masë që parandalon thyerjet e regjimit kufitar.

c. Konsiderohet njëkohësisht porta e fqinjit dhe porta e Europës.

Shqipëria e vlerëson bashkëpunimin me Greqinë për ndalimin e emigracionit klandestin, trafikut ilegal dhe çdo forme të kontrabandës nëpërmjet kufijve tanë. Një ndihmë në këtë drejtim është dhe vazhdimi deri në fund i bashkëpunimit për rindërtimin e piramidave. Lufta kundër trafikut ndërkufitar duhet të shkojë paralel me përparimin e procedurave dhe mundësive të qarkullimit të ligjshëm.

155. Në kuadër të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për krijimin e lehtësirave për qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave, janë nënshkruar marrëveshje për hapjen e pikave të reja të kufirit, siç është ajo e Qafë Botës. Pikat e kufirit që tashmë janë në funksionim me palën greke shërbejnë në mënyrë të veçantë lëvizjes së minoriteteve që janë edhe banorët e zonave kufitare.

Minoriteti kombëtar maqedonas

156. Në kuadrin e marrëveshjes për qarkullimin e vogël kufitar të nënshkruar midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së FYROM, pjesëtarët e minoritetit kombëtar maqedonas kanë mundësi të punojnë në Maqedoni.

157. Në fushën e garantimit të të drejtave arsimore, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe arsimimit në gjuhën amtare të minoriteteve.

Duke iu referuar pozicionit tepër të favorshëm gjeografik që ka për turizëm, por edhe si një komunë kufitare që lidh Korçën me Maqedoninë është parë me interes zhvillimi i zonës së Liqenasit. Konkretisht gjatë dy viteve të fundit në komunën e Liqenasit është investuar për vazhdimin e asfaltimit të rrugës nacionale Korçë-Doganë. Nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit janë çelur financime për sistemimin e rrugëve rurale, kanalizimin e ujërave të zeza. Gjithashtu, është i gatshëm projekti i ujësjellësit të fshatit Lajthizë dhe projekti i ndërtimit të qendrës shëndetësore në Kallmas dhe për realizimin e tyre po kërkohen financime.

158. Gjithashtu, me shumë vëmendje është trajtuar edhe çështja e lëvizjes së lirë të personave që i

përkasin minoritetit maqedonas. Në këtë kuadër, me marrëveshje dypalëshe janë hapur pika të kalimit kufitar, përfshirë edhe me të fundit atë në Xhebisht-Trebishtë-Peshkopi¹⁵. Hapja e këtyre pikave të kalimit kufitar shërben për të rritur kontaktet mes qytetarëve të të dy anëve të kufirit, si dhe për shtimin e shkëmbimeve tregtare dhe zhvillimin e turizmit në të dyja anët e kufirit. Po ashtu, këtij qëllimi i shërben edhe aplikimi me FYROM i sistemit të marrjes së vizave në kufi për qytetarët e të dy vendeve.

Minoriteti kombëtar serbo-malazez

159. Në drejtim të bashkëpunimit ndërkufitar në zonat e banuara nga minoriteti kombëtar serbo-malazez, gjatë muajit qershor 2006 janë nënshkruar marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi në fushën e mjedisit përreth liqenit të Shkodrës, në fushën e transportit për lidhjen e rrjeteve hekurudhore nëpërmjet Bajzës, si edhe u realizua lidhja liqenore me traget në liqenin e Shkodrës nëpërmjet hapjes së pikës kufitare të katërt midis dy vendeve, Ura e Bunës – Vir Pazar.

Neni 3

160. Masat e marra nga legjislatori shqiptar për parandalimin dhe mbrojtjen e personit/ave nga format e aparteidit dhe segregacionit racial lidhen më së shumti me ligjin penal në RSH.

161. Me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, në nenin 50 (Dënimet), është shtuar shkronja (j), e cila parashikon si rrethanë rënduese në dhënien e dënimit kryerjen e veprës të shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.

162. Gjithashtu, i njëjti ligj, në nenin 86 “Tortura” parashikon në shkronjën (ç) se kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet”.

163. Po kështu, në seksionin VII të Kodit Penal “Vepra penale kundër lirisë së personit”, në nenin 109 “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, në të cilin janë bërë ndryshime dhe shtesa me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 dhe ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004, parashikohet se: “rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi, për t’iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara, për qëllime politike ose çdo qëllim tjetër, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë”.

Në rastin se kjo vepër penale kryhet ndaj të miturit nën moshën 14 vjeç dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga tre milionë deri në shtatë milionë lekë.

164. Në seksionin III “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” të po këtij kreu, neni 265 “Nxitja e urrejtjes ose e grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”, parashikon se nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve raciale, nacionale ose fetare, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja me qëllim përhapjeje e shkrimeve me përmbajtje të tillë, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

165. Dispozita nr. 266 e ligjit penal “Thirrja për urrejtje nacionale”, dënon me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet, të gjithë personat që venë në rrezik e paqen publike, duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, fyer ose shpifur për ta, duke përdorur dhunën ose të veprimeve arbitrare.

166. Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dispozitat e ligjit nr. 8733, datë 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, abrogojnë zbatimin e dispozitës së “dënimit me vdekje” në RSH.

167. Në luftën kundër kriminalitetit ekstremist Shqipëria bashkëpunon me SHBA, Italinë, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Austrinë, si dhe me të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor si Kroacinë, Çekinë, Slloveninë, Maqedoninë, Bosnjë Hercegovinën, Malin e Zi etj.

Neni 4

¹⁵ Marrëveshje e nënshkruar në Tiranë, më 16.11.2005

168. Ligji nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1999 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligji nr. 10054, datë 29.12.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar” parashikojnë dispozita materiale dhe procedurale lidhur me kryerjen, ndjekjen dhe ndëshkimin e veprave penale që lidhen me racizmin dhe diskriminimin në sistemet kompjuterike, me qëllim penalizimin e shpërndarjes së materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 4 i protokollit) dhe fyerjes për motive raciste dhe ksenofobike (neni 5 i protokollit).

169. Konkretisht, neni 74/a i KP dënon me burgim 3 – 6 vjet, shpërndarjen kompjuterike të materialeve pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit”, të ofruara në publik ose të shpërndara qëllimisht publikut nëpërmjet sistemeve kompjuterike e materialeve, që mohojnë, minimizojnë në mënyrë të ndjeshme, miratojnë ose justifikojnë akte, që përbëjnë gjenocid ose krime kundër njerëzimit.

170. Në nenin 84/a “Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik” parashikohet se kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, që i bëhet një personi, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për shkak të përkatësisë etnike, kombësie, race apo feje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet.

171. Pas nenit 119 është shtuar neni 119/a “Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik, i cili parashikon se ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, materialeve me përmbajtje raciste e ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet.

Po me këtë masë dënimi, neni 119/b i ligjit penal dënon fyerjen e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë.

172. Legjislacioni shqiptar disponon mjetet efikase në luftën kundër shfaqjeve të veprimeve ksenofobe ose raciste, por duhet theksuar se këto veprime nuk janë frekvente brenda territorit shqiptar.

173. Gjithsesi, RSH në kuadër edhe të përmblotjes së detyrimeve të ndërmarra, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, është duke punuar në vazhdimësi për ndërmarrjen e masave të mëtejshme dhe përmirësimin e atyre aktuale, si në fushën ligjore, ashtu dhe në atë administrative, me qëllim që në tërësinë e zbatimit të tyre të mbrohen dhe të respektohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale, ose përkatësisë prindërore.

174. Nëse i referohemi ligjit penal në RSH, dispozitat që specifikojnë veprat penale me natyrë diskriminuuese, evidentohen si vijon: i) Neni 73 “Gjenocidi”, ii) Neni 74 “Krime kundër njerëzimit”, iii) Neni 74/a “Shpërndarja kompjuterike e materialeve pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit”, iv) Neni 75 “Krimet e luftës”, v) Neni 84/a “Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik”, vi) Neni 86/ç “Tortura”, vii) Neni 109 “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, viii) Neni 119/a “Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik”, ix) Neni 119/b “Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik”, x) Neni 253 “Shkelja e barazisë së shtetasve”, xi) Neni 265 “Nxitja e urrejtja ose e grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”, xii) Neni 266 “Thirrja për urrejtje nacionale”.

Vepra	2002		2003		2004		2005		2006		2007		2008	
	Çështje	Të dënuar	Çështje	Të dënuar	Çështje	Të dënuar	Çështje	Të dënuar	Çështje	Të dënuar	Çështje	Të dënuar	Çështje	Të dënuar
73	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
74	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
75	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
84	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
86	-	-	4	2	3	0	2	2	-	-	-	-	-	-
109	15	15	15	21	16	7	9	13	6	14	6	8	7	15
119	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
253	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
265	-	-	1	3	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-

266	2	2	-	-	2	0	-	-	1	1	-	-	-	-
-----	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

175. Të dhënat statistikore për vitin 2009 janë ende në përpunim. Gjithashtu, numri i çështjeve të gjykuara dhe numri i të dënuarve për veprat penale të parashikuara nga nenet 86 dhe 109 të KP nuk është specifik për situatën e shkeljeve të të drejtave të njeriut me element diskriminues ose racist.

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se në gjykatat shqiptare, kryesisht nuk ka raste mbi zhvillimin e gjykimit të veprave penale me natyrë ksenofobe apo raciste.

Neni 5

176. Republika e Shqipërisë respekton dhe garanton liritë dhe të drejtat e njeriut, të njohura dhe të sanksionuara me Kushtetutë (grupet e lirive dhe të drejtave të pasqyruara në trajtimin e nenit 1 të raportit). Paralelisht me të drejtat dhe liritë e parashikuara në nenin 5 të Konventës kuadër, grupi i lirive dhe të drejtave të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë paraqitet grafikisht, si vijon.



177. (Kushtetuta e RSH, neni 18/1) Gjykimi i barabartë - Në harmoni me dispozitat e parashikuara në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut¹⁶ dhe Konventën Europiane për të Drejtat dhe Lirive të Njeriut¹⁷, nenin 3 të KC dhe nenet 6, 7, 8 të KP, u njohin të njëjtat të drejta dhe detyrime si shtetasve shqiptarë (me kombësi shqiptare ose të pakicave), shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, duke parashikuar zbatimin barabartë e ligjeve në fushat e të drejtës civile dhe atë penale.

178. (Kushtetuta e RSH, neni 39/2, 3) Ekstradimi. Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën penale në KP lidhet me Institutin e Ekstradimit. Neni 11 i Kodit lejon zbatimin e ekstradimit vetëm në rastet kur i) është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, në të cilat RSH është palë dhe ii) objekti i kërkesës për ekstradim, parashikohet si i tillë njëkohësisht nga ligji shqiptar dhe ai i huaj. Në raste të tjera, kur subjekti i ekstradimit a) dyshohet se do të persekutohet, dënohet ose kërkohet për arsye të bindjeve të tij politike, fetare, kombëtare, racore ose etnike, apo kur b) është gjykuar nga gjykata kompetente shqiptare lidhur me veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi, ose c) vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim, ka një karakter politik ose ushtarak, veprimi i këtij instituti është null.

179. (Kushtetuta e RSH, neni 21) E drejta e jetës. Në përputhje me Kushtetutën, KP i RSH trajton në një kre të veçantë (Kreu II) “të drejtën e jetës”. Dhjetë seksionet e këtij kreu, nëpërmjet 57 dispozitave cilësuese, parashikojnë dënime të ndryshme për kundërvajtjet dhe figurat e veprës penale që cenojnë jetën e individit (gjობë, nga 300 000 – 10 000 000 lekë ose burgim, nga 3 muaj deri në burgim të përjetshëm).

¹⁶ nenet 1 dhe 7/ Deklarata Universale e të drejtave të Njeriut

¹⁷ 1 dhe 18 / Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut

Figurat e veprave penale të parashikuara nga ligji penal, për mbrojtjen e jetës janë: i) krime kundër jetës të kryera me dashje, ii) krime kundër jetës të shkaktuara nga pakujdesia, iii) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, iv) vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia, v) vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë dhe mosdhënies së ndihmës së shpejtë, vi) krime seksuale, vii) vepra penale kundër lirisë së personit, viii) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, ix) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, x) vepra penale kundër lirisë së besimit.

180. (Kushtetuta e RSH, neni 45) E drejta e votës – është një e drejtë kushtetuese, e cila sikurse çdo e drejtë tjetër i njihet dhe garantohet çdo shtetasi shqiptar pa asnjë lloj diskriminimi. Çdo person, mbajtës i shtetësisë shqiptare dhe që ka mbushur moshën 18 vjeç, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet si përfaqësues i një grupimi politik ose shoqëror. E drejta për t'u zgjedhur nuk iu njihet personave që vuajnë dënime penale.

Të drejtat civile

181. (Kushtetuta e RSH, neni 38/1) E drejta e lëvizjes i njeh të drejtën çdo shtetasi shqiptar dhe të huaj (të cilët qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e RSH), që të qarkullojë lirisht brenda territorit shqiptar.

182. (Kushtetuta e RSH, neni 38/2) E drejta për t'u larguar nga vendi, u garantohet si shtetasve shqiptarë po ashtu dhe atyre të huaj. Kundrejt praktikave ligjore të vendit të huaj, një shtetas shqiptar mund të udhëtojë drejt tij për arsye të ndryshme, ashtu sikurse dhe një shtetas i huaj mund të hyjë dhe të dalë nga territori shqiptar në përputhje me dispozitat e ligjit “Për të huajt”.

183. (Kushtetuta e RSH, neni 19) E drejta për shtetësi, i garantohet çdo fëmijë të lindur nga të paktën një prind me shtetësi shqiptare. Po ashtu në ligjin “Për shtetësinë” parashikohet se marrja e shtetësisë shqiptare nga shtetas të huaj mund të bëhet dhe me natyralizim. Praktikata e parashikuara në këtë institut lidhen me adoptimin ose kërkesën për marrje shtetësie.

184. (Kushtetuta e RSH, neni 53) E drejta për të lidhur martesë parashikohet edhe në Kodin e Familjes. Sipas nenit 1 të tij, “martesa është një bashkëjetesë ligjore, mbështetur në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit”. Neni 7 i këtij ligji parashikon se martesa mund të lidhet midis një burri dhe një gruaje, që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

185. (Kushtetuta e RSH, neni 41, 42/1) E drejta e pronës sipas nenit 149 KC është e drejta për të gëzuar dhe për të disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuara nga ligji.

Mbështetur në nenin 152 të KC, sendet u përkasin personave fizikë, personave juridikë dhe shtetit. “E drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveçse kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e së drejtës”.

186. (Kushtetuta e RSH, neni 41/2) E drejta e trashëgimisë. Mbështetur në nenin 316 të KC, trashëgimia është “kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë)”, sipas rregullave të përcaktuar në atë kod. Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, ose ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testament është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm (neni 317). Zotësi për të trashëguar ka personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë. Presumohet se ka qenë zënë në kohën e çeljes së trashëgimisë, personi që ka lindur brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit. (neni 320).

187. (Kushtetuta e RSH, neni 24) E drejta e lirisë së mendimit është një e drejtë kushtetuese, e cila u garantohet në mënyrë të njëvlefshme si shtetasve shqiptarë, ashtu edhe shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi.

188. (Kushtetuta e RSH, neni 22/1, 2) E drejta e fjalës i njeh të drejtën çdo personi (shtetas shqiptar, i huaj apo dhe person pa shtetësi) që të shfrytëzojë të gjitha mënyrat dhe format e përhapjes së informacionit (radio, media televizive dhe ajo e shkruar, internet, etj), si dhe për të shprehur e përcjellë fjalën dhe mendimet e tij.

189. (Kushtetuta e RSH, neni 46, 47) E drejta e tubimeve iu njeh të drejtën çdo grupi personash, që të mbledhen e të grumbullohen në ambientet publike dhe të manifestojnë qëllimet dhe interesat e tyre në mënyrë paqësore.

190. (Kushtetuta e RSH, neni 49) E drejta për punë i garantohet çdo shtetas shqiptar dhe çdo shtetas i huaj, që ka hyrë në territorin e Shqipërisë për arsye punësimi.

191. (Kushtetuta e RSH, neni 50) E drejta për t'u organizuar në sindikata. Ligjërisht të gjithë individët në marrëdhënie pune janë të favorizuar dhe të mbrojtur në mënyrë të barabartë për të krijuar dhe

për t'iu bashkuar organizimeve sindikale, pavarësisht nga raca, etnia, origjina, ngjyra, gjinia etj. e tyre.

Bazuar në nenin 10 të K.Punës, të qenit anëtar i një sindikate nuk mund të kushtëzojë punësimin e punëmarrësit dhe anasjelltas.

Organizata sindikale organizon lirisht administrimin dhe veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. (neni 181 i K.Punës)

Organizata sindikale e ushtron lirisht veprimtarinë në përputhje me statutin e saj dhe legjislacionin në fuqi. Ndalohet çdo ndërhyrje e shtetit dhe e punëdhënësit në veprimtarinë sindikale. Në raste ndërhyrjeje në veprimtarinë sindikale, si dhe abuzimi me drejtuesit ose anëtarët e sindikatave, dispozitat e K.Punës parashikojnë sanksione ndaj punëdhënësit deri në 50-fishin e pagës minimale mujore.

192. (Kushtetuta e RSH, neni 37, 40) E drejta për strehim në RSH i njihet çdo personi pa asnjë diskriminim.

193. (Kushtetuta e RSH, neni 52, 55) E drejta për trajtim shëndetësor dhe sigurime shoqërore.

Neni 4 i ligjit "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë"¹⁸ përcakton se sigurimi shëndetësor i detyrueshëm mbulon gjithë shtetasit shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe të huajt e punësuar dhe të siguruar në RSH.

Sigurimet shëndetësore janë një sistem jofitimprurës që mbulojnë i) një pjesë të çmimit të barnave në rrjetin e hapur farmaceutik, ii) shpenzimet e shërbimit nga mjeku i përgjithshëm ose i familjes, mjeku specialist, infermierët e shërbimit shëndetësor parësor për të gjithë të siguruarit. Nëpërmjet sigurimit shëndetësor bëhet i mundur rimbursimi i një pjese të çmimit të barnave kryesore të listës së miratuar nga KM.

Ligji "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"¹⁹ përcakton se sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga i) sigurimi i detyrueshëm, ii) suplementar, iii) vullnetar dhe iv) pensionet shtetërore të posaçme. Sigurimet shoqërore mbrojnë në mënyrë të detyrueshme gjithë shtetasit ekonomikisht aktivë në Shqipëri, në rastin e pakësimit të të ardhurave, si pasojë e barrëlindjes, pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes.

Sigurimet shoqërore, gjithashtu i japin mbrojtje të detyrueshme të gjithë personave të punësuar në rastin e pakësimit të të ardhurave si pasojë e paaftësisë së përkohshme, të shkaktuar nga sëmundja, aksidenti në punë, sëmundja profesionale dhe papunësia. Sigurimet shoqërore u japin mbrojtje edhe i) shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit (në përputhje me konventat, marrëveshjet dypalëshe dhe rregullores së Institutit të Sigurimeve Shoqërore) ii) shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi që punojnë në Shqipëri.

194. (Kushtetuta e RSH, neni 57) – E drejta për arsim në RSH mbrohet me ligj. Ligji "Për sistemin arsimor parauniversitar"²⁰ përcakton kriteret dhe nivelet e arsimit parauniversitar në RSH. Qëllimi i tij është ngritja e një niveli arsimor në respektim me të drejtat e fëmijëve dhe të të rriturve të sanksionuara.

Arsimi parauniversitar publik ka karakter laik dhe në institucionet arsimore publike ndalohet indoktrinimi ideologjik e fetar.

Fëmijët e moshës 6-vjeçare në RSH regjistrohen në shkollat e arsimit të detyruar, i cili zgjat jo më pak se 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin e detyruar deri në moshën 16 vjeç.

Rrjeti i institucioneve arsimore publike përfshin shkollat me kohë të plotë dhe me kohë të shkurtuar. Sistemi arsimor publik përbëhet nga:

-Arsimi parashkollor publik - është niveli i parë i sistemit arsimor publik në Shqipëri (kopshtet e fëmijëve)

-Arsimi i detyruar publik - përfaqëson arsimin bazë të njehsuar dhe të përgjithshëm. Ai synon të zhvillojë aftësitë intelektuale, krijuese, praktike dhe fizike të nxënësve. Shkolla e arsimit të detyruar publik përfshin ciklin fillor dhe ciklin e lartë.

-Arsimi i mesën publik - përgatit nxënësit për të ndjekur universitetin, shkolla të tjera të larta ose për të ushtruar profesione të caktuara.

-Arsimi special publik - synon që nëpërmjet përdorimit të formave dhe metodave të veçanta të

¹⁸ Miratuar me ligjin nr.7870, datë 13.10.1994

¹⁹ Miratuar me ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, ka pësuar ndryshime me ligjet e miratuara në vitet 1995, 1998, 2000, 2001, 2002, 2003, 2005 dhe 2006

²⁰ Miratuar me ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, ka pësuar ndryshime me ligjin e vitit 1998

sigurojë zhvillimin sa më të plotë të mundësive ndaj personave që paraqesin paaftësi fizike, mendore e emocionale. Të gjitha këto masa merren në përputhje me nevojat e tyre dhe kërkesat për një jetë sa më dinjitoze.

Krijimi i institucioneve arsimore private lejohet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Shtetasit shqiptarë ose të huaj kanë të drejtë t'i ndjekin këto institucione, në përputhje me rregullat e pranimit të tyre.

Ligji “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”²¹ parashikon se arsimi i lartë është publik dhe privat. Arsimi i lartë publik është laik.

Shteti garanton paprekshmërinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe të territorit të tyre. Cenimi i paprekshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë ndëshkohet sipas dispozitave ligjore.

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet mbi bazën e kuotave të pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, të miratuara nga KM. Çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

Në respektim të marrëveshjeve dypalëshe/shumëpalëshe të nënshkruara nga shtetit shqiptar, institucionet publike të arsimit të lartë të RSH, vendosin kuota dhe kritere pranimit për ciklin e parë të studimeve për studentët e huaj.

195. (Kushtetuta e RSH, neni 58) E drejta për të marrë pjesë në veprimtari kulturore në kushte barazie. Çdo person në RSH ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete kulturore dhe artistike, për të shpalosur vlerat e tij individuale apo dhe të hapësirave gjeografike dhe kulturore që ai përfaqëson.

196. (Kushtetuta e RSH, neni 59) - E drejta për të akses në të gjitha ambientet publike është një e drejtë kushtetuese, e cila i garanton çdo shtetasi shqiptar apo dhe të huaj, pa asnjë diskriminim që të frekuentojë të gjitha hapësirat dhe ambientet publike në territorin e RSH.

Neni 6

197. Lidhur me shfaqjen e rasteve diskriminuese, Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm pranë Ministrisë së Brendshme, informon se për periudhën 2002 -'08, nuk janë evidentuar nga punonjës të Policisë së Shtetit raste të keqtrajtimit dhe diskriminimit racial apo etnik të pakicave kombëtare që jetojnë në Shqipëri.

198. Përsa i përket çështjeve të të huajve në juridiksionin dhe mbrojtjen e shtetit shqiptar, ato trajtohen nga ligji nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”. Ky u njeh të drejtën për azil a mbrojtje të përkohshme, të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, qofshin këta refugjatë apo persona të tjerë dhe që kërkojnë azil në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

199. Duke parë vështirësitë e policisë kufitare të Shqipërisë në zgjidhjen e çështjeve të të huajve të parregullt në territorin shqiptar, në kuadrin e programit të ndihmës CARDS 2003, Komisioni European financoi një projekt të titulluar “Përzgjedhja e migrantëve të parregullt”, i cili kishte për synim aftësimin e policisë shqiptare për kategorizimin dhe shtruarjen për zgjidhje të nevojave të 3 kategorive të migrantëve të parregullt: azilkërkuesve, viktimave të trafikut të qenieve njerëzore dhe migrantëve të parregullt. Projekti i udhëhequr nga UNHCR Tiranë, me partnerë Drejtorinë për Refugjatët, IOM dhe OSBE (zhvilluar në periudhën 2004–'06), kishte si përfitues kryesor policinë e kufirit dhe migracionit.

Programi i cili përfshinte trajnime masive të policisë, rehabilitime të qendrave pritëse në pikat kufitare etj, ngriti në këmbë sistemin e përzgjedhjes, i cili iu dorëzua në fund PKM.

200. Deri në vitin 2009, numri total i refugjateve dhe azilkërkuesve në RSH ka qenë 99 persona. Kombësia e refugjateve dhe azilkërkuesve është kryesisht nga rajoni, si: Kosova, Mali i Zi, Serbia, Afrika Veriore (Egjypt, Marok, Algjeri), nga Azia (Turqi, Kinë, Afganistan, Indi, Irak, Iran). Lidhur me grupmoshat, 19 persona prej tyre janë fëmijë, 11 persona janë të moshuar dhe pjesa tjetër janë të rritur.

Neni 7

201. Lidhur me masat efektive të marra në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i konventave ndërkombëtare dhe konventës kuadër kundër diskriminimit racor, Qeveria shqiptare ka bërë

²¹ Miratuar me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 ka pësuar ndryshime me ligjin e datës 12.11.2007

përpjekje të vazhdueshme në luftën kundër racizmit dhe intolerancës, si dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës së shtresave vulnerabël.

202. Përveçse ratifikimit të dokumenteve ndërkombëtarë në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, Shteti shqiptar ka miratuar një sërë aktesh ligjore e nënligjore, përmes të cilave garantohen liritë e të drejtat e minoriteteve kombëtare, gjuhësore si dhe komunitetit rom veçanërisht.

203. Në këtë aspekt MB, në bashkëpunim me strukturat e qeverisjes vendore, kanë marrë masa konkrete për ngritjen e strukturave përgjegjëse në zbatimin e programeve me qëllim zbutjen e varfërisë, integrimin dhe përfshirjen e komunitetit rom në jetën publike të vendit, duke ruajtur identitetin dhe vlerave kulturore të tij.

204. Policia e Shtetit pranë MB, në kuadrin e masave për promovimin e lirive dhe të drejtave si luftën kundër diskriminimit racial, ka organizuar për personelin e saj trajnime që lidhen me respektimin dhe eliminimin e diskriminimit racial dhe etnik.

Trajnimet e zhvilluara kishin për qëllim: i) njohjen e të drejtave të minoriteteve dhe respektimin e tyre; ii) njohjen e legjislacionit të brendshëm, nga i cili burojnë të drejtat e minoriteteve dhe grupeve etnike, iii) përmirësimin e aftësive komunikuese dhe profesionale në komunitet dhe respektimin e të drejtave të komunitetit rom, iv) format e parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit racial, gjatë ushtrimit të detyrës nga punonjësit e policisë.

Për realizimin e këtyre trajnimeve policia ka pasur një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me organizata dhe institucione të ndryshme që ushtrojnë veprimtarinë në këtë fushë.

205. Objektivi kryesor i strategjisë për romët është edukimi i fëmijëve parashkollorë.

Niveli i regjistrimit të fëmijëve romë në institucionet e arsimit parashkollor sipas studimit të Bankës Botërore nuk e kalon 10 % të numrit të përgjithshëm të atyre që duhet t'i frekuentojnë këto institucione.

206. MASH, në bashkëpunim me UNICEF, po zhvillojnë një studim i plotë mbi situatën e frekuentimit të fëmijëve romë në arsimin parashkollor dhe atë parauniversitar, i cili do të mundësojë planifikimin e ndërhyrjeve të veçanta që do të rrisin aksesin e tyre në shkolla.

Zbatimi i kësaj mase ka ndeshur në vështirësi teknike dhe subjektive, sikurse është dhe mënyra e jetesës së komunitetit rom, që karakterizohet nga vendbanime jo të qëndrueshme.

207. Si rezultat i masave të marra ka një rritje të frekuentimit të kopshteve dhe shkollave nga ana e fëmijëve romë. Kjo rritje u mundësua nga disa faktorë, si: përmirësimi i infrastrukturës, zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere, marrja e masave nxitëse dhe heqja e barrierave kufizuese.

208. Udhëzimi i MASH për regjistrimin e nxënësve rom nëpër shkolla, kur këta nuk janë të pajisur me certifikatë lindje, ka përmirësuar situatën e regjistrimit në shkolla në qarqe si Tirana, Durrësi, Korça, etj dhe ka eliminuar pengesat ligjore në këtë drejtim.

Për të zbutur fenomenin e braktisjes së shkollës janë ndërmarrë iniciativa me ndikim të madh dhe të qëndrueshëm, të cilat synojnë tërheqjen e fëmijëve romë në shkollë përmes programeve speciale, ofrimit të shërbimeve të veçanta, sensibilizimit të familjeve dhe punës së veçantë me prindërit. 50 % e nxënësve që kanë përfituar nga projekti “Shansi i dytë” janë fëmijë romë.

209. Organizimi i shkollave verore, me nxënës romë dhe joromë, ka rritur përfshirjen e komunitetit dhe ka thyer barrierat penguese përmes organizimit të aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Reforma në fushën e kurrikulave ka krijuar hapësirat e nevojshme për mësimin e gjuhës rome në shkollat ku numri i nxënësve është i madh, hapësirë e cila nuk është shfrytëzuar siç duhet nga minoriteti rom, për shkak të mungesës së informacionit.

Në vitet e fundit është punuar mirë kryesisht nga shoqatat rome, si Unioni Amaro Drom, Romani Baxt, Roma për Integrim etj., për të sensibilizuar komunitetin rom që të regjistrojë fëmijët në kopshte. Kjo është realizuar përmes fushatave të ndryshme ndërgjegjësuere, por dhe është konkretizuar nga hapja e objekteve të reja parashkollore apo rikonstruksioni i atyre ekzistueseve. Ky është një proces i vazhdueshëm dhe gjithmonë do të ketë nevojë për mbështetje dhe bashkëpunim.

210. MASH, në bashkëpunim me UNICEF, po punon gjithashtu për realizimin e disa projekteve konkrete për arsimin parashkollor, siç është hapja e disa kopshteve të reja pranë këtij komuniteti në Berat, Korçë, Tiranë, Vlorë, Shkodër etj. Krahas këtyre institucioneve funksionojnë dhe kopshtet komunitare, të cilat janë iniciativa të vet komunitetit rom dhe kanë gjetur mbështetjen e strukturave shtetërore dhe donatorëve. Kështu për shembull në Moravë të Beratit, kopshti është ngritur me mbështetjen e UNICEF dhe DAR paguan edukatorët.

211. Reformat e ndërmarra në drejtim të arsimit të lartë kanë rritur mundësinë e nxënësve romë për

t'u pranuar në degët e hapura të universiteteve dhe për të përfitur bursa nga fondet publike.

Qendrat e formimit profesional dhe politikat e ndjekura për grupet në nevojë kanë rritur aksesin e fëmijëve romë në kurset e formimit profesional.

212. Përhapje të madhe kanë marrë qendrat ditore të shërbimeve në komunitet të cilat ofrojnë shërbime për fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, vajzat dhe gratë në nevojë. Aktualisht veprojnë 17 qendra, të ngritura në qarqet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës dhe Vlorës dhe po punohet për hapjen e 27 qendrave në qarqet e tjera.

Shfrytëzimi më i mirë i kapaciteteve të krijuara nga minoriteti rom kërkon organizimin e fushatave njohëse në radhët e këtij komuniteti.

213. Minoriteti rom gëzon të drejta të barabarta në fushën e mbështetjes sociale.

Shoqatat romë janë aktive dhe punojnë për influencimin e politikave qeveritare që lidhen me komunitetin rom. Ato bashkëpunojnë ngushtësisht me Njësinë e Monitorimit për Zbatimin e Strategjisë së romëve dhe gjithë strukturat e tjera në nivel qendror dhe lokal.

Disa për tyre në saj të punës dhe përvojës së akumuluar janë partnere të denja në zbatimin e projekteve të financuara nga agjenci ndërkombëtare.

214. Vaksinimi i fëmijëve nga 0-14 vjeç realizohet në shkallë vendi në masën 95 %. Megjithatë problem mbetet vaksinimi i fëmijëve për atë pjesë të popullsisë romë që lëviz nga një rajon në tjetrin apo që emigron.

215. MB ka ndërmarrë fushatën për mbrojtjen e fëmijëve dhe heqjen e tyre nga rruga, duke ndërmarrë disa iniciativa ligjore.

Masat e marra nga strukturat përgjegjëse të MB, për të kontrolluar trafikimin e fëmijëve brenda vendit dhe denoncuar rastet e trafikimit, kanë qenë: i) vendosja e linjave telefonike pa pagesë, ii) bashkëpunimi me qeveritë vendeve fqinje për rikthimin, rehabilitimin dhe kujdesin për fëmijët e trafikuar, ku një pjesë e konsiderueshme e këtyre fëmijëve janë rom, etj.

Iniciativat shtetërore në këtë fushë janë mbështetur dhe nga organizatat e shoqërisë civile, përmes krijimit të koalicionit “Bashkë kundër trafikimit të fëmijëve”.

216. Nga ana e saj MTKRS, në kuadër të promovimit të lirive e të drejtave të njeriut dhe identitetit e vlerave kulturore të minoriteteve dhe komuniteteve në Shqipëri, për periudhën 2002 – ‘08, ka ndihmuar financiarisht në organizimin e aktiviteteve e mëposhtme:

1. “Përmeti Multikulturor” - veprimtari kulturore dhe artistike e përvitshme, që përfshin folklorin e minoriteteve dhe pakicave linguiske në vendin tonë.

2. “Festivali i Minoriteteve – Promocion dhe Integrim” – synon njohjen, promovimin, evidentimin e vlerave kulturore dhe artizanale të minoriteteve, përfshirë këtu edhe minoritetin rom. Aktiviteti realizohet në formën e ekspozitave fotografike dhe panairit artizanal.

3. “Mimozat e Para” - aktivitet në ndihmë të nënave dhe fëmijëve romë.

4. “Arti kundër paragjykitimit - festivali i romëve” - Ky festival organizohet me mbështetjen e MTKRS-së në kuadrin e nismës së Këshillit të Europës/Komisionit Europian “Dosta”: Kapërceni paragjykimet, njihni romët”. Ky aktivitet, i organizuar në datat 5-7 prill 2007, mbledhi së bashku përfaqësues të OJF-ve, qeverisë dhe komunitetit rom, ku gjatë ekspozitave artistike dhe tryezave të rrumbullakëta u ritheksua rëndësia e ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare kundër paragjykitimit ndaj komunitetit rom.

5. Në kuadrin e Javës së Europës, Drejtoria e Politikave Rinore (pranë MTKRS) në bashkëpunim me zyrën e Informacionit të Këshillit të Europës përfundoi trajnimet nga 12 -15 maj 2008 me temë “Të drejtat e njeriut nëpërmjet edukimit bashkëmoshatar”, në të cilën morën pjesë 50 studentë nga fakultete të ndryshme të Universitetit të Tiranës.

6. Festivali “Oda Dibrane” – në Peshkopi.

7. Festivali i Veglave Popullore – në Gjirokastrë.

8. Festivali “Sofra Dardane” – Tropojë.

9. Financim i revistës së Shoqatës Kulturore – Multietnike “Të barabartë”.

217. Ndër të tjera, një meritë e veçantë në këtë fushë, u takon dhe organizatave joqeveritare që veprojnë në Shqipëri.

Veçojmë këtu punën e mirë dhe serioze të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, e cila ka konsistuar kryesisht në rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve vendore/qendrore, popullsisë e grupeve të interesit, lidhur me të drejtat e komuniteteve dhe minoriteteve kombëtare/kulturore/gjuhësore në Shqipëri si dhe me rritjen e kapaciteteve të administratës vendore në trajtimin e rasteve.

KSHH ka luajtur një rol të madh në procesin e promovimit të të drejtave dhe lirive të minoriteteve, duke synuar nxitjen e autoriteteve vendore dhe qendrore në nxjerrjen e akteve ligjore apo nënligjore, në fushën e minoriteteve.

218. Nisur nga sa më sipër, veprimtaritë e zhvilluara nga KSHH kanë konsistuar në monitorimin e gjendjes së minoriteteve në nivel vendor dhe zhvillimi i tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të minoriteteve dhe komuniteteve në rrethe të ndryshme (Tiranë, Korçë, Fier, Shkodër, Gjirokastrë, Sarandë, Berat, Durrës). Në rastet e shkeljeve flagrante të të drejtave të përfaqësuesve të minoriteteve, KSHH ka reaguar edhe me deklarata publike.

219. Një iniciativë tjetër e zbatuar nga kjo organizatë ka qenë vlerësimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në nivel lokal. Nisur fillimisht si një iniciativë rajonale pilote, ajo u zbatua së pari në bashkinë e Korçës (2005), meqenëse në të ndodhen katër minoritete dhe një komunitet. Ky vlerësim u realizua nëpërmjet një pyetësi i cili iu shpërnda qytetarëve të bashkisë, si edhe punonjësve të administratës bashkiake dhe këshillit bashkiak të Korçës. Pas përpunimit të pyetësorëve, përfundimet, problematikat dhe rekomandimet për administratën vendore u paraqitën në një tryezë të rrumbullakët në të cilën merrnin pjesë grupet e interesit, përfaqësues të administratës bashkiake, Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Drejtorisë Arsimore, grupeve minoritare etj. Pas përfundimit me sukses të kësaj iniciative, ajo u shtri edhe në qarqe të tjera të vendit, ku ka përqendrim minoritar, si Tiranë, Elbasan, Gjirokastrë dhe Fier. Metodologjia e ndjekur ishte e njëjtë si në projektin pilot të zbatuar në Korçë.

220. Ndër të tjera, KSHH ka investuar me punën e saj në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të punonjësve, të cilët gjatë punës së tyre përballen me këto minoritete (administrata bashkiake, staf i arsimor i shkollave të mesme dhe 9-vjeçare), si edhe të vetë përfaqësuesve të këtyre komuniteteve.

Në bashkëpunim me Komitetin e Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), KSHH ka zhvilluar trajnimin e punonjësve të drejtësisë (prokurorë, gjyqtarë) e policisë, që ushtronin funksionet e tyre në qarqet ku ka përfaqësues të minoriteteve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe trajnimit të gazetarëve. Trajnimi i tyre kishte të bënte me mënyrat e trajtimit të kronikave që lidhen me problemet e minoriteteve dhe komuniteteve (përkatësisht atij rom dhe egjiptian), terminologjisë së përdorur, nevojës së promovimit të vlerave kulturore, etj.

Pas këtij trajnimi, gazetarët pjesëmarrës realizuan kronika dhe/ose artikuj në mediane dhe shkruar dhe atë elektronike për këto komunitete (dhjetor 2007).

221. Gjatë aktivitetit të tij KSHH ka publikuar raporte dhe publikime në lidhje me gjendjen e minoriteteve në Shqipëri. Përveç raporteve të dala nga monitorimi dhe anketimi i realizuar në nivel vendor, KSHH ka hartuar raporte hije lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së minoritetit rom.

222. Gjithashtu, në kuadër të një iniciative tjetër rajonale, KSHH ka realizuar punë studimore lidhur me përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e minoriteteve në vendimmarrje dhe politikëbërje, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse sa i takon ngritjes së një sistemi efektiv për rritjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së minoriteteve në vendimmarrjen vendore dhe qendrore.

Vlen të përmendet se KSHH ka publikuar në mënyrë të vazhdueshme shqetësimet e tij për gjendjen e minoriteteve në Shqipëri, veçanërisht të minoritetit rom dhe Komunitetit Egjiptian qoftë nëpërmjet deklaratave publike, letrave drejtuar autoriteteve përgjegjëse, ashtu edhe letrave të hapura.

223. KSHH ka kryer aktivitete të ndryshme për minoritetin rom dhe atë egjiptian, me qëllim sensibilizues dhe për edukim ligjor. Për këtë qëllim është bashkëpunuar me organizata të ndryshme të këtyre komuniteteve dhe është vepruar në drejtim të respektimit të të drejtave të tyre dhe për të rritur aksesin në organet e pushtetit vendor, për komunikim më të mirë të tyre në kontaktet me policinë, prokurorinë, gjykatën, me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale etj.

224. KSHH në bashkëpunim me Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale (QSES) mbështetur nga Fondacioni Soros, gjatë vitit 2008 kanë organizuar disa trajnime me përfaqësues të minoritetit rom në komunën e Levanit, Fier. Synimi i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale të përfaqësuesve të minoritetit rom për një përfaqësim më të mirë të të drejtave të tyre të ligjore pranë institucioneve vendore. Gjithashtu, aktiviteti synoi të rritë informimin e përfaqësuesve të minoritetit rom për kompetencat dhe detyrat e institucioneve shtetërore vendore përkundrejt qytetarëve.

Janë organizuar gjithashtu, seminare trajnuese me përfaqësues të DAR, drejtues dhe mësues të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të rrethit të Fierit, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit pedagogjik që merret me edukimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë, në drejtim të parandalimit dhe luftimit të diskriminimit të hapur dhe të fshehur ndaj tyre.

225. KShH dhe QSES, bazuar në misionin e tyre për të nxitur dhe kontribuar në respektimin më të mirë të të drejtave të minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian, në datën 25 shkurt 2009 organizuan një tryezë pune me temë “Forcimi i dialogut konstruktiv ndërmjet aktorëve të ndryshëm për një integrim më të mirë të minoritetit rom dhe atij egjiptian”. Në tryezë u paraqitën përfundimet kryesore, të dala nga takimet dhe trajnimet e zhvilluara gjatë vitit 2008 në bashkitë e Elbasanit, Korçës dhe të Fierit. Këto takime, ku morën pjesë përfaqësues të bashkive, komunave, drejtorive arsimore, drejtorive të policisë, organizatave vendore, donatorëve dhe përfaqësues të vetë shoqatave romë dhe egjiptiane, kishin si qëllim gjetjen e formave efektive të bashkëpunimit, përmirësimit e kushteve të jetesës së këtyre komuniteteve dhe njohjen me rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë në këtë fushë.

226. Disa nga vlerësimet dhe sugjerimet kryesore të dala nga veprimtaritë e KShH janë si vijon:

-Përgjithësisht, ndërgjegjësimi dhe vëmendja e autoriteteve shtetërore, si në nivel qendror ashtu dhe vendor, është rritur përsa i takon respektimit të të drejtave të minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian. Një sërë reformash ligjore dhe institucionale janë ndërmarrë për të siguruar një mbrojtje më të mirë të drejtave të këtyre komuniteteve.

-Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian, në bashkinë e Elbasanit, Korçës dhe në qarkun e Fierit janë duke u zbatuar disa projekte nga institucionet vendore dhe nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm. Njohja e modeleve pozitive në këtë fushë dhe zbatimi i tyre është i domosdoshëm.

-Pjesëmarrja e minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian në qeverisjen vendore është në nivele të ulëta. Arsimiti është element i rëndësishëm në këtë drejtim. Megjithë përpjekjet që bëhen për shkollimin e fëmijëve, ende ka probleme me nivelin arsimor të tyre dhe për rrjedhojë në punësim dhe përfitimin e shërbimeve të tjera. Është e nevojshme rishikimi i bazës ligjore që do të mundësojë pajisjen falas me tekste shkollore për fëmijët në nevojë dhe mbështetjen sociale të familjeve të tyre. Gjithashtu, është e nevojshme të rritet informimi për të drejtat e minoriteteve dhe integrimin e tyre, duke vlerësuar traditat, kulturën dhe vlerat e tyre në një shoqëri.

-Strehimi, punësimi, arsimimi, përfitimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore dhe kushtet e infrastrukturës në zonat ku ka përqendrim të këtyre minoriteteve mbetet problem shqetësues. Është e nevojshme të rishikohet baza ligjore që të mundësojë përfitimin e banesave sociale për personat në nevojë nga këto minoritete, të shikohet mundësia e lehtësimit për përfitimin e ndihmës sociale, rritja e pjesëmarrjes së tyre në organet e qeverisjes vendore dhe gjetjen e formave të nxitjes së biznesit për të punësuar përfaqësues të minoriteteve.

-Me qëllim rritjen e aksesit të minoriteteve në punësim dhe qeverisjen vendore është e nevojshme parashikimi ligjor i masave pozitive (për shembull në formën e kuotave) që do të lehtësonte konkurrimin e tyre për disa vende pune. Formimi profesional dhe kurset e tij duhet të ofrohen sa më pranë qendrave të banuara nga këto minoritete dhe të krijohen lehtësitë e frekuentimit të tyre.

-Është e nevojshme gjetja e zgjidhjeve ligjore për regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit, të regjistruar me emra të ndryshëm, të fëmijëve që nuk jetojnë me prindërit.

-Zbatimi i Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom” në nivel vendor has vështirësi. Strategjia ka nevojë të përditësohet, duke përfshirë mendimet dhe opinionet e të gjithë aktorëve që veprojnë në këtë fushë; të caktohen objektiva konkrete, të qartë dhe të matshëm, afatet e realizimit të tyre, fondet përkatëse që do të vihen në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe ato që do të mbulohen me kontributin e donatorëve të huaj. Është e nevojshme që Strategjia Kombëtare të zbërthehet në plane veprime konkret në nivel vendor.

-Parimi i decentralizimit kërkon një shpërndarje të re të detyrave dhe përgjegjësiive midis pushtetit qendror dhe atij vendor, prandaj është e nevojshme që më shumë kompetenca vendimmarrje duhet të kalojnë në organet e qeverisjes vendore. Është e nevojshme që qeveria të mbështesë programet sociale që hartojnë organet e qeverisjes vendore.

-Në planin vendor, një rol koordinativ është e nevojshme t’i jepet institucionit të prefektit të qarkut. Prefekti ka autoritetin e nevojshëm që të monitorojë zbatimin e strategjisë nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe të ftojë për bashkëpunim OJF-të e ndryshme që veprojnë në nivel qarku.

-Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve profesionale të organizatave dhe shoqatave përfaqësuese të minoritetit rom dhe egjiptian mbetet një çështje prioritare, së cilës i duhet kushtuar një vëmendje e veçantë. Njohja nga ana e minoritetit rom dhe egjiptian e të drejtave të tyre ligjore dhe kompetencave të institucioneve shtetërore do të shërbejë për nxitjen e rolit aktiv të tyre dhe forcimin e fuqisë lobuese ndaj organeve të pushtetit vendor për përmirësimin e situatës së respektimit të të drejtave të tyre.

-Bashkëpunimi mes organet e qeverisjes vendore me OJF-të vendase dhe të huaja është me rëndësi për shmangien e mbivendosjeve në projekte dhe nisma dhe bashkërendimin e përpjekjeve në këtë fushë.

III. Përgjigje rekomandimeve të Komitetit lidhur me raportin I-IV të Konventës kuadër

Nr.12. Komiteti vëren se regjistrimi i fundit që tregon përbërjen etnike të popullsisë daton 1989 dhe se regjistrimi i kryer në 2001 nuk e rinovoi këtë informacion. Nuk ekzistojnë statistika të kohëve të fundit për minoritetet në përgjithësi, dhe asnjë lloj për minoritetin rom në veçanti.

Duke kujtuar se një informacion i tillë është i nevojshëm për vëzhgimin e politikave në favor të minoriteteve dhe për një vlerësim të zbatimit të Konventës, Komiteti rekomandon që shteti palë të mbledhë të dhëna të sakta statistikore për personat që u përkasin minoriteteve në Shqipëri. Përsa i përket kësaj, Komiteti kujton se në bazë të rekomandimit VIII (1990), një identifikim i tillë duhet të mbështetet në thelb, në identifikimin vetjak nga individët e interesuar.

227. Qeveria shqiptare ka filluar përgatitjet për zhvillimin e censusit të popullsisë shqiptare, i cili është vendosur të fillojë në vitin 2011. Puna për përgatitjen e pyetësorit tashmë ka përfunduar. Në këtë pyetësor do të përfshihen ndër të tjera edhe rubrikat e përkatësisë fetare dhe asaj etnike.

Nr.13. Komiteti vëren se shteti palë ka një tendencë për të mos shqyrtuar kryesisht situatën jo të favorshme, në të cilën grupe minoritësh të caktuara në Shqipëri jetojnë në një situatë që përfshin diskriminimin racial apo etnik, duke besuar se problemet ekonomike apo sociale të hasura nga persona që u përkasin këtyre minoriteteve janë të njëjta me ato që pjesa tjetër e popullsisë duhet të ketë të bëjë.

Komiteti rekomandon që shteti palë duhet ta rimarrë në konsideratë këtë çështje dhe të zhvillojë analiza përcaktimin deri në çfarë mase situata jo e favorshme e disa minoriteteve është rezultat i diskriminimit racial apo etnik.

Nr.27. Komiteti vëren gjithashtu se shumë pak raste të diskriminimit racial janë trajtuar nga Avokati i Popullit dhe se asnjë nga këto raste ose ankesa nuk janë dërguar para gjykatës. Komiteti rekomandon që shteti palë duhet të verifikojë se mungesa e rasteve të tilla nuk është rezultat i faktit se kjo kategori njerëzish nuk njohin të drejtat e tyre, mungesë e besimit ndaj policisë apo autoriteteve gjyqësore, ose mungesë vëmendjeje apo ndjeshmërie ndaj rasteve të diskriminimit racial.

Raporti i ardhshëm periodik i Shqipërisë duhet të përmbajë statistika mbi ankesat, procedimet dhe gjykimet lidhur me aktet e diskriminimit racial apo etnik dhe shembuj të rasteve aktuale që i ilustronë këto të dhëna statistikore.

228. Lidhur me këtë çështje risjellim në kujtesë të dhënat statistikore mbi veprat penale dhe krimet e kryera nga personat për periudhën 2002- '08, të paraqitura në trajtimin e nenit 4, paragrafi 170 të këtij raporti.

Gjatë së njëjtës periudhë, zyra e Avokatit të Popullit ka marrë në shqyrtim një sërë ankesash të depozituara nga persona që kanë pretenduar për diskriminim nga ana e organeve të administratës publike. Këto ankesa vijnë nga persona që u përkasin minoriteteve apo grupi të personave praktikues të një besimi të caktuar fetar.

Pavarësisht numrit të vogël të ankesave të shqyrtuara (rreth 24), ndërhyrjet e këtij institucioni në drejtim të eliminimit të diskriminimit racial, janë parë me prioritet dhe gjatë procesit të hartimit të ligjeve. Këto ndërhyrje, së pari kanë pasur si qëllim sanksionimin e institutit të “mosdiskriminimit” në dispozita të veçanta të ligjit dhe së dyti zbatimin e përgjithshëm të tij nga strukturat përgjegjëse shtetërore.

229. Gjatë vitit 2002 nuk kanë rezultuar ankesa të paraqitura nga subjekte të cilat pretendojnë shkelje të dispozitave të Konventës mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial.

Për vitin 2003, numri i ankesave të paraqitura nga subjekte të ndryshme, me pretendim “diskriminimin racial” kanë qenë vetëm 5.

1.Një grup banorësh të fshatit Boriç i Vogël, si dhe Kryetari i Shoqatës së Minoritetit Serbo-Malazez “Moraça-Rozafa” janë ankuar pranë zyrës së Avokatit të Popullit, për veprime të organeve të pushtetit vendor që kanë cenuar direkt të drejtat e tyre të pronësisë. Konkretisht, disa funksionarë të zgjedhur në këtë zonë, po vononin procedurat tekniko-organizative për ndarjen e tokës në pronësi²², për familjet bujqësore të fshatrave Boriç i Vogël dhe Boriç i Madh, duke tentuar të bëjnë kalimin e tokave në pronësi të personave të tjerë, banorë të një fshati fqinj.

²² Ne zbatim të ligjit nr.7501, date 19.7.1991 “Për Tokën”

Duke pretenduar shkelje të së drejtës së tyre të pronës, ata kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit.

Në përfundim të hetimit të çështjes, Avokati i Popullit i dërgoi rekomandim për dhënien e tokës bujqësore në pronësi, në bazë të ligjit, Kryetarit të Komisionit të Tokës së Qarkut Shkodër, Kryetarit të Komisionit të Tokës së Komunës Gruemirë, dhe për dijeni Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Kryetar i Komisionit Qeveritar të Tokës.

Pas ndërhyrjes së specialistëve të këtij institucioni u bë e mundur zhblllokimi i situatës dhe u ra dakord për pajisjen e banorëve të këtyre fshatrave me aktet e marrjes së tokës në pronësi, sipas ndarjes që ka bërë Komisioni i Tokës për fshatin në vitin 1991.

Megjithatë, ky rekomandim nuk është zbatuar ende sot. Për këtë zyra e Avokatit të Popullit konstaton se ka munguar vullneti i Komisioneve të Tokës në qarqet Gruemirë dhe Shkodër.

2. Ankesë tjetër, e shqyrtuar po këtë vit, është një ankesë e përbashkët e tre shoqatave të komunitetit egjiptian në Shqipëri : Shoqata e Egjiptianëve në Shqipëri “Nefreta”-Tiranë, Shoqata “Vllazërimi”-Tiranë dhe Shoqata “Kabaja”-Korçë. Ata u shprehën se i ishin drejtuar disa herë në mënyrë zyrtare Ministrisë së Punëve të Jashtme, ku nëpërmjet një memorandumit kërkonin njohjen e komunitetit të egjiptianëve të Shqipërisë si minoritet kombëtar.

Bazuar në kompetencat dhe ndërhyrjen e këtij institucioni, u bë i mundur informimi i këtyre subjekteve me arsyet e vendimmarrjes së organit.

3. Shtetasja L.C. u ankua për faktin që nga ana e Dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja nuk ju bë e mundur pajisja me diplomë.

Ky i fundit, në mënyrë verbale, i sqaronte ankueses se nuk prante të vendoste fotografinë në diplomë, në të cilën ankuesja kishte dalë me shami si praktikante e fesë myslimane, duke përmendur si argument të vetëm faktin se shkolla është laike.

Zyra e Avokatit të Popullit kontaktoi me Dekanin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe i bëri me dije se në veprimet e tij ishin konstatuar disa shkelje administrative.

Bazuar në nenin 108/a të KPr.A, shprehja nëpërmjet akteve administrative përbën një detyrim ligjor për një organ administrativ.

Në të njëjtën kohë, nxjerrja e një vendimi të arsyetuar nga ana e atij organi, i jep mundësi ankueses të parashtojë më mirë ankimin e saj, në nivelet më të larta të hierarkisë së organeve arsimore apo dhe ato gjyqësore.

Pas kërkesës për shpjegime, e cila iu dërgua në të njëjtën kohë dhe Rektorit të Universitetit të Tiranës, çështja mori zgjidhje pozitive dhe ankuesja u pajis me diplomë duke iu pranuar fotografia me shami.

Në vitin 2004, numri i ankesave të paraqitura për shqyrtim ka qenë vetëm 4.

1. Me të njëjtën ankesë, pra të diskriminimit për shkak të përkatësisë fetare, është paraqitur edhe shtetasi E. M., të cilit nuk i bëhej e mundur regjistrimi në shkollën e mesme “Kostandin Kristoforidhi”, Tiranë, për faktin se ai mbante mjekër. Nga ana e drejtorit të shkollës, ky fakt konsiderohej në kundërshtim me normat e bashkëjetesës në shkollë dhe si paraqitje e tepruar estetike.

Në rastin konkret, refuzimi i konstatuar krijonte premisa për shkeljen e disa të drejtave, si të drejtës për të shprehur e praktikuar besimin fetar dhe në të njëjtën kohë e drejta e ankuesit për t’u arsimuar. Situata bëhej më e ndjeshme dhe për faktin tjetër se ankuesi ishte i mitur.

Liria e shfaqjes së besimit ose të bindjeve nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera, veç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, për interesa të sigurimit publik, të ruajtjes së rendit, të shëndetit dhe të moralit publik ose të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Në të njëjtën kohë, mbajtja e mjekrës nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me normat e bashkëjetesës në shkollë dhe paraqitje e tepruar estetike, pasi nuk pengon procesin mësimor si dhe nuk cenon aspak bashkëjetesën.

Duke qenë se në rastin konkret trajtohet ankesa e një të mituri, referuar Konventës “Mbi të drejtat e fëmijës”, konkretisht të neneve 28 dhe 29, mosregjistrimi cenon gjithashtu të drejtën e ankuesit për t’u arsimuar.

Ky rekomandim është pranuar nga ana e drejtorit të shkollës dhe rezulton që ankuesi është regjistruar dhe vazhdon shkollën në sistemin e korrespondencës.

Edhe në vitin 2005, numri i ankesave me këtë problematikë nuk ka ndryshuar nga ai i një viti më parë. Këtu përmendim:

1. Në vitin 2005 pranë zyrës së Avokatit të Popullit, përfaqësues të partisë “Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut”, e cila përfaqëson të drejtat e komunitetit rom, paraqiti shqetësimin e saj lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre në zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut.

Ata bënë me dije se në këtë proces, pati parregullsi dhe për rrjedhojë, votat që i takonin asaj partie, u përvetësuan nga partitë e tjera gjatë procesit të numërimit.

Zyra e Avokatit të Popullit, pasi e shqyrtoi me vëmendje ankesën dhe pretendimet e parashtruara nga ky subjekt politik, konkludoi se shqyrtimi i rasteve të tilla është jashtë kompetencave të këtij institucioni. Kodi Zgjedhor ua atribuon organeve të tjera të drejtën e shqyrtimit dhe vendosjes për ankimet e paraqitura.

2. Ankesë e një natyre tjetër ishte ajo e një komuniteti rom (prej 200 banorësh) pranë zonës së ish-Kombinatit, të cilët ankoheshin për një mungesë 2- mujore të furnizimit me energji elektrike.

Referuar sa më lart, Avokati i Popullit çmoi se kjo çështje e mprehtë sociale duhet të verifikohet dhe zgjidhet menjëherë, ndaj dhe ai iu drejtua me një kërkesë për shpjegime Drejtorit të Përgjithshëm të KESH sh.a.

Në përgjigjen e tij, titullari i atij institucioni, sqaroi se problemi i furnizimit të energjisë elektrike në zonën e lartpërmendur kishte qenë mjaft i vështirë. Megjithatë u bë e mundur instalimi i një transformatori, i cili aktualisht furnizon me energji të rregullt banorët. Krahas kësaj zgjidhjeje provizore, u propozua që KESH sh.a. të vendosë një kabinë të re me linjë të rregullt 20 KV, për t’i ardhur sa më mirë në ndihmë kërkesave të popullatës.

Për vitin 2006, numri i ankesave të paraqitura për shqyrtim dhe ku pretendohet për raste diskriminimi ka qenë 4.

1. Këtu përmendim rastin e shtetas B.H., studente në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, e cila përcillte shqetësimin e saj, lidhur me mospranimin nga ana e rektorit të atij universiteti, të frekuentimit të mëtejshëm të procesit mësimor prej saj. Shkak për këtë mospranim ishte bërë veshja e saj, veshje e mbuluar me shami.

Në zbatim të rregullores së atij universiteti, studentët B.H. dhe J.M. janë thirrur nga rektorati i këtij institucioni dhe janë këshilluar të përshtatin veshjen dhe paraqitjen e tyre në përputhje me të. Për këtë arsye atyre u janë lënë dy javë afat reflektimi.

Pas rekomandimit tonë studentët u kthyen në procesin mësimor duke e vazhduar atë normalisht si praktikante të fesë myslimane.

2. Rast tjetër është ankesa e paraqitur nga shtetasja G. Xh., anëtare e komunitetit rom. Ajo pretendonte se Prokuroria e Rrethit Pogradec kishte përfunduar në mënyrë të parregullt dhe të padrejtë procedurat hetimore të një aksidenti automobilistik, ku ankimuesja kishte mbetur e dëmtuar.

Nga hetimi i çështjes rezultoi se e vetmja rrugë, që ankuesja kishte për të vënë në vend të drejtën e shkelur ishte t’i drejtohet gjykatës, ku të ankimonte vendimin e prokurorisë për pushim të procedimit penal.

3. Po atë vit Organizata për Mbrojtjen e të Drejtave të Maqedonasve në Shqipëri “Drushtvo Prespa”, paraqiti një ankesë lidhur me mosfunksionimin e pikës doganore Goricë.

Pas ndërhyrjes së zyrës së Avokatit të Popullit, përfaqësuesit e asaj organizate u informuan se pezullimi i zhdoganimeve në pikën doganore Goricë ishte bërë me urdhrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Ky pezullim specifikohet si i përkohshëm dhe kishte ardhur si rezultat i gjendjes së krijuar në periudhën nëntor-dhjetor 2005.

4. Nëpërmjet një ankese drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shoqata “Amaro-Drom”, shprehte shqetësimin e disa familjeve rome, të vendosura në lagjen “5 Maji”, Elbasan, të cilat jetonin në kushte shumë të vështira.

Lidhur me këtë çështje zyra e Avokatit të Popullit rekomandoi që të vlerësohet me prioritet sistemimi i përkohshëm i 4 familjeve rome, madje të shikohej mundësia e vendosjes së tyre në listën e personave të pastrehë, ku do të mund të përfitonin nga apartamentet e banimit që do të ndërtoheshin në lagjen “5 Maji”. Në këtë rast reagimi i bashkisë së Elbasanit ka qenë pozitiv dhe në favor të zgjidhjes së çështjes së këtij komuniteti.

Në vitin 2007, numri i ankesave të paraqitura pranë Avokatit të Popullit ishte përsëri 4.

1. Këtu përmendim ankesën e shtetas Z.M., e cila kishte mbaruar studimet e larta në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, dega matematikë, në vitin 2001. Pavarësisht këtij fakti, zyra arsimore e rrethit Pogradec ia kishte mohuar këtë të drejtë, me arsyen e vetme të “mbajtjes së

shamisë nga ana e saj”.

Duke e konsideruar si shkelje qëndrimin e përgjegjës së zyrës arsimore Pogradec ndaj ankueses Z.M. për të hequr shaminë gjatë procesit mësimor, përfundimisht iu rekomandua të mos pengonte ankuesen të ushtronte profesionin si mësuese, duke mbajtur shaminë e kokës, si shprehje e besimit të saj fetar.

Pavarësisht se ka kaluar një kohë e gjatë ende nuk ka pasur një përgjigje zyrtare nga ana e zyrës arsimore Pogradec. Për këtë çështje është informuar dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila nuk ka mbajtur asnjë qëndrim zyrtar, lidhur me këto ankesa.

Rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë në koherencë me përmbajtjen e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, ku, si një nga detyrimet e shtetit tonë, parashikohet garantimi i aksesit në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Shqipëri. Kjo do të realizohet duke eliminuar rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë, bazuar në Kushtetutën tonë dhe aktet e pranuar ndërkombëtare.

Për vitin 2008, numri i ankesave të paraqitura nga subjekte të cilat pretendojnë shkelje të dispozitave të Konventës mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racia rezulton të jetë rreth 3.

Nr.14. Komiteti merr parasysh dallimin e bërë nga shteti palë në legjislacionin e brendshëm ndërmjet pakicave kombëtare (greke, sllavo-maqedonase dhe malazeze) dhe minoriteteve linguistike (romëve, arumunëve dhe vllahëve). Vëren edhe deklaratën e bërë nga shteti palë se ky dallim nuk ka ndonjë efekt në të drejtat që gëzojnë personat që u përkasin këtyre minoriteteve. Megjithatë thekson se neni 20 i Kushtetutës nuk i jep shprehimisht të drejta vetëm pakicave kombëtare dhe se anëtarët e pakicave linguistike në praktikë nuk gëzojnë të njëjtat të drejta kulturore.

Për më tepër, personat që u përkasin minoriteteve rome dhe arumune janë të pakënaqur që minoritetet e tyre janë klasifikuar vetëm si linguistike, duke qenë se komponentët kryesorë të identitetit të tyre e tejkalojnë çështjen e gjuhës.

Komiteti rekomandon që shteti palë duhet të rikonsiderojë kriteret me anë të cilave është bazuar dallimi ndërmjet pakicave kombëtare dhe pakicave linguistike në konsultim me grupet në fjalë dhe të sigurojë që personat që u përkasin këtyre komuniteteve të gëzojnë të njëjtat të drejta, kryesisht në fushën kulturore.

230. Lidhur me çështjen ku Komiteti i rekomandon shtetit shqiptar “rikonsiderimin e kriterëve mbi të cilat bazohet dallimi midis “pakicave kombëtare” dhe “minoriteteve linguistike”, komentojmë se kriteret e zbatuara nga Shqipëria në këtë aspekt janë keqkuptuar.

Dëshirojmë të ritheksojmë se i vetmi dallim ndërmjet minoriteteve kombëtare dhe minoriteteve etno-gjuhësore është se të parat kanë një shtet amë, ndërsa të dytat jo.

Ky është një dallim objektiv i lidhur vetëm me ekzistencën ose jo të një shteti amë dhe që nuk ka të bëjë aspak me volumin e të drejtave të njohura ndaj një minoriteti. Nga ana tjetër klasifikimi i minoriteteve etno-gjuhësore në minoritete kombëtare do të krijonte një situatë absurde kur shteti shqiptar do të njihte ekzistencën e minoriteteve kombëtare, të cilat nuk kanë shtet amë apo dhe që nuk njihen si të tillë nga ata që pretendohet se janë shtete amë, çka në thelb përbën një shmangie nga parimet e vetë Konventës kuadër “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.

Nr.15. Komiteti vëren ekzistencën e një komuniteti i cili përshkruan vetveten si “egjiptian”, por nuk është njohur si një minoritet, me justifikimin se, sipas shtetit palë, është krejtësisht i integruar në popullsinë shqiptare.

Një informacion më i zgjeruar për këtë komunitet duhet të paraqitet nga shteti palë në raportin e ardhshëm.

231. Lidhur me këtë çështje, qeveria shqiptare e konsideron një devijim nga parimet e Konventës “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, njohjen si minoritet kombëtar të një grupimi vetëm mbi bazën e pretendimeve të anëtarëve të tij.

Identifikimi i anëtarëve të këtij komuniteti si egjiptianë është i pasaktë. Prejardhja e tyre në Ballkan është e diskutueshme. Aktualisht ky komunitet jeton i shpërndarë në zona të ndryshme të vendit. Ai nuk ka gjuhë të veçantë (ata flasin vetëm gjuhën shqipe), nuk ka kulturë të veçantë (kultura e tyre është e njëjtë me atë të zonave të cilat banojnë) dhe nuk ka një fe të veçantë (feja e tyre është e njëjtë me atë të popullsisë shqiptare në zonat ku banojnë). I vetmi dallim nga banorët shqiptarë është ngjyra e lëkurës. Gjithashtu nga kontaktet e zhvilluara vite më parë me përfaqësuesit e Ambasadës Egjiptiane në Tiranë është pranuar se ky komunitet nuk ka asnjë lidhje me egjiptianët dhe se nuk njohin asnjë komunitet egjiptian në Shqipëri.

232. Ky komunitet është mjaft i shpërndarë në territorin shqiptar. Pjesa më e madhe e tij është e

shpërndarë në qytete, në lagje me emra karakteristike (të njohura historikisht si lagje egjiptianësh), ndërsa pjesa tjetër e tij jeton në zonat rurale.

Pjesëtarët e këtij komuniteti janë të përqendruar kryesisht në qytetet e Tiranës, Kavajës, Lushnjës, Cërrikut, Elbasanit, Gjirokastrës, Vlorës, Korçës, Delvinës, Përmetit, Këlcyrës, Beratit, Shkodrës.

Njihen si popull i qetë dhe në këtë komunitet nuk gjejmë raste të kriminalitetit.

Ndryshe nga minoriteti lingvistik rom, ku organizimi social bëhet në kuadrin e fiseve dhe klaneve, komuniteti egjiptian ka një organizim social si pjesa tjetër e popullsisë shqiptare, të ngritur mbi bazën e familjes.

Mbi 95% e martesave të tyre bëhen brenda komunitetit të tyre, dhe kjo nuk është për shkak të traditës që mbizotëron brenda komunitetit, por dhe paragjyqimeve ndaj tij.

Ata dallohen për raportet e larta të lindjeve. Profesionet karakteristike të tyre janë: puna me metal (75%), këpucaria dhe muzika (45%)²³.

233. Komuniteti egjiptian sot vuan nga përjashtimi social i shoqërisë shqiptare. Kushtet e jetesës, situata ekonomike është në standarde tepër të ulëta, dhe pjesa më e madhe e tyre në minimumin e jetesës.

Fatkeqësisht kontingjenti i lypësve në Shqipërisë vijnë nga ky komunitet. Pothuajse 80% e dhuruesve të gjakut, të cilët e bëjnë për arsye ekonomike, i përkasin këtij komuniteti. Egjiptianët kanë probleme të mëdha me banimin dhe kanë nivele të larta papunësie. Disa familje përfitojnë asistencë sociale, por në rastin e familjeve egjiptiane që në përgjithësi kanë shumë fëmijë, kjo asistencë është shumë e vogël.

Si rezultat i kushteve të këqija të banimit, nivelit të ulët ekonomik dhe arsimor, mungesa e higjienës dhe edukatës shëndetësore, në këtë komunitet ka probleme të mëdha të shëndetit.

234. Kushtet e arsimit janë paraqitur gjithashtu problematike. Për shkak të varësisë dhe mungesës së informacionit për arsimim, pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve nuk shkon në shkollë. Edhe nëse këta fëmijë shkojnë në shkollë, ata e braktisin atë pas vitit të parë. Rastet e vijimit të shkollës janë sporadike.

Një fenomen tjetër, karakteristikë e gjendjes së rëndë ekonomike, shoqërore, kulturore dhe arsimore në këtë komunitet, është dhuna ndaj grave në familje.

Nuk ka përfaqësim në nivelet e ulëta të administratës, për të mos folur për më lart.

Komuniteti ka themeluar shoqatën e vet “Vllazëria e egjiptianëve të Shqipërisë”, e cila ka 10 degë në Shqipëri. Puna e anëtarëve të kësaj shoqate është vullnetare.

Nr.16. Komiteti vëren shpjegimet e shtetit palë se “zonat minoritare” nuk ekzistojnë më në Shqipëri, duke qenë se personat e këtyre minoriteteve kanë të njëjta të drejta, cilado qoftë vendndodhja e tyre gjeografike. Raporti periodik megjithatë i referohet kryesisht masave të miratuara për zbatimin e të drejtave kulturore në zona ku minoritetet greke dhe sllavo-maqedonase janë tradicionalisht të përqendruara. Këto minoritete ankohen për mungesën e sistemit të arsimit në gjuhën amtare jashtë këtyre zonave dhe për refuzimin e autoriteteve shqiptare për t’ju përgjigjur kërkesave të tyre.

Komiteti e kupton se ushtrimi i së drejtës për të studiuar dhe për t’u mësuar në gjuhën amtare do të thotë se një numër specifik i anëtarëve të një minoriteti duhet të jetë prezent në një zonë gjeografike. Gjithashtu njeh edhe përpjekjet e bëra nga shteti palë për të siguruar klasa dhe shkolla në gjuhën amtare, megjithë uljen e numrit të nxënësve. Megjithatë rekomandon që shteti palë të sigurojë që të drejtat e anëtarëve të minoritetit të mos jenë të kufizuara në mënyrë të papërshtatshme jashtë zonave ku këto minoritete janë përqendruar. Kërkon gjithashtu që informacioni për këtë çështje të përfshihet në raportin e ardhshëm periodik, përse u përket gjithë minoriteteve.

235. Lidhur me këtë çështje komentojmë se Shqipëria zbaton një legjislacion, i cili bën të mundur gëzimin efektiv dhe jo formal të së drejtës për të deklaruar, pa ndrojtje përkatësinë etnike, fetare kulturore etj. Po ashtu, konfirmojmë se kjo e drejtë ushtrohet në mënyrë individuale, në çdo zonë të territorit shqiptar dhe pavarësisht vendbanimit të shtetasit.

236. Hapja dhe mbyllja e shkollave të sistemit parauniversitar në qendrat e banimit ku jetojnë dhe personat që u përkasin minoriteteve kombëtare, bëhet në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 22.08.1994 “Për arsimin 8-vjeçar në gjuhën amtare të personave të minoriteteve kombëtare”. Në zbatim të këtij vendimi është edhe udhëzimi përkatës i Ministrisë së Arsimit nr.14, datë 03.09.1994, në të cilat janë përcaktuar kriteret që duhen përmbushur, si dhe procedura që duhet ndjekur.

²³ Vlerësime të Bankës Botërore, “Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri – Nga përjashtimi shoqëror tek përfshirja shoqërore”, botim i vitit 2004.

Në pikën 6 të këtij vendimi është parashikuar edhe praktika që duhet ndjekur për hapjen e klasave të veçanta në qendra banimi ku janë vendosur minoritete të ndryshme. Mësimi i gjuhës amtare nga pjesëtarë të minoriteteve kombëtare në këtë rast lejohet edhe si lëndë fakultative, por duhet ndjekur procedura përkatëse, ku kryesore është ruajtja në vijimësi e kontingjenteve të nxënësve.

237. Vendimi për hapjen e këtyre klasave apo shkollave merret nga prefekti që ka rajonin në juridiksion. Nga ana e MASH bëhet vetëm miratimi, pas vendimit përkatës.

Shoqata e minoritetit serbo-malazet “Moraca-Rozafa” (në vitin 2003) i ka drejtuar MASH një kërkesë për rihapjen e shkollës në gjuhën serbe në rrethin e Shkodrës.

Në mbështetje të akteve nënligjore të sipërpërmendura, MASH i është drejtuar DAR Shkodër për të bërë verifikimet e nevojshme si dhe propozimet konkrete për hapjen e shkollave apo të klasave të këtij minoriteti. Lidhur me këtë kërkesë që i është drejtuar, MASH sqaron shoqatën Moraca-Rozafa, se nga verifikimet e kryera në zyrat e gjendjes civile nga ana e DAR në Shkodër, si dhe në disa shkolla nuk rezultojnë asnjë nxënës me kombësi serbo-malazeze. “Në këtë rast, - vijon sqarimin MASH- nuk përmbushen kriteret për hapjen e shkollës në gjuhën e kësaj pakice, të përcaktuara nga legjislacioni në fushën e arsimit”.

238. Gjithashtu një grup prindëresh nga Himara, (në vitin 2004) i kanë drejtuar një kërkesë MASH për hapjen e shkollës në gjuhën amtare greke për vitin shkollor 2004-’05.

Nga shqyrtimi i kërkesës për hapjen e shkollës nga verifikimi i regjistrave të gjendjes civile të qytetit të Himarës rezultojnë se prindërit që kanë bërë këtë kërkesë janë me kombësi shqiptare.

MASH në përgjigje të kësaj kërkesë, drejtuar degës së partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Himarë dhe degës së shoqatës “Omonia”, Himarë sqaron se hapja e një shkolle të tillë nuk është e mundur pasi nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fushën e arsimit.

Aktualisht nuk rezultojnë të ketë kërkesa për hapje shkolle nga minoriteti maqedonas.

239. Për sa i përket hapjes së klasave dygjuhëshe në shkollat ku ka nxënës që u përkasin grupeve minoritare, MASH deri tani nuk ka marrë asnjë kërkesë nga këto komunitete për një veprim të tillë.

240. Në shkollat e minoritetit kombëtar grek raportin nxënës/mësues është afërsisht 7,8/1, ndërkohë që në shkollë republike ky raport është 18,2/1. Pra, kostoja e arsimit të një nxënësi minoritar është afërsisht 2,3 herë më e lartë se kostoja e arsimit të një nxënësi shqiptar.

Ndërsa në shkollat e minoritetit kombëtar maqedonas raportin nxënës/mësues është afërsisht 12,6/1 dhe kostoja e arsimit të një nxënësi minoritar është afërsisht 30% më e lartë se kostoja e arsimit të një nxënësi shqiptar.

Në arsimin e minoriteteve kombëtare greke dhe maqedonase në Shqipëri, vitet e fundit janë shënuar arritje të dukshme në planet, në programet mësimore dhe në tekstet e posaçme për këto shkolla.

Nr. 17. Komiteti vëren gjithashtu se pavarësisht se janë bërë përpjekje për zbatimin e nenit 4 të Konventës, legjislacioni shqiptar akoma nuk i plotëson të gjitha kriteret e kësaj dispozite.

Komiteti rekomandon që shteti palë duhet që t’i deklarojë si akte të rënda të dënueshme nga ligji çdo mbështetje ndaj aktiviteteve raciste dhe financimit të tyre, çdo pjesëmarrje në organizata raciste çdo akt dhune raciste dhe çdo provokim i akteve të tilla. Gjithashtu Komiteti sugjeron se rastet e rënda të racizmit duhet të pasqyrohen në kodin penal në mënyrë që çdo vepër mbi baza raciste duhet të dënohet me ligj.

241. Ndryshimet e bëra në legjislacionin shqiptar, lidhur me parashikimin e figurave të veprave penale dhe krimeve që lidhen me rastet e aparteidit dhe segregacionit racor, janë trajtuar në nenin 3 të këtij raporti.

Nr. 18. Komiteti është i shqetësuar rreth faktit se shpesh të rinjtë e komunitetit rom bëhen objekt i keqtrajtimit dhe përgjithësisht trajtohen si të dyshuar nga punonjësit e policisë.

Komiteti vëren se shteti palë duhet të marrë masat e duhura që raste të tilla të mos ndodhin më dhe të rrisin ndërgjegjësimin e forcave policore ndaj rasteve të diskriminimit racial.

242. Në përgjigje të këtij rekomandimi zyra e Avokatit të Popullit sqaron se në asnjë prej rasteve të shqyrtuara nga ana e këtij institucioni “nuk ka rezultuar se të rinjtë e komunitetit rom janë bërë objekt i keqtrajtimit të policisë për shkak të përkatësisë së tyre. Në përfundim të hetimit të këtyre çështjeve, edhe kur është pretenduar një gjë e tillë, ka rezultuar se nga ana e punonjësve të shtetit nuk janë kryer veprime të paligjshme dhe në kundërshtim me ligjin”.

Një ndër masat e marra së fundmi në luftën kundër të gjitha llojeve të diskriminimit, është edhe shtesa me nenin 144/b²⁴. “Keqtrajtimi i të miturit” në KP.

²⁴ Ligji nr. 9859, datë 21.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i

243. Kjo dispozitë dënon me masën e dënimit “burgim nga tre muaj deri në dy vjet”, keqtrajtimin fizik ose psikologjik të të miturit nga personi që është i detyruar të kujdeset për të. Ndërsa detyrimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij dënohet me burgim deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion lekë.

Nëse nga kjo vepër, shkaktohet dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, masa e dënimit të përcaktuar është 10 – 20 vjet.”

244. Në zbatim të objektivave dhe masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”²⁵, por edhe rekomandimeve të Komisionit European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, ka përgatitur dhe dërguar gjatë periudhës respektive një sërë urdhrash dhe porosish strukturave vendore të saj, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, e këtij komuniteti në veçanti.

Nr. 19. Komiteti vëren se informacioni i dhënë nga shteti palë për pjesëmarrjen në jetën politike të vendit dhe aksesit që pjesëtarët e minoriteteve kanë për pjesëmarrje në shërbimet publike është i pamjaftueshëm. Komiteti rekomandon se duhet analizuar mundësia e pjesëmarrjes së pjesëtarëve të minoriteteve në qeverisje dhe në institucionet politike.

Prej vitit 1991 skena politike shqiptare ka pasuruar mjaft spektrin e saj, duke përfshirë qartazi parti politike me qëndrime ideologjike të majta, të djathta dhe të qendrës (Partia Socialiste - PS, Partia Demokratike - PD, Partia Republikane - PR, Lëvizja Socialiste për Integrim - LSI, Partia Social Demokrate - PSD, Partia e Demokracisë Sociale - PDS); mbrojtëse të të drejtave të njeriut apo dhe me karakter kombëtar (Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut - PBDNJ, Partia Monarkiste - PM, Partia e Ballit Kombëtar - PBK, Partia e Legalitetit - PL, Partia e Bashkimit Socialdemokrat - PBS, Unioni për Dinjitet dhe Integrim - UDI, Partia e Unitetit Kombëtar - PUK); ambientaliste por edhe fetare (Partia Agrare Ambientaliste - PAA, Partia Demokristiane - PDK) etj.

Në zgjedhjet e përgjithshme të 28 qershorit 2009, partia e vetme që mori pjesë në ato zgjedhje, me anëtarë përfaqësues të minoriteteve, ishte PBDNJ. Sot ajo përfaqësohet me një deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

Gjithashtu, në kabinetin qeveritar të drejtuar nga Kryeministri Berisha, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është pjesëtar i minoritetit grek.

245. Minoriteti kombëtar grek

Referuar informacionit të marrë nga përfaqësuesit e organeve të qeverisjes vendore, mbi 30% e administratës së rrethit të Sarandës i përket minoritetit grek, me funksione sikurse: zv/kryetar i Bashkisë, anëtarë të këshillit bashkiak ose departamenteve rajonale, drejtues të institucioneve rajonale të arsimit dhe shëndetit, drejtues të Albanian Power Corporation, kompania Telekom, ndërmarrja shtetërore e ujësjellësit etj.

Shefi i komisariatit të policisë së Delvinës dhe zyrave operative, një polic dhe një oficer i përkasin këtij minoriteti, ndërsa ka një kërkesë në rritje për personel të kualifikuar. Në komisariatit të policisë së Sarandës, në 11 policë të punësuar, 6 prej tyre i përkasin këtij minoriteti.

246. E njëjta situatë vërehet edhe në rrethin e Gjirokastrës. Numri i përfaqësuesve të minoritetit në administratën publike regjistrohet në rritje të vazhdueshme këto tre vjetët e fundit, duke mbajtur parasysh raportin me përqindjen e popullatës.

Në këshillin e rrethit ka 4 anëtarë të minoritetit, në këshillin bashkiak ka një përfaqësues të minoritetit.

Anëtarët e minoritetit përbëjnë 5% të niveleve të policore në komisariatit të policisë të rrethit Gjirokastrë. Numri i anëtarëve të minoritetit në organet gjyqësore është i vogël.

Në të gjitha takimet midis përfaqësuesve të minoritetit dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal konfirmohet një frymë mirëkuptimi. Dialogu ka luajtur një rol të rëndësishëm midis strukturave lokale të minoriteve dhe strukturave qeverisëse.

Ekziston një dëshirë e përbashkët nga ana e autoriteteve qeverisëse dhe përfaqësuesve të minoritetit për diskutim dhe bashkëpunim konstruktiv.

247. Minoriteti kombëtar maqedonas

Jeta e anëtarëve të këtij minoritetit ka sigurisht problemet e saj. Numri i vogël i anëtarëve të minoritetit maqedonas në nivelet e doganës dhe policëve të kufirit, pavarësisht kualifikimeve dhe nivelit të arsimit të tyre, ishte thelbi i disa ankesave të bëra nga përfaqësues të komunitetit maqedonas të komunës së Liqenasit dhe shoqata “Druzhtvo Prespa”.

Takimet në pikat kufitare treguan se në 60 punonjës të policisë së kufirit, 10 prej tyre ishin nga minoriteti maqedonas.

248. Minoriteti kombëtar serbo-maqedonas

Sipas kryesuesve të shoqatës së minoritetit, ata nuk kanë përfaqësimin e duhur jo vetëm në strukturat e qeverisjes lokale, por edhe në qeverisjen qendrore (Parlament, struktura shtetërore, përfaqësi diplomatike). Në bashkinë e Shkodrës ka 2 përfaqësues të këtij komuniteti. Asnjë përfaqësues i këtij minoriteti nuk bën pjesë në Këshillin Bashkiak apo dhe të mbajë postin e një nëpunësi civil, pasi vendet aty janë të zëna nga përfaqësuesit e partive politike, fituese në zgjedhjet lokale.

Ndërkohë, në strukturat e administratës publike të Malësisë së Madhe, popullsia minoritare përfaqësohet nga: Drejtori i Drejtorisë së Hekurudhës, Drejtori i Shëndetit Publik, Drejtori i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtori i Shkollës së Mesme të fshatit Gruemirë.

Përfaqësuesit e këtij minoriteti në administratën e bashkisë Koplik, në prefekturën e Malësisë së Madhe ushtrojnë funksionet e tyre në postet shtetërore: Shef i Departamentit të Financës, Shef i Degës së Bujqësisë, Shef i Administrimit të Taksave në Prefekturën e Malësisë së Madhe.

Nr.20. Komiteti thekson se shteti palë nuk jep informacion të plotë në lidhje me dimensionet e diskriminimit bazuar mbi gjininë.

Komiteti i tërheq vëmendjen shtetit palë për rekomandimin e saj të përgjithshëm XXV (2000) mbi dimensionet e diskriminimit bazuar mbi gjininë dhe rekomandon se shteti palë duhet të vlerësojë këtë çështje dhe të parandalojë diskriminimin racial ndaj grave në përgjithësi.

Ai kërkon që raporti vijues periodik i Shqipërisë duhet të përmbajë informacion mbi këtë çështje.

249. Qeveria shqiptare në vazhdimësi i ka konsideruar të drejtat e grave si pjesë integrale e të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër janë miratuar ligje specifike dhe janë hartuar politika të rëndësishme, të cilat synojnë eliminimin e diskriminimit gjinor.

250. Parimi i barazisë së grave dhe burrave zë një vend të rëndësishëm në Kushtetutën e RSH dhe në legjislacionin e brendshëm. (Kushtetuta, neni 18/2).

251. Kodi Civil (miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994) me ndryshimet përkatëse në nenin 1 parashikon që, çdo person fizik gëzon zotësi të plotë dhe të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj, pa e kushtëzuar gëzimin e të drejtave civile me përkatësinë etnike, apo të origjinës sociale, si dhe pa parashikuar preferenca të veçanta në bazë të racës, ngjyrës, seksit, moshës, apo besimit.

252. Kodi i Procedurës Civile (miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996) gjithashtu cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile që parashikohen në të, duke mos parashikuar rregulla të veçanta për individë me përkatësi etnike, gjini, moshë, apo racë të veçantë.

253. Kodi i Familjes (miratuar me ligjin Nr. 9062, datë 08.05.2003) në përkufizimin që jep për martesën, e përcakton atë si një bashkëjetesë ligjore e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve.

254. Kodi Penal përmban sanksionet më të rënda për diskriminimin. Neni 253 parashikon se “dallimet mbi bazë origjine, seksi të kryera nga ana e punonjësit shtetëror, apo në shërbim publik që konsistojnë në krijimin e privilegjeve të padrejta, ose në refuzimin e një të drejte, ose përfitimi që buron nga ligji dënohen me gjobë, ose me burgim gjer në 5 vjet”.

255. Kodi i Punës sanksionon ndalimin e çdo lloji diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit, duke përfshirë edhe atë gjinor (neni 9)

256. Kodi Zgjedhor i RSH, i miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, në nenin 3 të tij parashikon që: “Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod”

257. Kodi i Procedurave Administrative të RSH (miratuar me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999) në nenin 11 të tij (“Parimi i barazisë dhe proporcionalitetit”) sanksionon parimin e mosdiskriminimit. Sipas kësaj dispozite administrata publike, në marrëdhëniet me personat privatë, udhëhiqet nga parimi i barazisë, në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohe apo diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, fesë...”

258. Miratimi i ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ka si qëllim kryesor mbrojtjen e qytetarëve nga çdo lloj diskriminimi që kryhet mbi bazë gjinie, garantimin e mundësive dhe shanseve të barabarta si për meshkujt e për femrat dhe për të arritur standarde sa më të larta në fushën e barazisë gjinore.

Në përputhje me nenin 1 të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, neni 4/3 i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri” jep përkufizimin e diskriminimit gjinor. Sipas tij “Diskriminim për shkak të gjinisë, përbën çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushttrimin në mënyrë të barabartë nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile”.

259. Ligji nr. 9888, datë, 10.03.2008 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Ky ligj u hartua nga rishikimi që ju bë ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”. Neni 5 i këtij ligji parashikon se ekzekutimi i dënimit me burgim bëhet duke respektuar dinjitetin e të dënuarit dhe përshkohet nga ndjenja njerëzore. Gjithashtu, po aty parashikohen parimet kryesore për trajtimin e të dënuarve, si paanshmëria, apo mos diskriminimi për shkak të seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar. Të dënuarve duhet t’u sigurohen kushte jetese të tilla që ulin në minimum efektet paragjyquese negative të burgimit dhe ndryshimet me jetën e shtetasve të tjerë. Institucioni përkatës ka filluar hartimin e amendimit të këtij ligji, me synim përmirësimin e kushteve dhe të drejtave të personave të dënuar me burgim, në përputhje me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare. Kjo iniciativë është realizuar në bashkëpunim me EURALIUS (European Assistance Mission for the Albanian Justice System) dhe UNICEF-in.

260. Në zbatim të këtij ligji është miratuar rregullorja e përgjithshme e burgjeve, ku ndër të tjera parashikohet detyrimi i administratës së burgjeve për realizimin e trajtimit njerëzor dhe edukues të të dënuarve nëpërmjet mënyrave efektive moderne të administrimit, pa diskriminim për arsye race, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, mendimi politik, origjinës kombëtare, ose shoqërore, gjendjes ekonomike etj. Sipas kësaj rregulloreje, çdo i dënuar duhet të njihet me të drejtat dhe detyrimet e tij që burojnë nga ligji, nga kjo rregullore dhe nga rregullorja e brendshme e burgut. Për këtë qëllim, nga biblioteka e institucionit grave të dënuara ju vihen në dispozicion aktet e nevojshme ligjore e nënligjore. Për të dënuarit që nuk dinë shkrim e këndim, komunikimi i akteve bëhet me gojë nga shërbimi i edukimit.

Sanksionet në rastet e diskriminimit gjinor.

-Kodi i Punës përmban sanksione lidhur me diskriminimin. Diskriminimi mund të sjellë si pasojë sanksione me shuma deri në 50 -fishin e pagës minimale mujore (neni 202).

-Kodi Penal i RSH (i ndryshuar) në nenin 6 parashikohet si rrethanë rënduese kryerja e veprës penale e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare, ose sociale. Ndërkohë që në nenin 253, sanksionohet se “dallimet mbi bazë origjine, seksi të kryera nga ana e punonjësit shtetëror, apo në shërbim publik që konsistojnë në krijimin e privilegjeve të padrejta, ose në refuzimin e një të drejte, ose përfitimi që buron nga ligji, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në 5 vjet”.

-Ligji nr.9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” për rastet e diskriminimit gjinor, përcakton se në varësi të dispozitave që shkelen që nga përgjegjësitë disiplinore (neni 18/2/g), parashikon dënimin me gjoba, me vlerë deri në 100 000 lekë. Shpërblimi për dëmin material dhe moral, të shkaktuar nga cenimi i dispozitave të këtij ligji, përfshirë rikthimin e të drejtave të shkelura, bëhet në rrugë gjyqësore në bazë të Kodit Civil.

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, në rastet kur përbëjnë vepër penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

261. Vlen të evidentohet fakti që legjislacioni shqiptar e trajton në veçanti dhunën mbi baza gjinore, përfshi edhe dhunën në familje. Dhuna ndaj gruas mbulohet nga disa seksione të KP, të cilat janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Seksionet e kodeve	Vepra penale kundër lirisë së personit	Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	Krime seksuale
Veprat penale	-Rrëmbimi -Trafikimi i	Shfrytëzimi i prostitucionit	Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të	- Marrëdhënie seksuale me dhunë(të mitura, ose të

	femrave -Heqja e paligjshme e lirisë		zgjidhur martesë	rritura) - Marrëdhënie seksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari
--	--	--	------------------	--

262. Gjatë vitit 2009 kanë denoncuar dhunën pranë strukturave vendore të policisë rreth 1217 persona, kur gjatë periudhës respektive të vitit të kaluar janë evidencuar 822 raste denoncimesh të tilla. Numri i kërkesëpadive “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” për atë vit ka qenë 841, ndërsa për vitin 2008 ka qenë vetëm 377. Tabela më poshtë jep të dhëna për dhunën në familje referuar veprave/ kundërvajtjeve penale, sipas dispozitave të Kodit Penal, për vitin 2009.

Nr.	Vepra penale/ Kundërvajtje penale	Të dëmtuar				
		Total	Femra	Persona nën 8 vjeç	Raste të përsëritura	Kërkesëpadi urdhër mbrojtje
1.	Rastet për kallëzim penal/këshillim	754	600	2	35	600
2.	Vrasje (nenet 76-83,85 KP)	16	8	2	0	0
3.	Vrasje e mbetur në tentativë	4	0	0	0	0
4.	Shkaktim vetëvrasje (neni 99)	9	3	2	0	1
5.	Plag.rëndë dashje (neni 88,88/a)	9	7	0	0	1
6.	Plag.lehtë dashje (neni 89)	64	14	4	1	9
7.	Marrëdhëniet seksuale (nenet 100-107)	5	1	2	0	0
8.	Shfrytëzim prostitucioni (neni 114)	2	0	1	0	0
9.	Vepra të turpshme (neni 108)	2	1	2	0	0
10.	Trafikimi (nenet 110/1,114/b,128/b)	0	0	0	0	0
11.	Rrëmbimi (nenet 109,109/a)	0	0	0	0	0
12.	Tortura (nenet 86,87)	0	0	0	0	0
13.	Ndër.shtatzënisë pa dëshirën e gruas (neni 93)	1	0	0	0	1
14.	Braktisja (neni 124)	11	4	10	0	0
15.	Mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125)	1	0	0	0	1
16.	Marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127)	4	2	1	0	1
17.	Shtrëngim bashkëjetese (neni 130)	1	0	0	0	1
18.	Mosdhënia ndihmë (neni 97)	0	0	0	0	0
19.	Kanosja (neni 84)	84	60	1	3	52
20.	Fyerja (neni 119)	7	1	0	0	0
21.	Shkatërrim prone (nenet 150-154)	14	2	1	0	2
22.	Dhunimi i banesës (neni 112)	48	2	0	1	42
23.	Vepra të tjera (nenet 90; 91; 92;120;261; 121; 134; 139; 275)	190	140	21	2	130
Shuma		1217	845	49	42	841

263. Në këtë pasqyrë jepen të dhënat statistikore për periudhën 2003-‘08 dhe 3-mujorin e parë të vitit 2009, lidhur me vendimet penale të gjykatave që i referohen dhunimit të të drejtave në përgjithësi dhe femrave në veçanti. MD nëpërmjet Buletinit Statistikor Vjetor evidenton vetëm vendimet e dhëna të gjykatave shqiptare respektive, sipas neneve përkatëse në K. Penal. Të dhënat statistikore të unifikuara nga Ministria e Drejtësisë gjenden të publikuara në faqen zyrtare elektronike të saj. (www.justice.gov.al, rubrika “Statistika”)

LLOJI I VEPRES PENALE	Neni	Viti	Çështje penale për ovikim	Çështje e pushuar	Vendim fajësie	Vendim pafajësie	Inkompetencë	Pushuar	Kthyer për plotësim hetimesh	Pa përfunduar
Ndërprenja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas	93	2003	0	0	0	0	0	0	0	0
		2004	0	0	0	0	0	0	0	0
		2005	0	0	0	0	0	0	0	0
		2006	0	0	0	0	0	0	0	0
		2007	0	0	0	0	0	0	0	0
		2008	0	0	0	0	0	0	0	0
		2009	0	0	0	0	0	0	0	0
Marrëdhënie Seksuale, ose Homoseksuale me të mitur	100/1 100	2003	12	11	11	0	0	0	0	1
		2004	15	10	10	0	0	0	0	4
		2005	11	11	11	0	0	0	0	0
		2006	10	7	6	0	0	0	1	3
		2007	16	10	9	0	1	0	0	6
		2008	20	14	12	2	0	0	0	6
		2009	9	5	5	0	0	0	0	9
Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale, me dhunë, me të mitur (14-18 vjeç)	101	2003	0	0	0	0	0	0	0	0
		2004	3	0	0	0	0	0	0	3
		2005	15	12	9	2	0	1	0	3
		2006	9	7	6	1	0	0	0	3
		2007	7	4	3	0	1	0	0	3
		2008	11	8	6	1	0	1	0	3
		2009	7	3	2	1	0	0	0	4
Marrëdhënie seksuale me dhunë, me të rritura	102	2003	12	0	20	0	0	0	0	0
		2004	8	0	14	0	0	0	0	0
		2005	15	11	7	1	0	3	0	4
		2006	16	13	10	1	0	2	0	3
		2007	20	1	10	0	0	4	0	5
		2008	9	9	5	1	0	2	1	0
		2009	2	0	0	0	0	0	0	2
Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur	103	2003	0	0	0	0	0	0	0	0
		2004	0	0	0	0	0	0	0	0
		2005	1	0	1	0	0	0	0	0
		2006	1	0	1	0	0	0	0	0
		2007	0	0	0	0	0	0	0	0
		2008	0	0	0	0	0	0	0	0
		2009	1	0	0	0	0	0	0	1
Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale, me	104	2004	0	0	0	0	0	0	0	0
		2005	0	0	0	0	0	0	0	0

		2006	0	0	0	0	0	0	0	0
		2007	0	0	0	0	0	0	0	0
		2008	0	0	0	0	0	0	0	0
		2009	0	0	0	0	0	0	0	0
Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale, duke shpërdoruar detyrën	105	2003	0	0	0	0	0	0	0	0
		2004	0	0	0	0	0	0	0	0
		2005	0	0	0	0	0	0	0	0
		2006	0	0	0	0	0	0	0	0
		2007	0	0	0	0	0	0	0	0
		2008	0	0	0	0	0	0	0	0
		2009	0	0	0	0	0	0	0	0
Marrëdhënie seksuale, ose homoseksuale, me persona në gjini, ose nën kujdestari	106	2003	0	0	0	0	0	0	0	0
		2004	2	2	2	0	0	0	0	0
		2005	0	0	0	0	0	0	0	0
		2006	2	1	0	0	0	0	0	1
		2007	1	1	0	1	0	0	0	0
		2008	0	0	0	0	0	0	0	0
		2009	0	0	0	0	0	0	0	0
Shfrytëzimi i prostitucionit	114	2003	22	21	21	0	0	0	0	0
		2004	73	46	46	0	0	0	0	0
		2005	33	18	13	1	2	2	0	15
		2006	23	9	8	1	0	0	0	5
		2007	19	13	11	2	0	0	0	6
		2008	19	13	9	0	3	0	1	6
		2009	9	3	3	0	0	0	0	6
Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese	114/a	2003	58	0	73	0	0	0	0	0
		2004	19	0	54	0	0	0	0	0
		2005	75	60	55	3	2	0	0	15
		2006	44	28	24	2	1	0	1	16
		2007	52	27	21	3	1	0	2	25
		2008	47	31	28	1	1	0	1	16
		2009	27	8	6	0	2	0	0	19

Burimi : Ministria e Drejtësisë

I/2. Kuadri ndërkombëtar

264. Vitet e fundit legjislativi shqiptar, veçanërisht ai penal ka ndryshuar në mënyrë progresive dhe cilësore, duke reflektuar në përmbajtje edhe aktet e ndryshme ndërkombëtare ku Shqipëria është bërë palë. Institucionet zyrtare shqiptare, në veçanti MD, MB, MPÇSShB, MASH, etj. kanë ndërmarrë iniciativa ligjore për përmirësimin e kuadrit ligjor që siguron barazi gjinore, si dhe masa konkrete në drejtim të aplikimit të drejtëpërdrejtë të neneve të Konventës në Shqipëri.

265. Parë në këtë prizëm dhe në përmbushje të rekomandimeve të Komitetit CEDAW (paragrafët 42 dhe 43,) pala shtetërore shqiptare është shprehur dakord:

1.Për kryerjen e ndryshimeve në nenin 20, të paragrafit të parë të Konventës CEDAW, lidhur me kohën e takimit të Komitetit. (paragrafi 42 i rekomandimeve)

2.Parlamenti shqiptar e ka ratifikuar Protokollin Opsional të Konventës me ligjin nr. 9052, datë 17.04.2003. (paragrafi 43 i rekomandimeve)

266. Krahas përmirësimeve të legjislacionit vendas Shqipëria ka ratifikuar gjatë periudhës 2003-'06 një sërë aktesh ndërkombëtare që synojnë ndër të tjera edhe eliminimin e diskriminimit ndaj grave. Ndër këto mund të përmenden:

-Protokolli nr. 12 i Konventës Europiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, i ratifikuar me ligjin nr. 9264, datë 29.07.2004, subjekt i të cilit është ndalimi i diskriminimit në përgjithësi.

-Protokolli Opsional i Konventës "Kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues", ratifikuar me ligjin nr.9094, datë 03.07.2003.

-Konventa Europiane "Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme", e ratifikuar me ligjin nr. 9265, datë 29.07.2004.

-Konventa e Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore" e ratifikuar me ligjin, nr. 9642, datë, 20.11.2006.

-Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Për punëtorët me përgjegjësi familjare, C 156, 1981".

267. Duke marrë për bazë këto ndryshime, mund të thuhet që legjislacioni shqiptar përputhet relativisht mirë me nenin 2 të Konventës CEDAW. Parimi i barazisë mes burrave dhe grave, (sikundër u përmend më lart në shpjegimet e nenit 1) parashikohet në Kushtetutë, ashtu si parashikohet edhe ndalimi i diskriminimit.

II-Politikat gjinore

268. Politikat gjinore të qeverisë kanë pasur si objektiv fuqizimin e statusit të gruas, me qëllim që t'i krijohet asaj në vazhdimësi një akses më i madh në tregun e punës dhe në shanset për karrierë zyrtare, politike e biznesi. Programi i punës së qeverisë shqiptare parashikon angazhimin e plotë të pushtetit ekzekutiv për të eliminuar dhunën ndaj grave e vajzave dhe shfrytëzimin e tyre për qëllime prostitucioni, apo për qëllime të tjera denigruese. Si rrjedhim, programi është qartësisht i orientuar ndaj politikave dhe masave për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe krimit në familje, zbatimi i të cilave zë një vend të rëndësishëm në të gjitha nivelet e qeverisjes.

269. Për të përmirësuar situatën e barazisë gjinore në vend, dhe si një nga masat për të parandaluar diskriminimin gjinor, MPÇSSHB, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, u angazhua gjatë periudhës kohore 2006-'07 në hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit për Veprim të Barazisë Gjinore&Dhunës në familje (2007-'10). Strategjia, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 913, datë, 19.12. 2007, përcakton fushat më të rëndësishme të ndërhyrjes operative, politike e legjislative në nivel mbarëkombëtar, duke përshtatur sipas kushteve konkrete të vendit fushat kritike të Platformës për Veprim Pekin 1995. Qëllimi i saj është përfshirja e çështjeve gjinore dhe dhunës në familje, në politikat publike që hedhin bazat për avancimin e barazisë gjinore dhe minimizimin e fenomenit të dhunës në familje në të ardhmen. Strategjia është ndërsektoriale dhe shoqërohet nga një plan veprimi i zbërthyer në veprime specifike për vitet 2007-'10, sipas 8 drejtimeve të përcaktuara në të.

Prioritetet strategjike të këtij dokumenti janë :

- Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë mbrojtës, që sigurojnë barazinë gjinore;
- Rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse;
- Rritja e mundësive të grave për punësim dhe kualifikim profesional;
- Promovimi i aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në arsimin cilësor;
- Përmirësimi i situatës sociale të grave në rrisk dhe ofrimi ndaj tyre i shërbimeve sociale cilësore;
- Mbrojtja e shëndetit të popullsisë, duke përmirësuar sistemin shëndetësor, në funksion të nevojave të veçanta të popullsisë në këtë fushë;
- Përmirësimi i rolit të medias për një mentalitet të ri, që i përgjigjet zhvillimit të kohës, lidhur me barazinë gjinore në shoqëri dhe rritjen e përfaqësimit të grave në këtë profesion;
- Rritja e ndërgjegjësimit ndaj dukurisë së dhunës, mbrojtjes ligjore dhe asaj administrative, si dhe mbështetja e individëve të prekur nga dhuna në familje.

270. Aktivitetet mbulohen pjesërisht nga Buxheti i Shtetit dhe pjesërisht nga donatorët në kuadrin e programit "Një OKB".

Për zbatimin e kësaj strategjie janë angazhuar institucionet qeveritare në nivel qendror (ministritë e linjës dhe institucionet e tyre vartëse) dhe struktura të tjera në nivel vendor (prefekturat, bashkitë). MPÇSSHB, si autoriteti përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, bashkëpunon në këtë aspekt edhe me

institucionet akademike, median, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare etj.

Monitorimi i SKBGJ&DHF, aktualisht kryhet nga Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta në MPÇSSHB. Raportet vjetore të këtij monitorimi shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ).

(Informacioni i zgjeruar lidhur me strukturat është dhënë në pikën 61 të këtij raporti.)

IV-Fushata ndërgjegjësuere për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje

271. Gjatë periudhës 2006-'09 janë organizuar fushata ndërgjegjësuere në bashkëpunim me aktorët e fushës për çështjet e barazisë gjinore & dhunës në familje. Ato realizohen nëpërmjet edukimit, trajnimit, informimit dhe ndërgjegjësimi të qytetarëve, punonjësve e funksionarëve të administratës publike dhe sistemit gjyqësor, mbi konceptin: e barazisë gjinore; mosdiskriminimin e gruas; eliminimin e stereotipave gjinorë në të gjitha fushat; ndarjes së përgjegjësisë familjare; parandalimit dhe reduktimit të dhunës në familje; botimeve; pasurimit të vazhdueshëm të informacionit në website e Drejtorisë së Politikave të Shanseve të Barabarta, (www.mpcs.gov.al/dpshb) etj.

272. Gjatë vitit 2006, MPÇSSHB në kuadrin e projektit “Hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit për Veprim për Barazinë Gjinore” dhe me mbështetjen e agjencive të specializuara të OKB-së realizoi një vëzhgim mbi gjendjen aktuale në Shqipëri për çështjet e barazisë gjinore. Ky vëzhgim konsistonte në plotësimin e një pyetësoi të përgatitur nga stafi i Drejtorisë së Politikave të Shanseve të Barabarta dhe u shpërnda në të gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet rrjetit të pikave të kontaktit të prefekturave.

Nga përpunimi i pyetësorëve për legjislacionin dhe instrumentet ndërkombëtare u konstatua se, në lidhje me pyetjen se çfarë njihni nga dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, nga gratë e intervistuar 70.6% e tyre njihnin Kartën e të Drejtave të Njeriut, 4.9% njihnin CEDAW-n dhe 7.6% njihnin Platformën për Veprim të Pekinit-1995. Nga burrat e intervistuar, 77.9% e tyre njihnin Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, 5% CEDAW-n dhe 1.1% Platformën për Veprim të Pekinit. Lidhur me pyetjen: Çfarë njihni nga legjislacioni vendas për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave? rezultoi se, 2% e të intervistuarave gra dhe 17.8% e të intervistuarve burra njihnin ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

273. Për të realizuar sensibilizimin e opinionit publik në përgjithësi dhe në veçanti për punonjësit e administratës publike në nivel qendror dhe lokal, MPÇSSHB ka zhvilluar një sërë veprimtarish të tjera, si për barazinë gjinore, ashtu edhe për parandalimin e dhunës në familje. Këtu mund të përmenden:

- Kryerja e dy studimeve “Situata e barazisë gjinore në Shqipëri” dhe “Dhuna në familje”, të cilat janë botuar dhe shpërndarë në institucionet dhe grupet e tjera të interesit.

- Cikël me shkrime në gazetën e përditshme “Standard” për çështjet e barazisë gjinore.

- Përgatitja dhe shpërndarja e posterave për dhunën dhe barazinë gjinore.

- Emisione në radio dhe TV Publik.

- Ekspozitë pikturë me tematikë dhunën kundër gruas dhe në ekspozita me foto të grave nga dy fototeka të njohura (me rastin e 8 Marsit).

- Panair për gruan biznesmene.

- Tryeza të rumbullakëta për legjislacionin, barazinë gjinore dhe dhunën në familje.

- Aktivitete tematiko-ndërgjegjësuere për ditën ndërkombëtare të 8 Marsit 2008 “Progresi është me mua, bashkohu edhe ti” me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit, deputetëve, përfaqësues të institucioneve të tjera, OJF-ve, organizatave ndërkombëtare që veprojnë në vend.

- Ndërgjegjësimi me Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje (SKBGJ & DHF) 2007-2010, nëpërmjet tryezave të rumbullakëta në 12 prefekturat e vendit dhe shpërndarja e Strategjisë.

274. Në SKBGJ & DHF në kapitullin të drejtat, legjislacioni dhe mekanizmi institucional, një nga objektivat që parashikohet të arrihet për periudhën 2007-2010 është: Përkthimi dhe publikimi i të gjitha dokumenteve ndërkombëtarë për çështjet e barazisë gjinore dhe në veçanti Konventa CEDAW. Në këtë aspekt janë realizuar:

- 1- Ribotimi i Konventës CEDAW dhe protokollit shtesë në gjuhën shqipe në formën e një broshure, me një parathënie shpjeguese. Broshura është shpërndarë në institucionet qendrore dhe vendore, si dhe pjesëmarrësve në aktivitetin e 8 Marsit, të titulluar “Progresi është me mua - bashkohu edhe ti”.

- 2- Përkthimi i akteve ligjore ndërkombëtarë që lidhen me barazinë gjinore të OKB-së, KE dhe BE-së, si dhe botimi. Materiali i botuar është shpërndarë në të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, si dhe OJF-ve që punojnë në këtë fushë.

275. Gjatë vitit 2008-2009 u zhvillua fushata ndërgjegjësuere “Të drejtat e grave janë të drejta të njeriut”, ku përveç emisioneve në TV dhe radio publike, shkrimeve në gazeta përfshihen edhe 12 tryeza të rrumbullakëta në prefekturat e vendit, ku pjesëmarrësit do të trajnohen dhe njihen nga afër me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar (veçanërisht CEDAW, protokollin shtesë i tij, Platforma e Pekinit, Konventa e ILOs etj.).

276. Qendra Shqiptare e së Drejtës Ndërkombëtare (organizatë joqeveritare) ka botuar dhe shpërndarë kohët e fundit në përmbledhje në shqip të akteve kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhur me çështjet e barazisë ligjore ku përfshihen një numër i madh Konventash Ndërkombëtare, përfshirë CEDAW-n. Gjithashtu, MTKRS ka organizuar ditë informative me tematikë “Promovimi i të Drejtave të Njeriut” dhe në këto veprimtari informative pjesë e rëndësishme e materialeve informuese ka qenë edhe Konventa CEDAW.

Nr.21. Komiteti është i shqetësuar rreth informacionit lidhur me diskriminimin ndaj romëve në lidhje me arsimimin, shëndetin, higjienën, strehimin, punësimin, ushqimin dhe furnizimin e mjaftueshëm me ujë.

Komiteti rekomandon që shteti palë duhet të intensifikojë përpjekjet që po bën ndaj minoritetit rom në përputhje me rekomandimet XXVII (2000). Përpjekje të veçanta duhen bërë në konsultim me komunitetin në fjalë për integrimin e fëmijëve romë në sistemin arsimor shqiptar, ndërkohë duhen krijuar mundësi për udhëzime dygjuhësh, ose në gjuhën amtare dhe respektimin e kulturës dhe mënyrën e jetesës së komunitetit. Informacioni në lidhje me rezultatet e arritura nga strategjia kombëtare përsa u përket romëve duhet të paraqitet në raportin e ardhshëm periodik.

278. Lidhur me situatën e arsimit të romëve në Shqipëri, MASH ka përqendruar punën e saj në këto drejtime:

- Tërheqja në shkollë e të gjithë fëmijëve romë.
- Ulja e numrit të rasteve të braktisjes së shkollës nga fëmijët romë.
- Rikonstruksioni i shkollave ku ka grupe fëmijësh romë.
- Rritja e sensibilizimit të familjeve romë për frekuentimin e shkollës nga fëmijët e tyre.
- Kualifikimi i mësuesve që punojnë me fëmijët romë, me qëllim ngritjen e ndërgjegjësimin të prindërve për të dërguar fëmijët e tyre.

279. MASH, në bashkëpunim me OJF, ka realizuar veprimtari të ndryshme për promovimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe në veçanti të të drejtave të fëmijëve romë. Aktualisht po punohet për përfshirjen në kurrikula të tematikave që trajtojnë problemet e rrezikshmërisë së përdorimit të drogës, të alkoolit, të duhanit, të braktisjes së shkollës dhe dukuri të tjera të lidhura me plagët e sotme të shoqërisë shqiptare, si p.sh. prostitucioni, trafikimi etj.

Në bashkëpunim me UNICEF dhe “Save The Children”, MASH në zbatim të Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve” është përfunduar një studim për evidentimin e situatës së arsimit të romëve në vendin tonë, si dhe po ndjek realizimin e disa projekteve konkrete për arsimin parashkollor.

280. Hapja dhe funksionimi i kopshteve romë ka qenë një nga masat prioritare që ka gjetur mbështetjen e gjerë të donatorëve të huaj dhe vendas falë bashkëpunimit të frytshëm që ato kanë pasur me shoqatat romë. Gjatë periudhës 2004-07 janë ndërmarrë disa iniciativa nga vet organizatat romë me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm për të ngritur kopshte në disa nga zonat me përqendrim të madh të komunitetit rom.

Në qytetin e Korçës është realizuar në vitin 2005 rikonstruksioni i godinës së kopshtit “Lulet e vogla” për komunitetin rom përmes një projekti të zbatuar nga shoqatat “Terre des Homes” dhe Arsis/Greqi.

Gjendja e vështirë e këtij komuniteti ka tërhequr dhe vëmendjen e kompanive të biznesit, të cilat përmes strategjive të tyre të marketingut social kanë filluar t’i vijnë në ndihmë komunitetit rom.

281. Në kuadër të këtyre strategjive kompania e telefonisë celulare vodafone ka mbështetur shoqatën “Romët për integrim” të ngrejë një kopsht në Selitën e Vogël në Tiranë me projektin “Edukimi i fëmijëve parashkollorë”. Kopshti u përrua në vitin 2006 dhe ka afro 30 fëmijë. Vazhdimësia e veprimtarisë së kësaj shoqate ka hyrë në rrugë institucionale dhe strukturat e MASH po japin gjithë mbështetjen e nevojshme për licencimin e këtij institucioni.

Ndërkohë njësitë e pushtetit vendor kanë marrë masa për të nxitur regjistrimin e fëmijëve romë në institucionet e arsimit parashkollor. Bashkia e Tiranës për të rritur kapacitetet thithëse ka ulur pagesat për familjet në nevojë. Nëse familja ka një fëmijë të regjistruar në çerdhe apo kopsht pagesa bëhet në masën 4396

50% dhe kur nga e njëjta familje ka të regjistruar më shumë se një fëmijë, shërbimet e kopshtit janë pa pagesë.

282. Komponent përbërës i projekteve të zbatuara nga organizata rome kanë qenë edhe kurset e gjuhës shqipe për t'i përgatitur fëmijët romë për klasën e parë.

Kjo është realizuar në disa qytete, si Tiranë, Korçë, Kuçovë, Lushnjë dhe Fushë Krujë. Ndërkohë ndërhyrje të tilla janë planifikuar të realizohen dhe nga drejtoritë arsimore rajonale, kryesisht në ato kopshte ku ka përqendrim të madh të fëmijëve romë.

Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e nxënësve që duhet të frekuentojnë shkollën dhe përqindjen e frekuentimit, por OJF-të që trajtojnë probleme të komunitetit rom dhe shoqatat rome japin të dhëna alternative, të cilat shpesh herë janë marrë në konsideratë nga institucionet shtetërore.

Nr.22. Komiteti është i shqetësuar rreth vështirësive që hasin minoritete të veçanta, në veçanti ai grek dhe arumun, në kthimin e kompensimin për pronat e komuniteteve të tyre fetare.

Komiteti inkurajon shtetin palë që të bëjë të mundur hyrjen së shpejti në fuqi të kuadrit ligjor mbi kthimin dhe kompensimin e pronave që një çështje e tillë të zgjidhet një herë e përgjithmonë.

283. Lidhur me këtë rekomandim, pranojmë se ka pasur vonesa në zbatimin e ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, por që asnjëherë këto vonesa nuk kanë pasur kategorikisht lidhje me dallimet etnike apo ato fetare. Zbatimi abuziv për shumë vjet me radhë i ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, bëri që në shumë raste, të kishte mbivendosje pronësie, në pronat publike, private dhe të komuniteteve fetare. Megjithatë, strukturat përgjegjëse në këtë proces janë duke vazhduar punën për zgjidhjen një herë e përgjithmonë të kësaj çështjeje.

Nr. 24. Komiteti vëren gjithashtu se personat që u përkasin minoriteteve kanë shumë pak akses për transmetimin në gjuhën e tyre të programeve në radiotelevizion.

Komiteti mirëpret vendimin e autoriteteve shqiptare për masat që do të marrin për rritjen e kohës së programeve të radios e televizionit në gjuhën e minoriteteve dhe kërkon nga shteti palë që këto masa të merren për të gjitha minoritetet, në veçanti për malazezët, romët dhe arumunët. Gjithashtu, sugjerohet që shteti palë të lehtësojë transmetimin e destinuar për minoritetet, duke përfshirë minoritetin grek.

284. Në RSH si media e shkruar, ashtu edhe ajo elektronike janë krejtësisht të lira nga çdo ndikim shtetëror. Kjo do të thotë që shteti është krejtësisht në pamundësi për të ndërhyrë në programimin e emisioneve televizive apo radiofonike, si dhe në çështjet që trajtohen nga shtypi i shkruar. Me përjashtim të Radiotelevizionit Publik, gjithë pjesa tjetër e shtypit të shkruar, e atij elektronik është privat dhe si e tillë i nënshtrohet rregullave të ekonomisë së tregut. Për sa i përket Radiotelevizionit Publik, është parashikuar mbajtja e emisioneve në gjuhën e minoriteteve, veçanërisht për ato zona në të cilat popullsia minoritare përbën shumicën e popullsisë.

285. Televizioni Shqiptar (TVSH) nëpërmjet programeve të veta televizive, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë pakicave kombëtare, gjuhësore dhe komuniteteve të veçanta në Shqipëri. Tematikat e këtyre programeve prekin problemet e pozicionimit në shoqëri të personave që u përkasin atyre minoriteteve/komuniteteve, marrëdhëniet e komunikimit ndërmjet tyre dhe strukturave shtetërore, si edhe kërkimit të rrugëve, mundësive dhe alternativave efektive për integrimin e tyre në shoqëri.

286. Formatet e programeve të përgatitura i trajtojnë problemet sociale, në përputhje me shtresa të caktuara sociale dhe grupmoshat, sikurse programet “Fokus fëmënor” (vështirësitë e shkollimit të fëmijëve romë), “Grua” – (problemet e diskriminimit të dyfishtë të gruas dhe femrës rome), “Skaner” (problemet e diskriminimit dhe integritetit të minoriteteve në Shqipëri), “7x7” (problemet e organizimit politik të minoriteteve PBDNJ- urë lidhëse apo determinante midis dy kulturave).

Cikli i përdyjavshëm kushtuar pakicave kombëtare në emisionin e përditshëm të TVSH, titulluar “ZIK – ZAK”, ka trajtuar në emisione të veçanta, për komunitetet rome, vllahe/arumune dhe egjiptiane, temat që lidhen me: historinë, prejardhjen, gjuhën dhe kulturën (muzika, kërcimet, e drejta zakonore), strehimin dhe shpërnguljet, regjistrimin administrativ dhe marrëdhëniet me shtetin ligjor, lidhjet e tyre ndërkombëtare, problemet sociale, shoqatat përkatëse, tentativat e tyre për integrimin etj.

Po ashtu për secilin nga këto komunitete është përgatitur një program i veçantë me temë, p.sh.: “Romët - Histori suksesi në fusha të ndryshme të jetës”.

287. Gjatë periudhës 2008 – 2009, TVSH ka prodhuar dhe transmetuar dy dokumentarë me temën e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit mes shqiptarëve dhe minoritetit grek, në jug të vendit. Dokumentari i parë titullohet “Fqinjët” (me autor Pluton Vasi), ndërsa dokumentari tjetër titullohet “Dropulli i Sipërm” (me autor Ilir Buçpapaj). Në qendër të vëmendjes së tyre kanë qenë lidhjet shpirtërore, martesat, shkollimi,

fatet e përbashkëta, angazhimet e tyre në jetën politike dhe administrative.

Radio Tirana – Në kanalin e parë të kësaj radio përgatitet dhe transmetohet një herë në muaj, për secilin minoritet në Shqipëri, një kronikë speciale 30 min dhe një kronikë tjetër, gjithëpërfshirëse, me minutazh të zgjeruar.

Në vitin 2008 në bashkëpunim me Institutin e Medias u përgatitën dhe u transmetuan 8 radioreportazhe për minoritetet gjuhësore rome dhe vllahe/arumune, përkatësisht në gjuhët e tyre. Kanali i tretë i kësaj radio, transmeton çdo ditë 15 min program në gjuhën greke dhe atë serbe.

Radio Korça, çdo ditë në orën 19.00 transmeton 30 min program me lajme dhe muzikë në gjuhën maqedonase.

Radio Gjirokastra, çdo ditë në orën 18.00 transmeton 45 min program kulturor në gjuhën greke.

Tv Gjirokastra transmeton një herë në javë, programin 60 min në gjuhën greke, me dokumentarë, telereportazhe etj.

288. Bazuar në kërkesat e vetë subjekteve të interesuara, Këshilli Kombëtar i Radio televizionit ka licencuar dy operatorët radiofonikë privatë vendorë “Radio Armonia” dhe “Radio Prespa” (përkatësisht të minoritetit grek dhe atij maqedonas), si dhe televizionin privat vendor “TV Armonia” (të minoritetit grek).

Zona e licencimit për “TV Armonia” dhe “Radio Armonis” është rrethi Gjirokastër, ndërsa zona e licencimit për “Radio Prespa” është komuna Liqenas.

Nr.25. Komiteti është i shqetësuar përse u përket vështirësive në akses që hasin romët dhe pjesëtarët e komunitetit që e quajnë veten egjiptianë në vende dhe shërbime të destinuara për përdorim publik.

Komiteti fton shtetin palë të marrë masat e duhura për të garantuar që askush të mos jetë i privuar nga aksesit në vendet publike dhe që askujt të mos i mohohet kjo e drejtë pa dallim race, ngjyre, prejardhje ose origjinë kombëtare apo etnike.

289. Në lidhje me rekomandimin 25 komentojmë se aksesit nuk mungon, por pranojmë se duhet punuar më shumë për të informuar dhe ndërgjegjësuar minoritetin rom dhe komunitetin e egjiptianëve, për të drejtat jo vetëm në aksesin në vendet publike, por dhe në të gjitha shërbimet sociale të ofruara nga shteti.

Nr.26. Komiteti shpreh keqardhjen për mungesën e informacionit nga shteti palë për ndikimin e mundshëm në zbatimin e Konventës për ndryshimet e bëra në legjislacionin i brendshëm në luftën kundër terrorizmit.

Komiteti fton shtetin palë që në raportin e ardhshëm periodik të japë informacion për ligjet dhe praktikatat e saj duke iu referuar veçanërisht identitetit, hyrjes, qëndrimit, kontrollit të të huajve, të drejtën për azil dhe ekstradim.

290. Në këtë kuadër Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim edhe me misionin PAMECA II dhe III ka hartuar një draft të strategjisë së luftës kundër terrorizmit, e cila iu është paraqitur për mendim dhe institucioneve të linjës. Qëllimi i kësaj strategjie do të jetë zvogëlimi i rrezikut të terrorizmit kombëtar e ndërkombëtar, që mund të kërcënojë demokracinë dhe mënyrën e jetesës së shtetasve shqiptarë. Së shpejti pritet që të fillojnë procedurat e miratimit, dhe ky të bëhet një dokument konkret për punën e strukturave të luftës kundër akteve terroriste.


Aktualisht këto struktura punojnë duke u bazuar në Planin Kombëtar të Veprimit Kundër Terrorizmit i miratuar nga Këshilli i Ministrave nr. 12, datë 28.01.2002.

Lidhur me regjimin e hyrjes, të qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve nga territori shqiptar, ligji “Për të huajt”²⁶, përcakton qartë funksionet, kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe subjekteve të tjera, publike dhe private, shqiptare dhe të huaja, që kanë të bëjnë me të huajt. (neni 1).

Kushtëzuar nga fakti i qëndrimit të rregullt në territorin shqiptar, ligji i njeh “të huajt” të drejtën e zotërimit të dokumenteve. (refero paragrafët 100 – 104 të raportit, neni 1)

Në vijim paraqiten në mënyrë grafike lejet e qëndrimit të lëshuara nga zyrat vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit, për periudhën janar 2002 – qershor 2008.

²⁶ Miratuar me ligjin nr. 8492, datë 27.05.1999, dhe ndryshuar me ligjin e miratuar në vitin 2008, nr. 9959, datë 17.07.2008
4398



Nr. 28. Komiteti rekomandon që informacion shtesë duhet t'i jepet atij mbi:

a- aktivitetin e Avokatit të Popullit, zyrës së Minoriteteve Kombëtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe sektorit për minoritetet kombëtare në Drejtorinë e Prefekturave në Ministrinë e Pushtetit Lokal;

b- masat e marra nga shteti palë për zbatimin e nenit 7 të Konventës. Në veçanti raporti i ardhshëm periodik duhet të përfshijë informacion mbi edukimin dhe trajnimin mbi të drejtat e njeriut për nxitjen e mirëkuptimit ndërmjet grupeve etnike dhe raciale dhe për mësuesit e nxënësit, për pjesëtarët e forcave të rendit, anëtarë të partive politike dhe profesionalistëve të medias.

291. Institucioni i Avokatit të Popullit përmendet për herë të parë në legjislacionin shqiptar nga Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1998. Akti themeltar i shtetit në nenet 60 - 63, përcakton funksionin, parimet e veprimtarisë, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Po ashtu, në nenin 134/"dh" sanksionohet e drejta e këtij institucioni për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Ky institucion përfaqëson një mekanizëm shtetëror, jashtë strukturave gjyqësore, për hetimin e pavarur të ankesave, kërkesave apo njoftimeve të qytetarëve ndaj sjelljes, vendimeve, veprimeve apo mosveprimeve të parregullta apo të paligjshme të administratës publike.

292. Parimet dhe tiparet thelbësore të institucionit janë pavarësia, konfidencialiteti, paanësia, profesionalizimi, fleksibiliteti, besueshmëria dhe transparenca ndaj publikut

Kodi i Procedurave Administrative²⁷, ligji nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"²⁸, ligji nr. 9888, datë 10.3.2008 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim"²⁹ si dhe ligji nr. 9135, datë 11.9.2003 "Për mbrojtjen e Konsumatorit"³⁰, përbëjnë bazën ligjore, ku përcaktohen thuajse të gjitha të drejtat dhe detyrat funksionale të zyrës së Avokatit të Popullit.

Institucioni merret me shqyrtimin e çështjeve pas paraqitjes së ankesave, kërkesave dhe njoftimet që paraqesin individët drejtpërsëdrejti ose me nismën e vetë institucionit, për të gjitha rastet e bëra publike.

293. Neni 12 i ligjit organik të veprimtarisë së institucionit, parashikon të drejtën e "Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat dhe liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike..." të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur.

294. Ligji nr.9398, datë 12.05.2005 "Për disa ndryshime në ligjin për Avokatin e Popullit" hoqi kufizimin ligjor për fillimin e rasteve *ex officio* nga Avokati i Popullit ("pëlqimi i të interesuarit ose të dëmtuarve"), kur trajtohen rastet e të dëmtuarve të mitur ose persona me aftësi të kufizuara. Neni 13 i këtij ligji parashikon se: Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paaftë mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

295. Gjithashtu ligji i sipërcituar ka parashikuar disa të drejta dhe kompetenca të tjera të reja në funksion të veprimtarisë së zyrës së Avokatit të Popullit. Në paragrafin e fundit të nenit 25 të këtij ligji parashikohet se: "Avokati i Popullit, pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë, dhe procedurat

²⁷ Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 45

²⁸ Neni 18

²⁹ Neni 74/1

³⁰ Neni 55

gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve”.

296. Sektori i të Drejtave të Njeriut, Pakicave dhe Raportimeve pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme është një sektor specifik, i cili merret me përmbushjen e detyrave në kuadrin e zbatimit dhe koordinimit të politikës së qeverisë shqiptare lidhur me minoritetet.

Disa nga detyrat e këtij sektori janë i) përgatitja e raporteve kombëtare lidhur me zbatimin e Konventave të OKB-së në fushën e të drejtave të njeriut, ii) ndjekja e zbatimit të detyrimeve në fushën e të drejtave të minoriteteve në kuadrin e procesit të integritetit të Shqipërisë në BE dhe raportimi, iii) Organizimi dhe drejtimi i mbledhjeve të Grupeve të Punës me përfaqësues të ministrive të linjës dhe dhënia e udhëzimeve lidhur me informacionin e domosdoshëm për hartimin e raporteve, iv) Mbajtja e kontakteve me përfaqësues të shoqatave të minoriteteve si dhe shoqatave në fushën e të drejtave të njeriut.

297. Përsa i përket strukturës “Sektori për minoritetet kombëtare në Drejtorinë e Prefekturave në Ministrinë e Pushtetit Lokal”, për të cilin Komiteti kërkon informacion në këtë rekomandim, sqarojmë se me ndryshimet e ndodhura në strukturat e institucioneve qendrore, pas zgjedhjeve parlamentare të viteve 2005 dhe 2009, kjo strukturë nuk ekziston më.

298. Lidhur me pikën b të rekomandimit komentojmë se në Shqipëri ka një rrjet të gjerë dhe të zhvilluar OJF, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në nivel kombëtar dhe lokal, duke u përqendruar kryesisht në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut.

Gjatë periudhës 2001-’06, shoqëria civile në bashkëpunim me donatorët e ndryshëm ka qenë veçanërisht aktive në: i) monitorimin e vazhdueshëm të situatës së respektimit të drejtave të njeriut dhe minoriteteve; ii) ndërgjegjësimin e opinionit publik për të drejtat e minoriteteve; iii) trajnimin e administratës publike, organeve qendrore dhe vendore; iv) rritjen e kapaciteteve të organizatave të minoriteteve; v) aktivitetet për rritjen e pjesëmarrjes së minoriteteve në jetën publike; vi) aktivitetet për parandalimin e trafikimit të grave dhe fëmijëve; vii) trajnimin e medias; viii) hartimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore; ix) publikimet informuese.

299. Qeveria shqiptare, duke vlerësuar rolin e shoqërisë civile në përmirësimin e vazhdueshëm të situatës së respektimit të të drejtave të njeriut, synon mbajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve konstruktive me organizatat e shoqërisë civile aktive në këtë fushë.

Dëshmi e kësaj fryme është dhe nënshkrimi më 15 tetor 2002 i një memorandumit mirëkuptimi midis Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe organizatave jofitimprurëse të angazhuara në studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Memorandumi synon nxitjen e bashkëpunimit, rritjen e shkallës së transparencës dhe kontributit të shoqërisë civile në përpjekjet e gjithanshme, drejt procesit të integritetit të Shqipërisë në strukturat europiane dhe euroatlantike, si dhe ruajtjen dhe respektimin në mënyrë të drejtpeshuar të raporteve të partneritetit dhe opionencës ndërmjet tyre.

Palët shprehen të gatshme për të ftuar ekspertë të tyre, si anëtarë të grupeve ndër-institucionale të punës, për çështje të ndryshme të politikës, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe integritetit euroatlantik.

300. Në këtë kuadër, organizatat jofitimprurëse janë ftuar vazhdimisht nga grupi ndërministerial i koordinuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për të ndihmuar dhe kontribuar në përgatitjen e raporteve që paraqiten para organeve që janë parashikuar nga Traktatet e Kombeve të Bashkuara, për të drejtat e njeriut.

301. Një aspekt i rëndësishëm, në kuadrin e rritjes së bashkëpunimit dhe dialogut me shoqërinë civile në procesin e zbatimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit mbi Konventën Kuadër ka qenë dhe pjesëmarrja aktive e institucioneve qendrore dhe vendore në aktivitete dhe projekte të shoqërisë civile.

Përmendim si shumë të suksesshëm në këtë drejtim, projektin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve”, në bashkinë e Korçës”, ku Këshilli Bashkiak i Korçës, nëpërmjet një vendimi të tij (23 maj 2006), vendosi pjesëmarrjen aktive në zbatimin e këtij projekti, duke ngritur madje dhe një grup pune të përbërë prej 5 anëtarësh të Këshillit, të cilët mbikëqyrën procesin e plotësimit të pyetësorëve të përgatitur për zbatimin e projektit.

Një përvojë shumë pozitive ofroi gjithashtu dhe programi “Përmirësimi i Marrëdhënieve Ndëretnike në Europën Juglindore³¹”, i zbatuar thuhet tërësisht në nivel vendor.

2) Sipas ligjit “Për Avokatin e Popullit”, në kryerjen e funksioneve të veta, ky i fundit bashkëpunon

³¹ Program i Fondacionit King Boudouin, Fondacionit të shoqërisë së hapur civile(OSFA), Fondacionit Charles Stewart Mott (CFMF) dhe Qendrës për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC).

ngushtë me organizatat jofitimprurëse, duke marrë periodikisht, mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë kuptim ai ka ofruar bashkëpunim OJF-ve më të angazhuara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke pasqyruar funksionet e këtij institucioni dhe strategjinë e tij të bashkëpunimit.

3) Shqipëria ka marrë pjesë aktivisht në zbatimin e shumë projekteve në kuadrin e nismave rajonale në kuadrin e Tryezës së Parë të Demokracisë dhe të Drejtave të Njeriut, të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore dhe grupit të minoriteteve të Nismës së Europës Qendrore.

Në përpunimin e tyre kanë kontribuar edhe një numër OJF, që janë pjesë aktive e këtyre nismave³². Pjesëmarrja aktive e Republikës së Shqipërisë në këto projekte është dëshmi e përpjekjeve gjithnjë e në rritje të Shqipërisë për promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit, lidhur me respektimin e diversitetit kulturor në Shqipëri.

4) Duke vlerësuar si mangësi mospërfshirjen e përfaqësuesve të pjesëtarëve të minoriteteve në procesin e hartimit të raportit të parë dhe në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit Këshillues të Konventës për minoritetet kombëtare, në hartimin e raportit të dytë, përfaqësues të shoqatave të minoriteteve dhe shoqërisë civile janë ftuar të marrin pjesë aktivisht gjatë gjithë këtij procesi.

Për këtë qëllim, është zhvilluar dhe një takim i zëvendësministres së Punëve të Jashtme me përfaqësues të shoqatave të minoriteteve dhe shoqërisë civile aktive në fushën e respektimit të të drejtave të minoriteteve.

Gjatë këtij takimi nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme është kërkuar bashkëpunimi me përfaqësues të shoqërisë civile dhe shoqatave të minoriteteve në përgatitjen e raportit të dytë zyrtar që Republika e Shqipërisë dhe përveç pyetësorit të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër për t'u plotësuar nga OJF-të u shpërnda dhe një material, i cili kërkonte qëndrimin e shoqatave lidhur me:

- problematikën specifike për minoritetet kombëtare dhe etnoghjuhësore;

- statistikat mbi minoritetet;

- vlerësime mbi gjendjen e respektimit të të drejtave të tyre, në mënyrë të veçantë informacione faktike mbi ushtrimin e së drejtës së përdorimit të gjuhës amtare në marrëdhënie me autoritetet vendore, në toponimet topografike, edukimi në gjuhën amtare, të dhëna mbi përfaqësimin e tyre në organet e pushtetit qendror dhe vendor, polici, financime të ndryshme në zonat ku ato banojnë, lëvizjen e lirë në vendet e origjinës;

- publikime të ndryshme për minoritetet nga OJF-të;

- aktivitete, projekte mbi respektimin e të drejtave të minoriteteve;

- vlerësime mbi politikën shtetërore për respektimin e të drejtave të minoriteteve, problematika e minoriteteve në Shqipëri dhe fushat ku nevojitet angazhim më i madh nga instancat shtetërore;

- vlerësim mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”.

302. Publikime të ndryshme në fushën e respektimit të të drejtave të minoriteteve

- Publikimi i INSTAT-it në bashkëpunim me MPJ për të dhënat statistikore mbi minoritetet.

- Studim mbi kuadrin ligjor dhe strukturat për minoritetet në kuadrin e Nismës për Europën Qendrore.

- Botimi i Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”, në bashkëpunim me OSBE-në.

303. Publikime të shoqërisë civile:

1. Publikimi i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, i cili përmbledh Konventën, Opinionin dhe Rezolutën e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër.

2. Publikime të Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

- “Minoritetet në Shqipëri” (versioni shqip dhe anglisht).

- “Çështja e minoriteteve në Europë (tekste dhe analiza, versioni shqip).

- Framework Convention on national minorities (versioni anglisht).

- Broshura Konventa Kuadër “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar për të drejtat e minoriteteve (versioni shqip, maqedonisht, greqisht).

- Fletëpalosje për minoritetet.

304. Grupi shqiptar për të drejtat e njeriut

³² Link Diversity, Non-discriminating Review, Central Europe Initiative (CEI)

- “Analizë mbi problemin e regjistrimit të popullsisë rome dhe egjiptiane në Shqipëri”.
- Studimi mbi minoritetet në Shqipëri, mbështetur nga Komiteti Suedezi i Helsinkit.
- Media dhe minoritetet, mbështetur nga CIDA-Ambasada Kanadeze.
- Materiale të Fondacionit Soros.
- Përmbledhje ekzekutive mbi raportin për zbatimin e strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom në Shqipëri”.

-Monitorimi i Strategjisë Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”.

Në këtë kuadër përmendim dhe vetë punën që bëhet nga shoqatat e minoriteteve, në publikimin e botimeve periodike të tyre.

Nr. 29. Komiteti rekomandon se për zbatimin me më shumë efektivitet në sistemin ligjor të brendshëm të dispozitave të Konventës, veçanërisht ato të nenit 2-7, shteti palë duhet të marrë në konsideratë pjesët përkatëse të programit dhe veprimtarisë të Deklaratës së Durbanit dhe Programit për Veprim dhe të përfshijë informacion në raportin e ardhshëm periodik mbi planin e veprimtarive dhe masa të tjera që do të merren për zbatimin e Deklaratës së Durbanit dhe Programit për Veprim në nivel kombëtar.

